

**PROBLEME NË RRUGËN  
E JETËS ISLAME**



**MUHAMED EL-GAZALI**



PROBLEME NË RRUGËN  
E JETËS ISLAME

Titulli në arabisht:  
Mushkilatun Fi Tarikil Hajatil Islamije  
Muhammed El Gazali

Përktheu  
Lavdrim HAMJA

Redaktoi  
Islam DIZDARI

Dizenjoi  
Bledar XAMA

مشكلات في طريق الحياة الإسلامية  
الشيخ محمد الغزالي

# PROBLEME NË RRUGËN E JETËS ISLAME

MUHAMED EL GAZALI



*Mbrojtësve të fesë, në shumicën e rasteve, nuk u mungon ndjenja dhe sinqeriteti, por u mungon thellësia e përvojës dhe kuptimi i drejtë i çështjeve!*

*Në historinë tonë shoqërore e politike ka bagazh të mjaftueshëm për atë që ka zemër, por tjetër gjë është se disfata të ndryshme godasin aktivistët në rrugën e Zotit për shkak të mungesës së përvojës dhe eksperiencës së paktë, ose për shkak të varfërisë së madhe në diturinë e vërtetë për librin e Zotit dhe synetin e të Dërguarit të Tij.*

# PËRMBAJTJA

<b>PARATHËNIE</b> .....	13
<b>KAPITULLI I</b> .....	15
Vështrime të reja e të ndryshme të punëve të mira .....	15
Qëndrimi i myslimanëve në këtë kohë.....	16
E vërteta e adhurimit.....	18
Detyrat kolektive dhe ato individuale.....	22
Detyra dhe vullnetarja.....	26
Fetarizmi dhe lidhja e tij me begatitë e Zotit në gjithësi .....	28
Diçka për përparimin shkencor .....	31
<b>KAPITULLI II</b> .....	35
Në kulturë, edukim dhe moral .....	35
Kultura kombëtare .....	36
Shkencat njerëzore dhe lidhja e tyre me kulturën kombëtare.....	37
Nevoja për gjallërimin e kulturës personale.....	39
Edukimi i kërkuar .....	41
Gishti i akuzës .....	48
<b>KAPITULLI III</b> .....	53
Rreth islamit .....	53
Pjesë nga realiteti .....	56
Në kohën e vjetër.....	56
Dhe erdhi islami.....	57
Veçoritë e lëvizjes së re.....	59
Islami dhe gruaja.....	62
Familja dhe rëndësia e saj .....	63
Roli i pasurisë në shoqëri.....	65
Pushteti është amanet dhe përgjegjësi.....	66
Dhe në epokën e re .....	71
Çështje të rëndësishme.....	73



Nuk është nga thirrësit.....	74
Arabët e kohës së re.....	75
<b>KAPITULLI IV.....</b>	<b>77</b>
Sprovat e gjuhës arabe dhe rreziqet që ajo përmban.....	77
Fyerja e arabishtes.....	79
Në fushën e letërsisë.....	80
<b>KAPITULLI V.....</b>	<b>83</b>
Në mes të drejtësisë dhe ekstremizmit.....	83
Udhëheqësit e popullit.....	85
Prej shkaqeve të ekstremizmit fetar.....	88
Teprimi dhe neglizhimi.....	94
<b>KAPITULLI VI.....</b>	<b>71</b>
Shfrytëzimi i ndryshimeve.....	97
Është tradhëti e madhe.....	97
E qarta dhe e jo e qarta.....	99
Selefët dhe halefët.....	101
Rruga e drejtë.....	104
Ndryshimi i juristëve.....	106
Teksti kuranor dhe transmetimet njëshe.....	108
Bashkëpunimi në atë që të gjithë bien dakord.....	111
<b>KAPITULLI VII.....</b>	<b>115</b>
Të kuptuarit e thirrjes islame dhe problemi i thirrësve.....	115
Kuptimi i praktikave hyjnore në njerëz dhe në univers.....	117
Kur’ani dhe pushteti.....	125
Të konsultuarit në periudhën e lulëzimit të filozofisë.....	130
Besa masive dhe xhemati mysliman.....	133
Rënia e fetvave zyrtare.....	139
Dështimi i parë dhe i fundit.....	148



## BIOGRAFIA E AUTORIT

**Muhamed El Gazali (1917-1996):** Është lindur në fshatin Neklal Ineb në prefekturën e Buheras, Egjipt, më 5 Dhil Hixhe 1335h/22 Shtator 1917. U rrit në një familje të ndershme dhe u edukua në një ambient besimi.

Mësoi përmendësh Kur'anin dhe lexoi hadithin në shtëpinë e babait të tij. Hyri në shkollën fetare të Aleksandrisë dhe vazhdoi aty deri sa arriti të mbarojë shkollën e mesme të Ez'herit.

Më vonë, në vitin 1356h/1937 shkoi në Kajro dhe u regjistrua në fakultetin e Usuli Din. Gjatë studimeve të tij në Kajro u lidh me Imam Hasen Benna. Duke forcuar lidhjet me të u bë prej njerëzve të afërm të tij, deri sa Imam Hasen Benna kërkoi nga ai të shkruaj në revistën Ihvanul Muslimin, pasi mori premtimin e tij për vendosmëri dhe qartësi.

Imam Hasen Benna asnjëherë nuk pushonte së nxituri që ai të shkruante gjithmonë. U diplomua në vitin 1360h/1941.

U specializua në fushën e Thirrjes (Dawes), ku dhe mori gradën El Alemijetu në vitin 1362h/1943 dhe vazhdoi udhëtimin e Thirrjes nëpër xhamitë e Kajros.

### *El Gazali, kalorës i Thirrjes Islame*

Shejkh Muhamed El Gazali ka qenë “huxh-xhe” (argument), ashtu siç ka qenë argument edhe Ebu Hamid El Gazali.

Shejkh M. El Gazali ishte njëri prej thirrësve të mëdhenj të Islamit dhe burrave reformator të shquar. Tek ai ishin mbledhur cilësi që nuk janë mbledhur vetëm tek një numër i paktë njerëzish të shquar. Ai ishte besimtar i sinqertë, muxhahid në fushën e Thirrjes. Islami sundoi gjithë jetën e tij dhe jetoi për të duke ia kushtuar fesë tërë jetën e tij.

Lapsin dhe mendjen e nënshtroi në sqarimin e qëllimeve dhe lartësimin e synimeve. Shpjegoi parimet, i mbrojti dhe i

ruajti nga armiqtë e fesë.

Nuk ka lënë mjet që ka njohur pa e përdorur në arritjen e qëllimeve të tij. Kështu që shfrytëzoi librin, gazetën, radion dhe televizionin në realizimin e asaj që dëshironte në shërbim të fesë Islame.

Zoti xh.sh i kishte dhënë mendje të thellë, kulturë të gjerë Islame dhe si produkt i kësaj kanë qenë librat e shumtë në fushën e mendimit Islam, të cilat i jepnin jetë ymetit, reformonin brezat, hapnin rrugët, edukonin rininë, ndërtonin mendje dhe lartësonin idetë.

Ai kur shkruante ishte letrar i përsosur. Po qe se do t'i kushtohej letërsisë do të arrinte kulmin e tij, do të ishte nga lloji i argumentit letrar dhe talentit islam Mustafa Sadik Rafij, por zgjodhi rrugën e Thirrjes duke qenë letrari i përkryer i saj.

Zoti xh.sh i kishte dhuruar retorikë dhe qartësi, e cila bënte për vete zemrat e secilit që rrinte me të, të shoqëruar me dialekt të pastër e besim të sinqertë, qartësi mendimesh dhe nivel të lartë të çështjeve islame.

Hytbet dhe mësimet e tija ishin bashkim idesh dhe shkollë e Thirrjes në çdo vend që rrinte.

El Gazali zotëronte ndjenjat e dëgjuesve kur predikonte dhe orientonte mendjet e njerëzve kur shkruante.

Ai ishte njeri reformator, dijetar i sëmundjeve të shoqërisë islame në të gjithë anët e saj.

Jetën e tij ia kushtoi zbulimit të problemeve, luftimit të bidateve dhe formave të shthurjeve, me një gjuhë të qartë pa ndërlikime dhe pështjellime. Shfaqte hapur atë që besonte, sepse ishte e vërtetë dhe nuk shqetësohej aspak për pakënaqësitë e pushtetarëve, ose zemërimin e qytetarëve.

Atë e lëvizte një besim i fortë, trimëri e patundur dhe shpirti islam.

Fusha për të cilën ishte krijuar Shejkh Muhamed El Gazali, ka qenë fusha e Thirrjes për tek Zoti xh.sh, me mençuri dhe urtësi, me ndihmën e lapsit dhe gjuhës së tij. Ai kishte një rubrikë të veçantë në revistën Ihvanul Muslimin, e cila

titullohej “Ide të gjalla”, duke shfaqur talentin e tij në çështjet dhe problemet bashkëkohore të Islamit dhe myslimanëve.

Shejkh M. El Gazali ndërroi jetë duke dhënë kontributin e tij në atë fushë ku dhe ia kushtoi gjithë jetën e tij. Në konferencën e Thirrjes Islame në Riad, gjatë punimeve të saj një debat u ndez rreth një çështjeje në besimi, shejkh Gazali ndërhyri me këmbëngulje duke sqaruar dhe argumentuar shkencërisht, si pasojë e këtij debati u godit nga një infarkt i zemrës, i cili i shkaktoi edhe vdekjen, më 9 mars 1996. U varros në varrezat e Bekias, në Medine munevvere.

### *Disa nga librat e tij*

Shejkh Muhamed El Gazali gjatë jetës së tij la një trashëgimi të pasur me libra të shkruar prej tij, rreth 60, ndër ta:

- El islam vel euda’ë el iktisadije (ky është edhe libri i parë i tij, 1947)
- Es sunnetu en nebevije bejne ehlil fikhi ve ehlil hadith
- Kadajal mer’etil muslimeh
- Fikhus sire
- Dusturul vahdetith thekafije
- Min huna na’lem
- Kadhaiful hakk
- Rakaizul iman
- El islam vel istibdadus sijasij
- Iel ve edvije
- Akidetul muslim
- Khulukul muslim
- Teemmulat fid dini vel hajat ...etj.



## PARATHËNIE

Falënderimi i takon Allahut, që është një dhe i pashoq.

Myslimanët, që afërsisht janë  $\frac{1}{4}$  e banorëve të tokës, jetojnë sot një periudhë kritike të historisë së tyre dhe në rrethana të zymta. Skajet e tyre po zvogëlohen dita ditës. Ndërsa qendra është e kërcënuar të humbasë në një kohë që kolonizuesi kulturor insiston duke bërë presion rreth de-tyrave fetare të tyre.

Për këtë, atyre u kërkohet që të vendosin jetën në shërbim të fesë dhe orientimin e veprimtarive individuale e shoqërore në shërbim të Mesazhit hyjnor dhe realizimit të qëllimeve të tij.

Islami është mesazh që kërkon nga përqafuesit e tij ta bëjnë shoqërinë e tyre më të përshtatshme për jetën dhe më të aftë për të pasur suksese.

Mbrojtësve të fesë, në shumicën e rasteve, nuk u mungon ndjenja dhe sinqeriteti, por u mungon thellësia e përvojës dhe kuptimi i drejtë i çështjeve!

S'ka dyshim se gjendja e myslimanëve sot ndryshon nga gjendjen e gjermanëve, të cilët hynë në luftën e dytë botërore pas disfatës së tyre në luftën e parë, akoma pa kaluar 20 vjet!

Ne myslimanët ecëm prapa për disa shekuj me radhë dhe po tërhiqemi që nga fundi i shekullit të XIX-të, kur dihet se gjyshërit dhe baballarët tanë qëndruan e u bënë ballë sulmeve e trashëguan këtë qëndresë guximtare e fisnike dhe fituan beteja të shumta duke mundur të tjerët.

Mendoj se patjetër duhet t'i bëjmë një studim të përgjithshëm shkaqeve të tërheqjes sonë civile e ushtarake duke përcaktuar faktorët e gjallërisë, të cilët i humbëm derisa na goditi ajo që na goditi? Patjetër duhet një shikim i mprehtë dhe i thellë, i cili do të kujdeset për kulturën tonë dhe të pastrojë burimet e saj! Të shqyrtojë me hollësi nivelin tonë të fundit civilizues dhe të zbulojë shkaqet e rënies!

A ishim me të vërtetë në zanafillën që Zoti i krijoi njerëzit, apo na munda sëmundja e popujve të parë dhe u larguam nga rruga e drejtë? N.q.s duam kthimin, cila është rruga më e mirë?

Mbajtja e fesë së Zotit është një gjë, ndërsa përfitimi i pushtetit me një rrugë apo me një tjetër është një gjë tjetër. Mbajtja e fesë së Zotit do të thotë, para së gjithash, themelimi i lidhjeve të pastra mes robit dhe Zotit të tij, larg nga kërkimi i kësaj bote, nga ngopja me dëfrimet dhe nga mbizotërimi i dëshirave të saj.

*“Atë botën tjetër e bëjmë për ata të cilët nuk duan mendje-madhësi në tokë dhe as shkatërrime...”<sup>1</sup>*

Kjo do të thotë gjithashtu pjesëmarrje në ndërtimin e një shoqërie botërore, që e njeh të mirën dhe urren të keqen, respekton të drejtat dhe madhëron Zotin e gjithë botëve!

Në historinë tonë shoqërore e politike ka bagazh të mjaftueshëm për atë që ka zemër, por tjetër gjë është se disfata të ndryshme godasin aktivistët në rrugën e Zotit për shkak të mungesës së përvojës dhe eksperiencës së paktë, ose për shkak të varfërisë së madhe në diturinë e vërtetë për librin e Zotit dhe synetin e të Dërguarit të Tij.

Në këtë libër ka shembuj problemesh të ndryshme, ku specialistë të fushës islame kanë hyrë ose do të hyjnë në to, për të cilat pata dëshirë që t'i shpjegoja në dritën e asaj që u mahnita prej historisë sonë të tashme dhe të kaluar.

*Muhamed El Gazali*





# KAPITULLI I

## Vështrime të reja e të ndryshme të punëve të mira

Në të kaluarën Hadremeuti i madh ishte vendi i dueleve ku dy armiq ndesheshin dhe asnjëri nuk ndalej ndaj tjetrit derisa ta mundte kundërshtarin, ose ta vriste duke e lënë në fushën e betejës. Ndoshta lufta fillonte me duelin e komandan-tëve të dy ushtrive armike, para se të ndizej ajo dhe të trium- fonte njëra palë me fitimin e këtij apo atij pjesëmarrësi në duel. Pastaj binin fshatra e qytete në dorën e fituesit. Kryesorja është se dëmet e luftës ishin të kufizuar edhe pse rezultatet politike, ekonomike dhe fetare ishin shumë të mëdha.

Ne kohën e sotme kur ndizet lufta, merr pjesë një popull i tërë, dalin djem e vajza, burra e gra dhe shtrihet era e saj në tokë, det dhe ajër dhe ka të njëjtin fat si ai që është në fillim, ashtu edhe ai që qëndron në fund. Shpenzohen mijëra e miliona të holla para se të fillojë lufta dhe përgatiten shumë forca të të gjitha llojeve, materiale dhe jo- materiale.

Njerëzit para se të futen në luftën e nxehtë janë në luftë të ftohtë dhe para përleshjes së vazhdueshme janë në gati- shmëri e përgatitje.

Kur shikojmë lindjen komuniste, apo perëndimin e krish- terë i gjejmë të dy kampet të mbrojtura e të përgatitura që të mos sulmohen papritur, në rast se bien daullet e luftës të jetë i parapërgatitur secili kamp që të shpëtojë ose të fitojë!

Çdokush në lindje apo perëndim e di detyrën e tij, mban mbi shpatulla përgjegjësitë që rëndojnë mbi të me dëshirën e tij dhe është i bindur se ky është përcaktim dhe se ka pak shpresë për t'iu shmangur.

## Qëndrimi i myslimanëve në këtë kohë

Le të shohim se cili është qëndrimi i myslimanëve në këtë kohë? Çfarë bëjnë ata me mesazhin e tyre hyjnor në hallet e kësaj jete?

Një miliard myslimanë filluan shekullin e XX-të në rrethana të vështira.

Netët e gjata na sjellin shumë ngjarje, skajet tona pakësohen çdo ditë, madje edhe qendra jonë është e kërcënuar të humbë. Kolonizuesi kulturor insiston duke bërë presione dhe ndërhyrje në dispozitat fetare dhe në planet tona, duke u ndihmuar nga shkrimtarë e tradhtarë, apo politikanë që urrejnë librin e Zotit dhe synetin e të Dërguarit të Tij.

Edhe një herë tjetër përsërisim pyetjen tonë: Cili është qëndrimi i myslimanëve në këtë kohë në të cilën luftërat kanë evoluuar duke u përmirësuar funksionimi i tyre në çdo gjë, kur armiku po këmbëngul të ndërtojë mbi gërmadhat tona!

Para së gjithash duhet të japim një ekspozitë të shpejtë lidhjes së myslimanit me fenë e tij, ose kërkesave të fesë ndaj përfaqësuesve të saj.

Myslimani është një person, i cili njeh saktë Zotin e tij dhe ndërton lidhjen e tij me Zotin e vet mbi parimin e dëgjimit dhe të bindjes. Ai bashkëpunon me vëllezërit e tij të besimit në themelimin e një shoqërie, e cila realizon në mënyrë të plotë detyrën e namazit, dhënien e zekatit dhe urdhëron për punë të mira e ndalon punët e këqija. Së bashku me këta vëllezër krijohet qeveria, e cila mbron këtë bashkësi dhe vendos gjithçka në jetën e tyre për forcimin dhe ngritjen e detyrave fetare.

Kush e lejon idenë të përhapet, nuk sheh tek ne veçse të mira; s'ka dhunë në fe, ndërsa kush përballet dhe na pengon, i tregojmë vendin e duhur dhe s'ka respekt.

Vënia e jetës në shërbim të fesë është një punë shoqërore dhe shtetërore në të njëjtën kohë dhe kërkon drejtimin e gjithë veprimtarive individuale e shoqërore në shërbim të

mesazhit dhe realizimit të qëllimeve të tij, i cili është shpallur për mbarë njerëzimin.

Në anën tjetër çdo lëvizje, e cila bën bashkësinë islame më të dobët se sa shoqet e saja komuniste, hebreje apo kristiane, konsiderohet mashtrim dhe tradhti. Çdo neglizhencë civile apo ushtarake në shërbim të Islamit është një moskokëçarje ndaj asaj që do të ngjajë.

Këtu sakrificat për Allahun e kalon xhaminë, duke përfshirë arat, uzinat, fabrikat, stacionet hapësinore, detin, tokën dhe çdo gjë që shkruhet apo dëgjohet dhe ndoshta përfshin imagjinatën, apo ëndrrat njerëzore.

Islami është mesazh, i cili kërkon nga përfaqesit e tij ta bëjnë shoqërinë e tyre më të vlefshme për jetën dhe më të fuqishme për të korrur fitore. Çdo gjë që ndihmon në realizimin e kësaj, është fe.



## E vërteta e adhurimit

Po t'i hedhim një sy adhurimeve hyjnore në Islam do të vëmë re se realizimi i tyre brenda 24 orëve nuk merr më tepër se një gjysmë ore, ndërsa mësimi i tyre përmbledhet në një fletë apo në dy të tilla. Koha tjetër që mbetet është e madhe për të kuptuar jetën, për zbulimin e energjive të saj dhe për t'i vënë ato në shërbim të fesë.

Çdo sakrificë dhe përpjekje në këtë drejtim quhet juridikisht punë e mirë, sakrificë e pëlqyer e pranueshme dhe forcim besimi, i cili e bën të gatshëm njeriun të fitojë kënaqësinë e Zotit xh.sh.

*“E kush bën ndonjë vepër të mirë dhe është besimtar, munda i tij nuk i mohohet, sepse Ne i shënojmë ato.”<sup>2</sup>*

Është e pamundur ngritja e një shoqërie, n.q.s pjesëtarët e saj janë injorantë ndaj kësaj bote, të pafuqishëm në këtë jetë. Punët e mira kërkohet që t'i bëjë sëpata e druvarit, gjilpëra e rrobaqepësit, lapsi i shkrimtarit, ekspertiza e doktorit, provëza e farmacistit. I bën ato polumbari në det, piloti në qiell, shkencëtari në laborator, ekonomisti në planin e tij. Duhet t'i bëjë ato çdo mysliman që është anëtar i mesazhit hyjnor, kur ai merr përsipër çdo gjë duke i përdorë sendet si mjete për të ndihmuar fenë e Zotit dhe për të mbajtur lart fjalën e Tij!

Ishte dështim, për të cilin paguam një çmim shumë të lartë, kur humbëm në fushat e jetës. Menduam se shpërblimi i Allahut është në disa fjalë që thuhet, apo në formalitete sipërfaqësore që kryhen.

Imagjinoni një njeri me pozitë të lartë qeverisëse, ku u thotë vartësve të tij: Përpara jush është institucioni shtetëror, udhëhiqini atë për të vërtetuar ekzistencën tuaj dhe për të realizuar qëllimet. Po qe se ata do ta udhëheqin keq këtë institucion, duke u mbledhur sa për të folur, por jo për të vepruar dhe bashkëpunuar në dobi të punës, n.q.s eprori i tyre do t'i largonte nga institucioni nuk do të bënte padrejtësi.

Madje, edhe sikur të urdhëronte rojet për t'i rrahur nuk do t'u kishte bërë zullum. Ata janë me të vërtetë shkatërrues dhe jo të sinqertë!

Dikur në një kohë një grup besimtarësh e panë të arsyeshme që adhurimin e tyre ta kufizonin vetëm në namaz, përmendje të Zotit, duke i përsëritur e stërpërsëritur, duke menduar se popujt përparojnë me murmurima, papunësi, dembelizëm etj. Atëherë kush e ndihmon fenë e Zotit dhe të Dërguarin e Tij? Kur këta të jenë injorantë në nxjerrjen e hekurit, shkrirjen dhe përpunimin e tij? Kur Allahu thotë në librin e Tij: ***“Dhe Ne e zbritëm hekurin ku në të ka forcë të madhe, dobi për njerëzit dhe që ta dijë Allahu se kush e ndihmon Atë (fenë e Tij) dhe të dërguarit e Tij në mënyrë të fshehtë.”***<sup>3</sup>

Ekzistojnë rreth 70 procese civile dhe ushtarake që kanë lidhje me naftën, nxjerrjen dhe përpunimin e nënprodukteve të saj, për të cilat nuk dimë asgjë. Atëherë a i shërbejmë akides së tevhidit dhe gjithçka që ka lidhje me të, me gjithë këtë paaftësi dhe nënçmim?

*“Sikur t’u thuhej gjërave që ndodhen në vendet islame: Kthehuni andej nga kenë ardhur, do kisha pasur frikë se mos njerëzit do ecnin lakuriq e këmbëzbathur, nuk do gjenin, prej punimeve të duarve të tyre, çfarë të mbathnin ose çfarë të vishnin, në çfarë të hipnin dhe me çfarë të ndriçonin shtëpitë e tyre. Madje do isha frikësuar se mos pllakoste zija e bukës, sepse vendet e tyre nuk sigurojnë për vete as atë që u nevojitet për bukën e gojës”.*

Allahu nuk e pranon këtë fetarizëm, të cilin po e turpëron ky parazitizëm i paparë. Nuk e kuptoj se si pretendojmë besimin dhe xhihadin, kur ne po vuajmë nga ky parazit, i cili po bën të tjerët, në qoftë se dëshirojnë, të na ushqejnë e të na mjekojnë dhe, të na furnizojnë me armë. Pa dyshim ky është një parazitizëm që i hap rrugë dominimit të huaj.

Kam parë shumë të rinj, të cilët kanë dëshirë t’i shërbejnë fesë, por më frikëson mendjelehtësia e tyre e trashëguar. Ata nuk e konsiderojnë djersën e derdhur në kërkim të naftës, apo ndotjen e rrobave nga veglat e nxjerrjes së saj, nuk e konside-

3. Sureja Hadidë, ajeti 25

rojnë këtë gjë përpjekje dhe sakrificë. Tek ata sakrificë është vetëm leximi i Kur'anit, përmendja e Zotit dhe përsëritja çka t'u vijë më lehtë, mbasi vazhdojnë të kenë mjaft kohë!

Më ka sjellë rasti të njoh një farmacist, i cili ishte i zënë me kërkimin e çështjes, “namazi tehiyetul mesxhid”<sup>4</sup>, gjatë hytbes së xhumasë dhe shumë i interesuar për preferencat e secilit medhheb.

I thashë: Përse nuk ndihmon Islamin në specialitetin tënd dhe t'ia lësh këtë temë njerëzve përkatës që janë të zotë rreth kësaj çështjeje?

Me të vërtetë Islami, në fushën e farmaceutikës është i mposhtur! Sikur armiqtë e Islamit të mendonin për të helmuar ymetin tonë në këtë fushë, pa vështirësi do ta bënë dhe ju do të ishit të paaftë për ta mbrojtur!

A s'do kishte qenë më mirë për ty dhe për vëllezërit tuaj të prodhoni diçka për fenë tuaj në fushën, e cila është fare bosh, në vend që të hyni në preferencat mes shafijve dhe malikive?

Një student i fakultetit të kimisë më pyeti për një çështje jo të qartë në shkencën e teologjisë! Thashë me vete: çmimi Nobel këtë vit iu dha një grupi shkencëtarësh në fushën e kimisë, në mes tyre nuk ndodhej asnjë arab, ndërsa nevoja e myslimanëve për t'u thelluar në shkencën e kimisë është më se e domosdoshme.

Në disa libra të mi kam sjell shembuj se si arritën rusët të shfrosnin një fshat të tërë, duke përdorur mbi të një sulm kimik. Viktimat u harruan, pa u dëgjuar nga myslimanët asnjë lajm dhe ata nuk dinin gjë se çka kishte ndodhur apo çfarë po ndodhte.

Studentit që pyeti i thashë: Për ty, më mirë është që të largohesh nga kjo temë e t'i përvishesh me forcë asaj për të cilën je specializuar. Ne jemi shumë të varfër për talente në fushën ku jeni duke studiuar dhe shumë të pasur në fushën e filozofisë e të llafollogjisë.

Duke qeshur i kërkova të më ndiqte: dikur kimia në kohë-

4. Tehijetul mesxhid: namazi që falet si përshëndetje kur hynë në xhami.

ra të vjetra ka qenë e interesuar për shndërrimin e mineraleve jo të çmueshme në ar. Poetët kanë folur për kiminë e fateve, e cila ngre të përbuzurën në vende të larta!

Më pyeti përsëri dhe ai duke qeshur për këtë kiminë e fateve?

I përmenda dy vargje të Ibn Runit:

*“Me të vërtetë për fatin ekziston kimi  
kur ta prekin qenin e shndërronë njeri”  
Zoti ngre lart kë të dojë,  
kur të dojë dhe si të dojë, të jetë kush të jetë!*

S’ka dyshim që fati luan një rol të madh në jetë, por ai është rol dytësor dhe i kufizuar. Ndërsa lartësimi i popujve edhe rënia e tyre ka të bëjë me ligje rigorozë e forca plot seriozitet. Myslimanëve nuk u është bërë padrejtësi kur dëshatuan në garën e jetës! Ata keqinterpretuan domethënien e fetarizmit dhe me të drejtë pësuan disfatë.

U ktheva dhe i thashë: Thelloju në shkencën e kimisë, kjo është më e vlefshme për Islamin se sa të zhytesh në lexime fetare, specialiteti i cili nuk është detyrë e jotja, të mjafton dituria në fe, aq sa të përkushtojë zemrën tënde kur të lexosh Kur’an, pastaj ec pas të Dërguarit tënd të përkryer dhe mëso nga ai se si arriti të ndryshojë botën me emrin e Allahut.

U largova prej studentit i hutuar, pa e kuptuar nëse e binda apo jo!

Ai dhe shumë prej të rinjve mendojnë se devotshmëria ka të bëjë me shpenzimin e pjesës më të madhe të kohës në lexime fetare dhe përkushtimi në një pjesë fare të vogël të kohës për çështjet e kësaj bote dhe shkencat e jetës. Beto hem se, Islami s’ka për të pasur dobi nga kjo prirje, n.q.s ndjekësit e tij janë në marrëzitet e hindusëve, ndërsa armiqtë zotërojnë rrugët e universit!

Zotëro kontrollin e botës me dituri e aftësi, që të kesh mundësi të ndihmosh të vërtetën, të cilën e ke përqaftuar. Në rast se nuk vepron kështu do ta kalojnë të aftët e të zgjuarit!.

## Detyrat kolektive dhe ato individuale

Detyrat<sup>5</sup>, sipas juristëve, ndahen në dy pjesë: fard ajn<sup>6</sup> dhe në fard kifaje.<sup>7</sup>

Me fard ajn kemi parasysh atë detyrë që kërkohet prej çdo njeriu dhe për të cilën do të pyetet, ndërsa fard kifaje është detyrë kolektive, por nëse një njeri prej këtij kolektivi e kryen këtë detyrë, atëherë përgjegjësia shkarkohet nga të tjerët dhe nuk kërkohet prej tyre për ta kryer!

Nga ky kontekst, myslimanët e dinë mbi bazën e këtij përkufizimi se, po ta kryejnë disa atë detyrë, të tjerët nuk kanë përgjegjësi. Nëpër gjuhët e njerëzve nuk qarkullon, përveçse një shembull i vetëm i kësaj detyre e, ajo është namazi i xhenazes!

Shpjegimi i këtyre dy detyrave nuk shprehet qartë me këtë metodë të mangët. Keqinterpretimi i saj në fushën e edukimit e të përgatitjes, i ka bërë myslimanët të sillen pa kujdes në çështjet që prekin jetën dhe ekzistencën, ku ngrihet lart, apo bie poshtë flamuri i tyre.

Detyrat kolektive kërkojnë nga shteti dy gjëra, të cilat burojnë që të dyja nga përgjegjësitë e tij.

Gjëja e para: bindja e plotë se këto detyra kanë gjetur numrin e mjaftueshëm të specialistëve për t'i bërë ballë detyrave. P.sh në qoftë se populli ka nevojë për 100 mjekë dhe nuk gjenden veçse 50 të tillë, shteti duhet të interesohet për plotësimin e numrit të mjaftueshëm, i cili siguron shëndetin e përgjithshëm dhe nuk lejohet aspak që të neglizhohë në këtë detyrë.

Gjëja e dyta: të ndjekë me mjetet e tij mënyrën e kryerjes dhe seriozitetin e punës, në mënyrë që interesi i përgjithshëm të jetë në baza të shëndosha..

Populli, i cili është i paaftë të shfrytëzojë begatitë e Zo-

5. Farzet

6. Detyrë individuale

7. Detyrë kolektive



tit xh.sh në tokë, nuk do të mund të kryejë ashtu siç duhet mesazhin e Tij. Populli, i cili është i pafuqishëm të mobilizojë dhuntitë e myslimanëve, me duart e tij hedh veten në shkatërrim.

Le të pyesim se, sa uzina armësh duhen ndërtuar për të ndihmuar të pafuqishmit? Sa specialistë duhen përgatitur për t'ia arritur këtij qëllimi?

Ndoshta detyra individuale mund të përfshijë shtyllat e adhurimeve, si: namazin, zeqatin etj., shtyllat e moralit si: singëritetin, turpin. Ndoshta mund të përfshijë largimin nga mëkatet e mëdha dhe, të gjitha këto në pjesën më të madhe kanë të bëjnë me ndërgjegjen e personit dhe me karakterin e tij të veçantë.

Ndërsa detyra kolektive ka të bëjë me ruajtësit e rendit, gjykatat, postet e ndryshme zyrtare, ngritja dhe zhvillimi i arteve dhe i arkitekturës që shërbejnë në ndërtimin e pallateve dhe, të tjera si këto.

Bashkësia njerëzore është një bashkësi me interesa të ndërthura. Njerëzit, të gjithë kanë nevojë për njëri-tjetrin. Aparati drejtues, kulturor, shëndetësor, ekonomik dhe ushtarak, në qenien e shoqërisë i përngjan aparatit nervor, tretës, atij të frymëmarrjes e të qarkullimit të gjakut në trupin e njeriut. Nga këtu kuptojmë se, detyrat individuale dhe detyrat kolektive ndërthuren në jetën e përgjithshme plotësisht me njëra-tjetrën.

Le ta sqarojmë më tepër çështjen. Namazi është detyrë individuale, sepse çdo mysliman mund ta kryejë këtë detyrë, prandaj askush nuk është i përjashtuar prej saj. Ndërsa drejtësia, mësimdhënia, inxhinieria janë detyra kolektive, sepse jo çdokush është i aftë për të qenë gjykatës, mësues apo inxhinier.

D.m.th, në qoftë se ndonjë kandidat për gjykatës me kualifikimin përkatës caktohet nga shteti në këtë post të përshtatshëm për të, atëherë kryerja e detyrave që kërkon ky post kthehet në detyrë individuale, sikur namazi dhe agjërimi dhe, në asnjë mënyrë nuk i lejohet që të neglizhohet, apo të shpërdorohet detyrën, sepse çdo nënvleftësim apo abuzim kon-

siderohet mëkat ndaj Zotit e, nuk i pranohet justifikimi se ky abuzim ka ndodhur sepse ajo është detyrë kolektive.

Sakrifica e njeriut dhe përpjekja e tij duhet të ndahen në mënyrën më të drejtë mes namazit që është detyrë individuale për të dhe, kryerjes më përpikëri të detyrës së gjykatësit që i është ngarkuar, në mënyrë që, drejtësia të mbulojë gjithë shoqërinë dhe të çojë të gjitha të drejtat në vendin e tyre. Ndoshta, mësimi i çështjeve të drejtësisë zgjat dhjetë fish më tepër se, sa koha për mësimin e namazit! Po le të jetë më tepër se, siç është namazi adhurim edhe drejtësia është adhurim.

Ajo që thamë për drejtësinë thuhet edhe për mësimdhënien, mjekësinë dhe për çdo profesion për të cilin ka nevojë shoqëria. Shoqëritë njerëzore, në të pesë kontinentet, e kuptojnë këtë realitet të vërtetë dhe krijojnë mijëra e mijëra vende pune e profesione të ndryshme. Ndihejmojnë me mijëra njerëz dhe shpenzojnë shuma të mëdha nga buxhetet e tyre që t'i sigurojnë këto interesa. Të gjitha vendet e punës, pa përjashtim janë amanete, përgjegjësi dhe realizimi i tyre është një e drejtë që duhet zbatuar.

Por ndër myslimanët, ku është për të ardhur keq, ka njerëz dhe drejtues të atillë, të cilët renditën në vendin e parë për humbjen e amaneteve, të premtimeve, ndërsa punët zyrtare janë të kërcënuara. Posti, apo vendi i punës, në shumicën e rasteve është më tepër burim për të marrë se, sa mjet për të dhënë!

Injoranca e myslimanëve për obligimet kolektive, natyrën dhe ndikimin e tyre, është skandaloze. Kjo ndodhë, sepse tek disa “fetarë”, ka dallim mes formave të adhurimeve të obliguara dhe kryerjes e punëve civile të ndryshme. E para, adhurimi i obliguar, tek ata konsiderohet fe, ndërsa e dyta nuk është adhurim, veçse rastësisht.

Kam parë disa prej tyre ndenjor nëpër zyra me një parqitje të lodhur, ku njerëzit i vijnë për nevojat e tyre dhe, ata i mbarojnë punë kur të donë, e neglizhojnë sa të donë. Dhe kur afrohet koha e namazit të drekës, fillojnë të përgatiten përpara kohe.

Njërit prej tyre i thashë: *“Ajo që po lë pa bërë nuk është me*

më pak rëndësi se sa ajo që do të bësh.. Shkathësia jote në kryerjen e nevojave të njerëzve në një kohë sa më të shkurtër e në formën fetare më të mirë është vaxhib<sup>8</sup>, si namazi e agjërimi”.

Më tha: “Ne po përgatitemi për namazin që është obligim dhe, punën tonë do ta bëjmë pasi të kryejmë të drejtën e Zotit!”

I thashë: “Bukur, të jesh i kujdesshëm ndaj namazit që është obligim në kohën e tij, por s’do të thotë patjetër ta kryesh atë në fillim të kohës apo në mesin e saj! Do të ishte më mirë për ty t’i mbaroje punë këtij njeriu, i cili ka ardhur nga një vend i largët, i shqetësuar për nevojat që ka, pa harruar se namazi edukon njeriun të jetë i ndjeshëm me përgjegjësinë për detyrën. Namazi nuk zgjat më tepër se disa minuta”.

Ne, kështu nuk e nënvleftësojmë vlerën e namazit që është obligim dhe faljen e tij brenda kohës, por ne mundemi të vëmë rregull në kryerjen e tij me xhemat në fillim të kohës dhe, të tjerët ta kryejnë p.sh pas mbarimit të orës së mësimimit në shkollë, në fabrikë pas mbarimit të turnit, në spital kirurgët dhe infermierët pasi të kenë kryer planifikimet e tyre, duke i caktuar për këtë gjë një kohë të drejtë, në mënyrë që të mos e shfrytëzojnë rastin njerëzit përtacë.

Të konsiderosh punë e ndryshme publike e shoqërore gjë pa vlerë, punë kote, ose diçka që lejohet neglizhenca, mungesa e seriozitetit apo, do ta bëj kur të kem kohë, e gjitha kjo quhet humbje e një obligimi dhe, humbja e tij është e ndaluar!<sup>9</sup>



---

8. Detyrë.

9. Haram.

## Detyra dhe vullnetarja

Në vargun e nënvleftësimit të detyrave kolektive, një njeri vendosi të shkojë për haxhin nafile<sup>10</sup>, më duket se për herë të tretë.

I thashë: “*Sa kushton ky haxh? Afërsisht 1000 xhunejh*”<sup>11</sup>?

Më tha: “*Madje edhe më tepër*”.

I thashë: “*A të tregoj për diçka më të mirë? Një student mbaron fakultetin e mjekësisë dhe është i varfër. Banorët ku ai jeton kanë nevojë për një farmaci, jepi këto para studentit të diplomuar të fillojë jetën duke i bërë dobi atij dhe gjithë popullit e, tek Zoti xh.sh do të kesh shpërblim më të madh se ky haxh që do të bësh!*”

Më shikoi me habi dhe thërriti: “*A mund të thuhet kjo fjalë?*”

I thashë: “*Në qoftë se ti më dëgjon ke bërë një farz*<sup>12</sup>, ke mbyllur një boshllëk dhe ke marrë pjesë në një sakrificë me fryte të mëdha, në vend të këtij haxhi vullnetar të cilin ke vendosur ta bësh”.

E ai i habitur vazhdoi e tha: “*Të lë haxhin! Dhe të ndihmojë në hapjen e një farmacie, çfarë është kjo?*”

Me të vërtetë një pjesë e madhe e myslimanëve nuk arrijnë t’i kuptojnë përmasat e tragjedisë, të cilën po jeton sot ymeti. Madje nuk arrijnë ta kuptojnë as shkallën e prapambetjes së tmerrshme, e cila po kërcënon të sotmen dhe të nesërmen tonë dhe, prej saj ai humbet në fenë e tij, një humbje trashanike!

Diku në librat e mi kam përmendur thënien e dijetarëve se, Allahu nuk pranon punën vullnetare derisa të kryhet puna e obliguar, ku puna e obliguar është e njëjtë si ajo individuale, ashtu edhe ajo kolektive.

10. Jo të detyrueshëm, vullnetare.

11. Paraja që përdoret në Egjipt

12. Detyrë

Thashë: N.q.s nafilja<sup>13</sup> të pengon në përsosjen e vaxhibit<sup>14</sup>, atëherë pse të ekzistojë?

Për këtë solla një shembull:

Në rast se agjërimi vullnetar pengon mësuesin në korrigjimin e fletëve të provimit në formë të saktë, atëherë ai nuk duhet të agjërojë, kështu edhe për doktorin, n.q.s agjërimi vullnetar e pengon të kryejë si duhet kontrollin e të sëmurit, ekzaminimin e sëmundjes apo dhënien e mjekimit të përshtatshëm!

*“Zoti yt e di se ti dhe një grup i atyre që janë me ty, kaloni në adhurim më pak se dy të tretat e natës ose gjysmën e saj, a një të tretën e saj. Allahu e di gjatësinë e natës dhe të ditës dhe Ai e diti që ju nuk do të mund t’i përmbaheni asaj, andaj u lehtësoi juve, pra faluni duke lexuar Kur’an sa t’ju vijë më lehtë”<sup>15</sup>.*

Për pasanikun, adhurimi i parë për të, është shpenzimi dhe ndihma për nevojtarët dhe, nuk e ka të drejtë të agjërojë apo të falet natën<sup>16</sup> n.q.s agjërimi dhe falja shërben për të si mjet për shmangie nga shpenzimi në rrugë të Allahut.



---

13. Vullnetarja

14. Detyrës

15. Sureja Muzemmil, ajeti 20

16. Kijamul lejl

## Fetarizmi dhe lidhja e tij me begatitë e Zotit në gjithësi

Ka dhe diçka tjetër, e cila ka lidhje me mesazhin e fesë, në mesin e të gjallëve. Me të vërtetë unë urrej fetarizmin e distancuar nga bukuria e gjithësisë dhe madhështia e saj, fetarizmin shterp, që nuk kupton sekretet e gjithësisë dhe nënshtrimin e saj në dobi të interesave njerëzore.

Për disa çaste, kur po lexoja Kur'an, më mbërthyen ndjenjat se, Zoti xh.sh. dëshiron të kthejmë vështrimin nga krijimi i Tij, në njerëzit dhe horizontet. Kërkon të nxisë ndjenjat tona në atë që ekziston në gjithësi prej saktësisë, përpikërisë, bukurisë dhe fuqisë. Kërkon nga njerëzit të vështrojnë argumentet e madhësisë së Tij në këtë gjithësi, e cila dëshmon, ditën dhe natën, për Zotin që është Rregullatori i saj.

A mos ndoshta Zoti betohet në elementet e gjithësisë kotë së koti? Shikoni tek kjo panoramë!

*“Betohem në dritën e kuqe (muzgun) e perëndimit. Në natën dhe çka mban ajo. Në hënën kur merr formën e saj të plotë...”*<sup>17</sup>

Patjetër është një pamje origjinale e horizontit të kuqërremtë, të cilin e pason perëndimi i diellit dhe dalja e hënës. Pastaj një panoramë tjetër e asaj që e ndjek pas këtë moment kohe:

*“Pasha natën që vjen me errësi dhe mëngjesin kur agon”*<sup>18</sup>

Bota po lëviz dhe dridhet me flade zgjonjëze të hershme!

Ai që krijoi qiejt e tokën dhe vendosi dritën e errësitat, kërkon nga ne të zbulojmë cilësitë e Tija, anekënd mbretërisë së Tij. Që të shikojmë tek bota se, ajo është vendi i shpalosjes së emrave të Tij të bukur, ku më pas të ndërtojmë cilësitë tona me besim të fortë dhe bindje të plotë, të udhëzohemi me dritën e Tij. Ne punojmë në tokë si për t'u përgatitur për udhëtimin e kthimit, udhëtim që patjetër do të vijë.

17. Sureja Inshikak, ajeti 16-18

18. Sureja Tekvir, ajeti 17

*“Ai është, i Cili ju krijoi juve prej balte pastaj caktoi exhelin (afatin) dhe exheli (afati) i caktuar ndodhet tek Ai”<sup>19</sup>. Vërtet është për t’u habitur; të jetojnë myslimanët prej disa shekujsh dhe nuk dinë asgjë nga ajo që thuhet për gjithësinë! Të jenë shkencat e saja dytësore në kulturën e tyre, si tek intelektualët ashtu edhe tek njerëzit e thjeshtë. Të jetë dituria për sekretet dhe energjitë e saja prej gjërave luksoze pa rëndësi të madhe tek disa dhe, si diçka qesharake e kotë te disa të tjerë!*

Çfarë e ka mbërthyer interesimin e tyre mbi artet e dijes? Në kohën kur myslimanët u larguan nga studimet e gjithësisë, të tjerët u thelluan në atë rrugë, korrën suksese të habitshme, pastaj i vunë në shërbim të besimeve të tyre dhe filozofive të pavlera! Pa dyshim këtë ndarje mizore mes fesë nga njëra anë dhe, jetës e gjithësisë nga ana tjetër, Islami e refuzon me plot gojë dhe kërkon nga robërit e mirë të Zotit një rrugë tjetër, e cila me forcë e kundërshton këtë ndarje.

Ndoshta mund të thuash: *“Ne e dimë këtë gjë dhe s’po na flet diçka të re!...”*

Përgjigjem: *“Nuk pushojnë së renduri të rinjtë, të cilët dëshirojnë kthimin e të punojnë për Islamin, t’i kthejnë shpinën botës dhe shkencave të saja, t’i zbrazin çantat e tyre nga kërkimet hulumtuuese të energjive të ndryshme jetësore dhe, mendojnë se dhikri, përmendja e Allahut, e falënderimi në adhurim janë rilindje!”*

Mora pjesë në një seminar për çështjet të thirrjes, i cili u mbajt në Noakshut, kryeqyteti i Mauritanisë. Në atë vend, pashë një grup prej komunistëve kinez, të cilët nuk punonin për qiellin, por për tokën. Kishin arritur të zbulonin burime të pastra uji dhe kishin shtrirë tubat e ujitjes nëpër tokat e thata që kishin nevojë për ujë!

Gjithashtu kam parë disa prej komunistëve kinez në Jemenin lindor, duke çarë zemrën e Saharasë me rrugë të asfaltuara në mes të vargut të maleve! Thashë me vete: Nga fundi i lindjes, prej larg e më larg, kanë ardhur që të ndërtojnë në vendet tona! Po çfarë punojmë ne?

Ndjeva zemërim të madh kur mora vesh se Katari myslimi-

19. Sureja En’am, ajeti 2

man eksportonte grurë, ditëve kur ishte i kolonizuar, ndërsa kur fitoi pavarësinë dhe, qeverisja ra në duart e banorëve të saj, toka u tha dhe filloi importimi i grurit nga jashtë!

Më erdhi turp, kur po numëroja shtetet e industrializuara dhe nuk gjeta mes 10 të parave, as 10 të dytave e, as... të paktën një shtet islam të vetëm!!

Dihet që Japonia filloi mëkëmbjen e saj, afërsisht përpara një shekulli dhe, po në të njëjtën kohë filluan edhe disa shtete islamike. Ndërsa Japonia arriti deri në maja të zhvillimit, ne mbetëm të varfër. Cili është shkaku? Ndoshta rol të madh mund të ketë prishja politike, por prishja kulturore, për mendimin tim, ka një rol kryesor.

Çfarë mund të thuash për djelmosha, të cilët duan të nderin beteja për disa çështje fare të vogla në veshje dhe të tjera, kur këto janë më afër synetit të traditës, se sa synetit të adhurimit dhe, ndoshta gjërave parësore i vjen fundi.

Fenë e Allahut nuk kanë fuqi ta mbajnë dhe as ta ruajnë dështuesit në fushat e civilizimit njerëzor, llafazanët e botës së fshehtë, gajbit, memecët e botës së dukshme.

Ndjej se detyra e myslimanëve për t'u thelluar shkencërisht në shërbim të fesë dhe të dynjasë së tyre, ka nevojë për një shpjegim të madh, sepse kënaqësia e injorantëve me atë që kanë prej njohurive të rreme, është neglizhencë e çështjes që nuk përballohet dhe, në rast se nuk ua bëjmë të qartë të gjithë realitetin, të vërtetën, ymetit tonë, atëherë ai dhe ne së bashku jemi të destinuar të shkatërrohemi.





## Diçka për përparimin shkencor

Le t'i shkëpusim disa fragmente seminarit të mbajtur nga dr. Muhammed Kamil me disa shkurtime:

Pothuajse para një shekulli e gjysmë filloi praktika e kësaj shkencore në fushat e industrisë, bujqësisë, mjekësisë etj. Një shkencëtar anglez arriti të prodhojë përbërje kimike me ngjyrë që zëvendësonin kromozomet natyrore të njohura dhe, si rrjedhojë e këtij zbulimi u shfaqën bojërat, barërat, plehurat kimike, insekticidet, dizifektantët etj. U përdorën të gjitha mënyrat shkencore në të gjithë industrinë dhe u futën së pari në konkurrencë të kësaj fushe, Anglia, Franca dhe Gjermania, pastaj i ndoqi edhe SH.B.A. në shekullin e kaluar dhe, së fundi B. Sovjetik e Japonia.

Pas luftës së II botërore zhvillimi u bë një gjë e lehtë duke ecur me hapa gjigantë dhe me një mesatare tepër të lartë! 80% e të ardhurave në shtetet e industrializuara vinin si pasojë e kësaj konkurrence dhe, vetëm 20% ishin rrjedhojë e akumulimit të kapitalit.

Njerëzit kuptuan rëndësinë e përparimit shkencor në të dy drejtimet, teorike e praktike dhe filluan të drejtohen tek ai, ndërsa ajka e shkencëtarëve në shtetet e mëdha ishin të zënë tani dhe për disa vite të tjera, me kërkimet e kores së Tokës dhe përbërjes së saj prej jetës së gjallë, ujit dhe ajrit.

Tashmë, ata kanë vërtetuar një teori të përbërjeve minerale tokësore! Me këtë teori lidhen drejtpërdrejt disa çështje, si: mundësia e gjetjes së pasurive minerale, naftës dhe të fushave të gazit natyror, zgjedhja e vendeve ku do të groposen mbetjet e ndryshme kimike, atomike, bakteriologjike pas përdorimit të tyre. Ata vëzhgojnë lëvizjet e komplikuar të oqeanëve dhe të rrymave të tyre, njohjen e bazave për ndryshimin e motit, parashikimin e thatsirave, pamje të fundit të deteve dhe nxjerrjen e smeraldeve nga shkëmbinjët e tyre, rrezikshmërinë e rritjes së karbonit në atmosferë etj.

Pastaj, përsëri eksperimentim të gjerë shkencor në zbulimet hapësinore, punën e sateliteve artificial dhe studimin

e pamjeve, të cilat na i sjellin këto satelite për çka ndodh në sipërfaqen e Tokës, të lëvizjeve civile e ushtarake dhe, mundësinë e përfitimit nga këto satelitë në botën e madhe të informacionit.

Lektori vazhdonte të fliste për hapësirat bashkëkohore të përparimit shkencor. Ndërsa trokiti në shkencën e biologjisë, ai tha se me të vërtetë në këtë fushë ishte bërë një hap i madh. Ajo, mbasi kishte qenë thjesht një shkencë që studionte sjelljet e përbërjet e të gjitha gjallesave dhe shpjegonte detyrat e pjesëve përbërëse, u shndërrua në një shkencë eksperimentale që i kushton vëmendje të madhe ndërtimit të qelizave të gjalla që nga formimi i tyre i parë me ndihmën e aparateve të reja si p.sh.: mikroskopët elektronikë, të cilët kanë aftësi t'i zmadhojnë gjërat mijëra herë, aparate centrifugale, të cilat dhanë mundësinë e ndarjes së pjesëve qelizore dhe nëndarjet e tyre.

Rrezet X, të cilat japin një imazh pamjesh të ndërtimit kristalor të sendeve, tingujt magnetik-nuklear, të cilët ndihmojnë në ndërtimin e thërrmijave, pa përmendur këtu hapat e mëdha që janë bërë në përdorimin e teorisë rrezatuese!

Shkencëtarët kanë arritur, me ndihmën e këtyre mjeteve, të transplantojnë qelizat, kromozomet, genet, që mbajnë kodin përgjegjës të trashëgimisë, nga një gjallesë tek një tjetër.

Lektori tha: *“Shkencëtarët janë drejtuar me kërkimet e tyre në fushat e trashëgimisë inxhinierike tek bakteret dhe viruset e nga aty te gjallesat me komplikim më të madh, mbasi siguruan garancitë e duhura ku edhe mbikëqyrësit më pas u qetësuan. Kërkimi u ngrit nga Toka për në Qiell, pamjet e vizatuara tashmë në mendjet e shkencëtarëve se gjithësia përbëhet nga miliona galaktika të shpërndara në hapësirë në të gjitha drejtimet në formë simetrike, se kjo gjithësi zgjerohet dhe ndoshta vazhdon kështu derisa të shpërthejë”.*

Bëra këtë përmbledhje që myslimanët të ndiejnë sadopak se rreziku i armikut të tyre patjetër do vijë, se largimi nga gjithësia e shkencat e saja është krim për Islamin dhe për qafuesit e tij dhe, se ndihma e të Vërtetës me të cilën Allahu na ka nderuar, nuk plotësohet me prapambetje shkencore dhe as duke e konsideruar fenë si një grumbull ritualesh të

brendshme. Në qoftë se adhurimi, në namazin plot frikë e përqendrim, është bashkëbisedim me Allahun, gjithashtu edhe studimi shkencor në gjithësinë e Tij të madhe është i lavdëruar.

Prej shenjave të shkëlqimit të kulturës sonë të vjetër janë dhe këto fjalë të Ibnul Xhevzij, me të cilat bën thirrje për lartësimin e përpjekjeve dhe kërkon prej myslimanit që të jetë kërkuesi dhe hulumtuesi i parë në çdo fushë. Ai thotë: *“Duhet që i mençuri mysliman të vendosë një synim, aq sa ka mundësi dhe, sikur të imagjinohej që njeriu të ngrihej në qiell, do ta konsideroja prej të metave më të këqija qëndrimin e tij në tokë!”*

Ibnul Xhevzij është prej dijetarëve të shekullit të VI hixhrij. Sikur të shikonte myslimanët tani, në kohën e hapësirës duke parë betejat e hapësirës si budallenj, do kishte marrë kamxhikun për t'i qëlluar dhe, të shfajësonte Islamin prej këtij qëndrimi skandaloz!

Tani, dua të sjell një thënie të Imamul Haramejn, i cili flet për detyrat kolektive dhe, qëndrimin që duhet mbajtur kur detyra kolektive ballafaqohet me detyrën individuale.

*“Ajo, të cilën e shoh të arsyeshme të them për dy llojet e detyrave, është se, realizimi i asaj që është detyrë prej detyrave kolektive është në shkallën më të lartë dhe më e pëlqyeshme se sa mund të jetë realizimi i një detyre individuale! Sikur robi përgjegjës të lërë një detyrë individuale të caktuar, duke mos ju bindur një urdhri të Zotit, mëkati bie vetëm mbi të dhe, po qese e kryen, ka fituar shpërblimin. Por, në qoftë se supozohej lënia e një detyrë kolektive, mëkati do të përfshinte të gjithë myslimanët sipas gradës së përgjegjshmërisë së tyre. Kështu pra, ai që e kryen këtë detyrë kolektive, ka mbrojtur veten dhe të tjerët prej belasë së dënimit dhe shpreson shpërblimin me të mirë. Atëherë mos të nënvleftësohet dhe neglizhohet asnjë përpjekje e atij që zë vendin e të gjithë myslimanëve për çështje të fesë”.*

*“Pastaj ajo që quhet detyrë kolektive për disa njerëz mund të bëhet detyrë individuale në situata të caktuara. Kështu, në qoftë se dikujt i vdes shoku i tij në udhëtim dhe askush nuk merr pjesë në vdekje përveç tij, për të bëhet detyrë individuale larja, qefinosja dhe varrimi i shokut, etj”.*

Kështu ka vazhduar Imami me metodën e tij të mençur

në shpjegimin e domosdoshmërisë të të qenit syçelur për detyrat kolektive.

Java e punës në vendet e përparuara zgjat vetëm 40 orë! Mjaftojnë për çdo gjë që kërkon populli, prej punëve që sigurojnë ekzistencën, suksesin dhe mbajtjen lart të emblemës së tij. Ndërsa ajo që mbet prej (168) orëve shërben si dëfrim për individin, gëzimin dhe çlodhjen e tij. Feja nuk ia ka pjesëtuar njeriut orët e jetës së tij në këtë mënyrë. Ajo ka caktuar për adhurimet e mirëfillta veçse disa pjesëza kohe të kufizuara! Ekziston mundësia për çdo njeri që të kthejë ushqimin dhe fjetjen e tij në adhurim duke pasur nijetin e mirë, d.m.th përmes këtyre veprime ka për qëllim fitimin e kënaqësisë së Allahut dhe mirësitë e Tija.

Mundet që çdo njeri të kthejë cilëndo punë të tijën, në tokë, det dhe ajër, në adhurim të Allahut, po me këtë nijet të mirë.

Kur Allahu urdhëroi namazet e detyruara, Ai caktoi për to kohë të gjerë dhe kohë emergjente. Prandaj ka mundësi të bëhet një koordinim i bukur mes detyrave të Zotit dhe çdo pune tjetër!

Baza, nga e cila nisemi, është të njohim veten tonë, të bëhemi të vetëdijshëm se jemi anëtarë të mesazhit qiellor, i cili nuk fiton përveçse në qoftë se zotëron mirësitë e begatitë e Tokës dhe i vendos ato në shërbim të këtij mesazhi. Tek ne dhe, vetëm tek ne, janë mendimet e shpalljes dhe fjalët e saj të fundit. Në qoftë se dështojmë në vlerësimin e pasurisë sonë dhe në mbledhjen e energjive të gjithësisë për përmbushjen e të vërtetës dhe shkatërrimin e të keqes, atëherë të mos fajësojmë askënd, përveç se veten tonë.



## KAPITULLI II

### Në kulturë, edukim dhe moral

Studimet tradicionale tek ne, apo siç quhen në Algjeri “studimi origjinal”, et-tealimul-aslij, ose siç e quaj unë, kultura kombëtare e ymetit Islam, është një lloj i njohjes, ku rëndësia e saj përçmohet!

Kultura kombëtare është një gjë dhe thënia se dituria e cila s’ka atdhe, një gjë tjetër! Dituria e zakonshme, si inxhinieria, matematika, fizika, kimia, biologjia, mjekësia, arkitektura dhe artet ushtarake e civile, të gjitha këto janë të përhapura në pesë kontinentet, ku njerëzit bëjnë gara në përvetësimin e tyre sa më të mirë dhe nuk përtojnë e flasin për arritjet e tyre.

Ato, në përgjithësi janë mjete në shërbim të popujve dhe mesazheve të tyre të ndryshme në këtë jetë. Pra, rriten e shtrihen nën kujdesin dhe porositë e kulturës kombëtare të çdo populli, sepse kjo kulturë pasqyron personalitetin e popullit, tiparet e tij mendore e personale, shpjegon shtyllat e besimit prej të cilave niset, parimet në të cilat mbështetet, traditat, edukatën dhe ligjet e saja, duke filluar nga familja deri tek marrëdhëniet ndërkombëtare. Gjithashtu shpreh letërsinë, gjuhën, të veçantat e poezisë dhe të prozës së saj. I kushton rëndësi historisë për të lidhur brezat e kaluar me brezat e ardhshëm dhe, lidh besnikërinë e veçantë e të përgjithshme me kushtet e vendosura dhe ligjet e qarta.

## Kultura kombëtare

Kultura kombëtare është pasuri me shumë vlerë përcaktuese për një popull.

Nga këtu, kolonizatori u drejtua për të goditur këtë kulturë dhe, të dobësujë institutet e saj, ta zhdukte, ose ta paralizonte lëvizjen e saj, duke e lënë atë shterpë, apo emër pa gjë. Kjo është ajo që ndodhi në Universitetin El-Karavijjin, Ez-Zejtune, Al-Ez'her dhe Universitetet islamike në Libi, Sudan e në vende të tjera. Si rrjedhojë e kësaj pasuan dy gjëra të rrezikshme: **shuarja e mendimit islam dhe dobësimi i studimeve fetare**, pastaj shuarja e gjuhës arabe dhe literaturës së saj, tkurrjen e saj përballë përparimit qytetërues, pakësimi i folësve të saj dhe shtim e atyre që flasin pa pikën e turpit me gabime.

Mbasi politikanët arabë dhe udhëheqësit e tyre janë prej të diplomuarve në studimet jofetare, më shumë se 99% e tyre ndodhen larg në mendime nga kultura jonë kombëtare, si pasojë e kësaj, progresi islam herë përparon e herë mbetet prapa. Edhe në qoftë se përparon ndonjë hap, me vështirësi të vazhdueshme e bën.

Ndërsa të flasësh për vetë fenë, është bisedë e lodhshme dhe kujtesë për diçka që ka vdekur, ose që duhet të vdesë. Por kjo ndjenjë mbështillet me urrejtje, me shprehje të bukura, ose respekt artificial, për t'u mbrojtur nga zemërimi i popullit.

Në një shoqëri të nënçmuar, e cila i ka humbur vlerat e saj, ose ka degraduar, feja konsiderohet prapambetje, namazi zënie e kohës dhe agjërimi pengesë e prodhimit.



## Shkencat njerëzore dhe lidhja e tyre me kulturën kombëtare

Le t'i kthehemi bisedës rreth kulturës kombëtare dhe asaj të përgjithshme e të pyesim: A janë shkencat njerëzore prej llojit të parë apo të dytë? Shkencat njerëzore përfshijnë psikologjinë, sociologjinë, etikën, sjelljen, ekonominë, politiken, menaxhimin, historinë etj, ndoshta përfshijnë edhe disa filozofi fetare e jofetare.

Temat e tyre përfshijnë lidhjen e njeriut me veten e tij dhe me të tjerët, ku në sfera të ndryshme të tyre ndërthuren me Islamin në fusha të gjëra. Ne duhet të përfitojmë nga këto studime duke theksuar atë që Islami ka thënë rreth këtyre çështjeve.

Shkencat njerëzore ndonjëherë janë përshkruese të gjendjeve individuale e shoqërore. Puna e tyre karakterizohet në këtë fushë me të shumtën e rasteve me sinqeritet dhe paanshmëri. Kanë vendosur ligje të mira, që përputhen me zanafillën, e cila është cilësia e parë e Islamit. Ndoshta planifikojnë metoda të mira për qëllime që edhe feja i mbështet dhe lënë të lirë atë që mund të arrijnë përpjekjet tona të zakonshme.

Përkrah gjithë kësaj, ata kanë në mesin e tyre gabime e teori të përhumura, por sidoqoftë Islami në rast se flet për diçka, është më i drejtë dhe më i besueshëm .Baballarët tanë iu futën filozofisë greke dhe veprimtarisë së saj mendore. Dikush u sprovua me të deri në kufijtë e harresës, të tjerë e refuzuan plotësisht dhe, grupi i tretë mori, ktheu, shikoi dhe kritikoi!!...

Habitem me të vërtetë, prej mendimtarit mysliman, i cili pranon mitologjitë e vjetra të mendjeve që i krijoi Aristoteleli dhe prej mendimtarit tjetër, i cili pranon gjeputat e përmendura në qytetin e Platonit, e as që di shkakun e këtyre moskokëçarjeve.

Kemi mësuar një pjesë të mirë të shkencave njerëzore në rininë tonë dhe përsëri vazhdojmë t'i ndjekim leximet dhe diskutimet në shumë çështje. Ata bien në kundërshtim me

realitetin moral dhe material të të gjithë njerëzimit, duke ditur se njohja e këtij realiteti është gjë që kërkohet.

Ndoshta ata mundën të japin sugjerime të dobishme për njerëzimin, më të mira se sugjerimet, të cilat i shfaqin fetaristët e rremë ose sipërfaqësorë për rregullimet e përgjithshme, ngase gjenden në mesin e fetarëve për fat të keq, që ligjet kushtetuese i quajnë si bidate të papranueshme, sepse disiplinimi i gjërave që e prishin abdesin, janë më të rëndësishme tek ata sesa disiplinimi i marrëdhënieve mes gjykatësit dhe të gjykuarit!





## Nevoja për gjallërimin e kulturës personale

Ndjej në këto ditë se nevoja për të ngjallur kulturën personale është shumë e madhe, për të pastruar atmosferën e saj dhe për të zgjeruar shtrirjen e mëtejshme, sepse kolonizatori kulturor ateist ka arritur sukses në shkatërrimin e personalitetit tonë kuptimor, në prishjen e mendjeve të mijëra njerëzve nga besimi ynë, ashtu siç pati sukses në shturjen e gjuhës sonë, në palosjen e strukturës tonë dhe në nëpërkëmbjen e të drejtave tona, duke na futur në shoqërinë ndërkombëtare, pa asnjë tipar dallues të vërtetë dhe pa asnjë identitet të veçantë. Kjo është ajo humbja e plotë!!

Ndoshta, dikush prej nesh mundet të marrë grada shkencore në mjekësi, jurisprudencë. Ndoshta, mund të emërohet në postet më të larta në Evropë apo Amerikë, por lidhja e tij me fenë e vet është zero. Marrëdhëniet e tij me kombin janë gjithashtu zero. Në të njëjtën kohë, kolegu i tij hebre është si uragan në shërbim të sionizmit dhe kolegu i tij i krishterë është më i shpejtë se vetëtima në shërbim të kolonizatorit! A mundet që ky mysliman me ndjenja të ftohta, t'i bëjë ndonjë dobi popullit të vet? Pa dyshim ai i ngjan një mercenari që me armën e tij i shërben çdo parimi për një copë bukë dhe për thërrimet e kësaj bote.

Përhapja e arsimit në vendet tona, duke e zhveshur atë nga kultura jonë kombëtare dhe përkatësia jonë e kufizuar, është një gjë e dëmshme dhe s'të gëzon aspak, të shqetëson dhe s'të lë të qetë.

Kur të kthehemi tek ligjet tona shpirtërore e intelektuale, pa dyshim që duhet të largohemi nga shumë gjëra të ndaluara.

- Shtyllat e fesë tek ne janë shumë më pak në sasi dhe formë, sesa librat që i shtjellojnë ato. Debate boshe të mbledhur në to, i kanë shumëfishuar çështjet e tyre pa as më të voglin shkak. Kryesorja është që të përkrahen me zemër, të shndërrohen në forcë shtytëse dhe në dritë që ndriçon rrugën.

- Adhurimet dhe shkencat e tyre nuk janë dete të kohës pa brigje. Ato në fenë tonë janë të lehta në kuptim dhe në realizim.

Ka disa njerëz që kanë qejf të shpjegojnë pastrimin<sup>20</sup> e namazit, në një muaj kohë! Të parët, të mëdhenj e mësonin fenë e tyre me orë të pakta, çanin fushat e jetës me islamin e tyre, me shpirtin e tij, duke u nisur prej qëllimeve të tija me seriozitet e me sinqeritet.

Po, ndoshta mund të ketë njerëz të specializuar në studime të caktuara dhe për specializimin ekzistojnë njerëzit dhe kushtet që duhen, ashtu si dhe në çdo fushë tjetër shkencore.

- Ngritja e personave mbi moralin e lartë dhe ndërtimi i shoqërive mbi traditat e ndershme janë shtyllë e shtyllave në fenë e Zotit xh.sh. Edukimi është si bujqësia dhe industria, është punë që kërkon sakrificë të madhe, ku marrin pjesë elementë të shumtë e jo fjalë apo predikime prekëse. Si mundet të pastrojmë shpirtin nga koprracia, smira, mendjemadhësia dhe dyfytërsia? Si mundet të ndërtojmë njerëz që e duan të përsosurën, përvëlohen për të bukurën dhe të mirën, refuzojnë rrëmujën e parregullsinë?

Në atë popull ku feja e tij e urren nxitimin, përse përhapet pakorrekhtësia e neglizhenca nëpër zërat e tij. Në atë popull ku jurisprudenca, fikhu, ngrihet mbi pastërtinë, përse janë të përhapur mbeturinat e papastërtisë e të hipokrizisë? Tradita e hipokrizisë në mënyrat e ngrënies, pijes, veshjes, martesës dhe në çdo gjendje tjetër, po vret burrat e gratë! Ku është lehtësia, sinqeriteti dhe modestia, ndërsa në themel të fesë sonë është origjinaliteti?



## Edukimi i kërkuar

Edukimi i kërkuar nuk është një gjë e lehtë, ai është plot probleme dhe sakrificë, me të cilat ndeshet edukuesi dhe i edukuari së bashku, ku në arritjen e rezultatit marrin pjesë edhe elementë të tjerë, në ballë të tyre: shoqëria, mjedisi dhe shteti. Ashtu siç marrin pjesë uji dhe rrezet, të nxehtit dhe të ftohtit në pjekjen e frutave.

Predikimi në minber dhe këshilla e mësuesit, vetëm këto të dyja nuk e edukojnë të riun edhe pse të dyja mund të kenë ndikimin e tyre. Shkenca e arsyetimit, logjika, siç e kanë quajtur, është një mjet i drejtë që mbron mendjen nga gabimi në të menduar dhe me gjithë këtë, kjo shkencë nuk ndërton një mendimtar. Njohja e rregullave të poezisë dhe e figurave letrare, të gjitha këto nuk mund të na japin një poet.

Na është bërë zakon që fenë ta marrim si fjalë apo imagjinatë, por kjo mënyrë e marrjes së fesë nuk kryen pastrimin e shpirtit, pa të cilin nuk ka për të shpëtuar askush dhe, as që do të shpëtojë njeri në qoftë se kur lëviz mendja e tij, së bashku me të, lëvizin edhe imagjinatat e supersticionet, të cilat i thur fantazia!

Elementet që ndikojnë në edukim, patjetër duhet të bashkërendohen e të ndërthuren me njeri-tjetrin, d.m.th: patjetër duhet t'i rregullojë një mbikëqyrje e vetme dhe të orientohen tek një qëllim i caktuar. Kështu, në qoftë se familja ose shtëpia është myslimane dhe përmbush detyrat fetare në mësimin e fesë, atëherë puna e saj do të bie poshtë, ose do dobësohet, po të jetë shteti dhe shkolla laike. Boshllëku, të cilin e vëmë re tek myslimanët e kësaj kohe, një pjesë e madhe e tij e ka burimin tek kjo shkëputje dhe antagonizëm në mënyrat e propagandës.

Nuk më pëlqen që t'ia ngarkoj kolonizatorit të gjitha disfatat tona materiale e shpirtërore dhe të shmangem nga pasojat e neglizhencës, e cila ka vështirësuar hapat e mia qëkur. Me të vërtetë, ne myslimanët i kushtuam rëndësi një pjese të moralit dhe neglizhuam pjesën tjetër, po me aq vle-

rë. Menduam se kjo neglizhencë falet, ose rregullohet me përkatësi tek një besim çfarëdo dhe me vazhdimësi në një adhurim po të çfarëdo!.

Morëm nga morali kuptimin e tij të afërt. Mundet ta kuptojmë amanetin sikur ai është diçka e lënë në ruajte, vedia<sup>21</sup>, duke ia kthyer të tjerëve atë që kanë lënë tek ne për ta ruajtur, ndërsa konsiderimi i detyrës, postit drejtues, amanet ku nuk lejohet shfrytëzimi i tij për interesa personale dhe ku s'lejohet shpërdorimi në përgjegjësitë e tij të mëdha e, kjo na qenka gjë tjetër?!

Në të shumtën e rasteve kërkimi i detyrës është mjet për t'u pasuruar dhe për të mbizotëruar, kërkim për interesa personale dhe jo për interesa të ymetit-popullit.. Sinqeriteti është një cilësi e njohur dhe shpesh ndodh që, në fjalë jemi të sinqertë, por jo në vepra, sepse sinqeriteti në punë është vështirë e ai është zbatimi i të vërtetës dhe shkatërrim i së kotës, bindje ndaj ligjeve mbi të cilat janë të ngritura qiejt e toka.

Dashuria për veten është prej natyrës njerëzore, por deri në çfarë kufiri mbizotëron kjo natyrë në rrugën tonë? Makina është përparim, burri ia kalon gruas, i madhi fajëson të voglin dhe lëvizin këto ndjenja të ulëta në dhjetëra veprime dypalëshe! Të gjithë thërrasin: vetja ime, vetja ime! A është kjo sjellje, komenti i prituri i thënies së të Dërguarit të Zotit a.s: *“Nuk beson asnjëri prej jush derisa të dëshirojë për vëllain e vet atë që dëshiron për veten e tij?”*<sup>22</sup>

A kemi vendosur ndonjë plan praktik që të fshijë këtë egoizëm të vogël dhe të mbulojë këtë ndjenjë shtazarake në gjakun e njerëzve? Me të vërtetë Allahu xh.sh e ka shkruar të mirën në çdo gjë dhe ne pothuajse kemi gjysmaken në çdo gjë!

Kam kërkuar shkakun e këtij shkatërrimi personal dhe jam udhëzuar drejt një gjëje që ndoshta është e vërtetë, ose pjesë e së vërtetës. Teprimet e pa arsyeshme në vlerësimin e

21. Plaçka që dikush na e lë për ta ruajtur dhe për t'ia kthyer më vonë.

22. Transmeton Buhariu dhe Muslimi.

botës së fshehtë të fesë plotësohen në kurriz të anës praktike, ose të asaj reales e kjo është gabim! Kam parë një tregtar që po i shiste një personi mallra me çmim më të lartë se çmimi i tyre.

I thashë: *“Përse bën padrejtësi, mashtron blerësin, kur ai është i natyrshëm me ty?”* Mora këtë përgjigje nga tregtari: *“A nuk e njihni, ai është njeri që mohon ‘keramat’<sup>23</sup> e evlijave!”* I thashë: I mohon, ose i beson, duhet që ti të sillesh me respekt ndaj tij! Tha: *“Ky është gjysmak në fe dhe...”*. Iu përgjigja: Le të jetë jehudi ose i krishterë por shfrytëzimi i tij nuk lejohet dhe mashtrimi është haram me besimtarin dhe me jobesimtarin!! A e konsideron besimin tënd për “keramat” shembës të cilësive të larta të moralit?

Gjithashtu kam parë një djalë të ri, i cili fliste me smirë për një thirrës<sup>24</sup>. I thashë: Përse hakmerresh ndaj tij?. Ai m’u përgjigj: *“Nuk e njeh synetin! A nuk e shikon se si i ka zgjatur rrobat e tija? Dhe nuk e falë mirë namazin! Qëndron drejtë dhe i mban këmbët në këtë formë!!”* I thashë: Urren një mysliman dhe i dëshiron të keqen për të tilla gjëra të vogla?

Zmadhimi i këtyre gjërave është argument i sëmundjes shpirtërore. Zemra jote mëkatore është shumë më larg mëshirës se sa dukuritë e tij, madje ai mund të jetë edhe më afër Zotit!.

Sipas këtyre shembujve, shikon personin, i cili ndjek një medhheb të veçantë në akide, apo në jurisprudencën dytësore<sup>25</sup>, mendon se udhëzimi i tij në këtë kuptim ose në këtë rrugë i ka bashkuar atij krenarinë në të gjitha drejtimit, për këtë s’ka gjë që ai të sillet si të dëshirojë, sikur Zoti i ka thënë: *“Bëj ç’të duash sepse të kam falur çdo gjë!!”*

Nga këtu shohim se shumë prej përmendësve<sup>26</sup> të Zotit, ose studiuesve të disa syneteve kanë shpërfillur bazat e edukatës dhe të moralit, ashtu siç kanë shpërfillur shumë çështje të jetës, vënien nën kontroll të tyre dhe futjen nëpër rrjedhat e

23. Gjëra jo të zakonshme që i ndodhin njerëzve të mirë, evliave.

24. Vaiz

25. Fukh fer’ij

26. Dhakirinëve

saj, duke u bërë gjëmë e zezë për fenë dhe dynjanë së bashku e, me këtë Islami pësoi disfata të mëdha prej duarve të tyre!!

Sëmundjet morale, të cilat kanë goditur ymetin së bashku me degjenerimin politik, janë të shumta, të cilat ndryshojnë nga një periudhë në një tjetër dhe, që nuk është vendi t'i përmendim, por vetëm do pyesim: Çfarë do të thotë falsifikim votimesh në një vend të çfarëdoshëm? Pa dyshim që ky falsifikim shkakton katastrofë morale më të madhe se sa shkatërrimi material, që e shkakton një tërmet i tmerrshëm!

Një ushtri e përbërë me njerëz, me pozita të larta e të ulëta, shndërrohen në hoje blete, në fabrikë gënjeshtresh me rreze të gjerë ndikimi, shkatërrues institucionesh, duke ndihmuar njëri-tjetrin në shpifje idesh e regjistrimi, në ngritje e transmetim të tyre nga një vend në tjetrin, pastaj bashkohen në fund të çështjes, ashtu siç pret kanali ujërat e zeza dhe pislleqet, duke ia imponuar botës se filan person ka fituar kaq vota prej zgjedhjeve...duke arritur një fitore të plotë!. Kështu njerëzit ngrysen e zgjohen me këto gënjeshttra të dukshme.

A mund të jetë sinqeriteti monedhë e vlefshme, apo monedhë pa vlerë? A do të qëndrojnë në shoqëri traditat e nderit apo traditat e plaçkitjes? A do të përparojnë njerëzit intelektual dhe të devotshëm apo do mbulohen me dhe? S'ka aspak dyshim që bazat e edukimit kanë nevojë për një mbrojtje të fortë, pasi të realizohet shpëtimi i tyre nga kjo fatkeqësi e madhe! Ekspozimi i kulturës sonë kombëtare përpara njerëzve në këto ditë, duhet të shoqërohet me të gjithë atë, që ajo ka përfshirë gjatë kalimit të kohërave.

Le të përmendim kalimthi se si myslimanët në kohën e shpalljes, pastaj në kohën e kalifëve rashidinë<sup>27</sup> nuk i kanë njohur gjithë këto studime të stërzgjatura në Bazat e Ligjislacionit<sup>28</sup> dhe degët e tij. Ishin vetëm ajete, ose sure nga Kur'ani i Shenjtë dhe disa hadithe të sakta ato që ata njihnin, me përjashtim të atyre që ishin të spikatur e të devotshëm. Legjislacioni i adhurimeve<sup>29</sup>, transmetohej me mënyra praktike,

27. Kalifëve të drejtë.

28. Uslu Din.

29. Fikhul Ibadat.

pastaj njerëzit pas gjithë kësaj merrnin rrugën e luftës e të sakrificës për mbajtjen lart të fjalës së Zotit!!

Më vonë morën vrull studimet fetare, u shtuan kërkimet në çdo fushë. Si mendoni, a është gjithë kjo shtrirje për zbukurim dhe çlodhje apo për të shtuar frikërespektin e devotshmërinë?

Ajo që dihet mirë tek ne është se, njeriu përgjigjet për diturinë e tij se çfarë ka punuar me të. Atë që kam vënë re, duke ditur se unë punoj në fushën e thirrjes islame që 40 vjet, ose më shumë, është se shumica e këtyre njohurive janë pa vlerë dhe njerëzit u kanë hyrë për të mbushur kohën bosh dhe për të mbrojtur titullin.. Sikur dhjetë prej tyre të punojnë në fikhun islam, jurisprudencën islame, mjaftojnë për të gjithë, pastaj pjesa tjetër mbetet të shpërndahet në punë frutdhënëse.

Shekulli i 14-të po mbaron, pas tij vjen shekulli i 15-të<sup>30</sup>, ndërsa problemet e ymetit islam sa vijnë e shtohen dhe ndërlikohen. Armiqve po u rritet lakmia e tyre, po u shtohet smira e mosmarrëveshjet ndërmjet tyre po zhduken, ndërsa prapambetja qytetëruese tek ne të nxit hidhërimin dhe me gjithë këtë, disa vrasës të diturisë fetare ngjallin mendime të varrosura me të cilat të çojnë të vjellura dhe neveri! Në vend që të orientohet rinia e shekullit të ri drejt punës së përshtatshme në shërbim të fesë së tyre, i orientojnë në rrethe boshe me çështje, të cilat i krijoi boshllëku në ditët e boshllëkut..

I thashë njërit prej tyre: Mendimit fetar i është rritur planci dhe i ka vënë dhjamë prej këtyre çështjeve e, që t'i kthehet shëndeti, duhet të hiqet ky dhjamë e t'i ulet ky planc, pastaj të merren myslimanët me shkencat e jetës, me të cilat i japin të drejtë fesë së tyre të brengosur dhe zmbropsin me të armiqtë e paturpshëm.

Tani le të flasim për kulturën tjetër e cila qëndron ballë për ballë me kulturën tonë kombëtare, ose për atë që s'ka atdhe dhe siç quhet ndryshe shkencë!

---

30. Autori ka për qëllim kalendarin hixhrij, që aktualisht jemi në shekullin e 15-të, në vitin 1432 (sh.p).

Po mendoja një ditë për shtypshkronjën dhe shpikësin e saj. Dëshiroja që shpikësi i rrallë të ishte person mysliman arab, ose jo arab.

Ne dimë shumë mirë që fjala e parë në shpalljen e Zotit për Pejgamberin tonë a.s është: “Ikra”, lexo, studio, hulumto, por ky aparat filloi në formën e tij të thjeshtë në Kinë, pastaj u përmirësua shumë në Gjermani dhe arriti pothuajse në kufirin e tij të plotë në këto ditë larg tokave islame!! Pyeta veten: përse? Kjo shpikje dhe tjera si këto, lindën e u rritën larg nga shoqëria jonë; a jemi ne njerëz jo si të tjerët?

Gjithashtu dëgjova nga një gazetar specialist që fliste me fakte se Saharaja perëndimore është e mbushur plot me naftë.

- Përse nuk nxiret?

- Kompanitë e huaja e vonojnë këtë deri në një kohë të caktuar.

- Ç’hyjnë këtu kompanitë e huaja?

- Ato posedojnë mjetet shpuese dhe zbulojnë me aparatet e tyre vendet e pasura me këtë lëndë të çmuar!!

Pëshpërita me vete: Ne nuk i dimë vendet dhe nuk i posedojmë mjetet, përse?

Patjetër duhet ta dimë përgjigjen e këtyre pyetjeve!

Ne nuk jemi jashtë çështjes! 1/5 ose 1/4 e botës janë myslimanë, kanë fenë, pretendimet dhe aspiratat e tyre! Ishin të urdhëruar për të qenë udhëheqës të botës, por çfarë i përçmoi ata? Ishin të urdhëruar për të qenë dora e sipërme dhënëse e moralit dhe e materies, po çfarë i pengoi ata? A kanë ndonjë justifikim për gjithë këtë pafuqi? Përgjigjja është e shpejtë: Jo dhe jo.

Nuk ka libër qiellor, që nxit mendjen dhe thërret dhuntitë e talentet, se sa Kur’ani i Shenjtë! Atëherë çfarë mbetet pas kësaj, që t’u thuhet njerëzve, se Allahu xh.sh ka nënshtruar për ju gjithë universin, qiellin dhe tokën e Tij. Ngjituni, zbrisni, shkoni dhe rrini si të dëshironi: *“A nuk e shikoni se Allahu ka nënshtruar për ju çka ka në qiell dhe çka ka në tokë, plotësoi për*



*ju të mirat e Tija të dukshme e të padukshme*<sup>31</sup>

A thua myslimanët nuk janë si njerëzit e tjerë e, për këtë në sytë, mendjet dhe vendosmëritë e tyre ka dobësi e trashësi?? Jo, jo, ata udhëhoqën botën shekuj me rrallë, hynë në betejën e zhdukjes, ose të ekzistencës me popujt më të dhunshëm të tokës dhe dolën fitimtarë pas zjarreve e dyluftimeve!! Atëherë, pra cili është shkaku që goditi mendjen njerëzore, prej përtacie dhe çfarë e gjeti popullatën myslimane që u dobësuan duke u sunduar nga ujqërit e tokës, ku po i shqyejnë nga çdo anë; ujqërit e tokës? Jo, por mizat e saj!

Hebre nga Los Anxhelos që banon në SHBA, i ardhur në Palestinë, qëllon me plumba mbi banorët Halil<sup>32</sup>-it, ka për qëllim shporrjen nga banesat e tyre dhe marrjen e tokës për veten e tij!

*“Edhe kukuwajka në tokën tonë bën si shqiponjë”*<sup>33</sup>



31. Sureja Llukman, ajeti: 20.

32. Halil, qytet në Palestinë.

33. Shprehje arabe, ka për qëllim: “kush jeton me ne bëhet krenar”

## Gishti i akuzës

Po e them shkurt e haptas: Gishti i akuzës drejtohet ndaj dy grupe njerëzish: udhëheqësve dhe dijetarëve, të cilët i sollën ymetit tonë këtë prapambetje të kobshme gjatë shekujve me radhë dhe ishin shkak i sëmundjeve, të cilat e paralizuan në kohën kur banorët e tjerë të tokës filluan të heqin pengesat në rrugën e tyre të përparimit. Nuk u mjaftoi të arrijnë retë, por pushtuan universin. Nuk u mjaftoi të ndërtojnë anijet në det si male, por u zhyten në thellësitë e deteve, duke mbajtur me vete kokat nukleare shkatërruese në masë.

Për mendimin tim, totalitarizmi politik është një prej shkaqeve të para të paralizimit të mendimit tek myslimanët. Nuk është e lehtë për njeriun të eci me frikë në rrugë duke parë para e prapa se mos i ndodh gjë, ndoshta mund t'i vijë ndonjë dajak në majë të kokës, i cili i merr jetën, ose ndonjë shuplakë në fytyrë që i merr nderin, ose të merret për leckash e të hidhet në burg, ku s'di asgjë për familjen dhe fëmijët e tij! Nevoja për siguri është si nevoja për ushqim.

Ishte Ibrahim i a.s, i dashuri i Zotit xh.sh., i cili vlerësoi të drejtat morale e materiale të njeriut së bashku, kur u lut para se të ndërtonte Qaben, **“O Zot, bëje këtë vend të qetë, të sigurt dhe furnizoi banorët e tij prej frutave të ndryshme”<sup>34</sup>**.

Ndërsa ushtari i urdhëruar qëllon mbi njerëzit duke mos i bërë përshtypje aspak që vë nën këpucët e tij trurin më të madh në botë, sepse ai nuk dallon trurin prej trurit. Ai është i urdhëruar që të qëllojë, ai është vegël njerëzore në duar të diktatorit.

Kur Kur'ani i shenjtë tregon politikën e faraonëve, ai bashkon eprorin dhe vartësin në të njëjtin kallëp: **“Me të vërtetë Faraoni, Hamani dhe ushtarët e tyre ishin mëkatarë”<sup>35</sup>**. Dhe ndoshta cilëson të gjithë vargun ushtarak zullumqarë: **“A të erdhi lajmi i ushtrive të Faraonit e të Themudit. Jo, por ata që nuk**

34. Sureja Bekare, ajeti: 126.

35. Sureja Kasas, ajeti: 8.

*besuan janë në gënjeshtër. Ndërsa Allahu ata i ka rrethuar*<sup>36</sup>.

Diktatorit nuk i intereson tjetër, përveç se vetja. Ai shikon vetëm interesat e tij dhe nuk afron tjetër, përveç atë që e kënaq dhe i bindet.

Kujtoj një herë se, në një vend hipi në makinë presidenti së bashku me ministrin, ku për çlodhje, presidenti po ngiste makinën, papritmas përplasat me një pemë në anë të rrugës. Zbriti me vrap ministri që t'i thotë zotërisë së tij: *"Makinën e ngjisje në rregull, por pema kishte qëndruar gabim!!"*

Në këtë mjedis të zymtë prej servilizmi vdesin dhuntitë shpirtërore, kur totalitarizmit të verbër i shtohet edhe mungesa e rriskut dhe pasuria kalon mes gishtave të udhëheqësit të vetëm, atëherë i jep e i merr kujt të dojë, duke ekzekutuar të gjitha moralet e të drejtat.

Kur po lexoja tregimin e shpikjes së makinës me avull, imagjinoja djalin e ri anglez, duke vëzhguar avullin që ngrinte kapakun e enës dhe duke menduar me maturi në shfrytëzimin e kësaj energjie në dobi të njerëzimit, ndihej i qetë, shpreonte dhe krijonte, se askush nuk do ta çonte në dhomat e izolimit për ta rrahur me 100 kamxhikë, si dënim për atë që bëri. Ai nuk do të qëndrojë para ndonjë oficeri duke i thënë: Mendo për atë që të bën dobi ty? Siç thuhet shpesh në lindjen islame(!) Ishte nderimi moral e material në vendin e tij, i cili vendosi ta shpërblente me çmim të lartë, për të cilin shpenzoi mbreti i Anglisë!

Nuk mundem të zgjatem më në këtë temë, por ah, sikur të ngrihej një grup universitar për mbledhjen e gjurmëve rreth personave të shquar në mendimin islam përgjatë shekujve. Ndërsa roli i dijetarëve të sotëm, të cilët kanë ndërprerë veprimtarinë shkencore, duket së pari në kërkimet "kelamije gajbije", metafizike, në degët e fikhut imagjinar dhe në materiale pa dobi, të cilat s'kanë mbarim, pastaj e gjithë kjo llogaritet si dituria, e cila s'ka dituri mbi të.

Me këto u shkëput rruga e mjekësisë së Ibën Sinës, kimia e Xhabirit, optika e Ibnul Hejthemit dhe logaritmi i Khava-

36. Sureja Buruxh, ajeti: 17-20.

rizmit. Madje, njohuritë e përparimit e të zhvillimit shkencor tek arabët nuk i gjen në enciklopeditë veçse, në bibliotekat perëndimore dhe tek shkrimtarët realistë evropianë!

Ndërsa përpjekjet e baballarëve tanë në shkencat e astronomisë, jetës, mjekësisë dhe në artet luftarake janë aq të shumta sa nuk mund të numërohen apo të shkruhen!! Sistemi nervor i njeriut lodhet e dobësohet me çfarë kanë shpikur devijuesit dhe ekstremistët prej ibadeteve e riteve, duke mos u mbetur më kohë të trajtojnë dy mendime e pas kësaj të mendojnë e të shpikin.

Pasi të ngarkohet myslimani, pas gjithë përmendjeve të ditës e natës të thotë: *“Ja Latif<sup>37</sup>”* 10000 herë, çfarë i mbetet atij kohë për mendim të zbulojë të panjohurën apo të shpiki diçka të re? Sikur të pushonte në gjumë, pastaj të ngrihej të stërvitet ushtarakisht në tokë, det e ajër e gjitha kjo do të ishte më e dobishme për Islamin. Zoti ynë i lartë i fali mu-xhahidinët nga detyrimi i kijamul-lejlit<sup>38</sup>, që t’u japë mundësi atyre të përgatiten për luftën e ditës, gjithashtu fali edhe tregtarët, që të qëndrojnë të fortë në fushën e ekonomisë, ndërsa Pejgamberi a.s ka thënë: *“Kush lexon dy ajetet e fundit të sures Bekare, atij i mjaftojnë”*.

Por, tek shumica e dijetarëve myslimanë shkencat e jetës së gjithësisë janë vullnetare, ndërsa ne lodhemi e sakrifikojmë që të bindim rininë se fjala e njësimi, po kërcënohet në qoftë se nuk shpikim në këto shkenca!

Më rastisi të shikoj një student mjekësie me një turrë librash fikhu e hadithi dhe me keqardhje i thashë: Më mirë do të ishte për ty, sikur kjo turrë me libra të ishte në njohuritë në të cilat je i specializuar. Përse nuk konkurron me mjekët e Londrës dhe të Parisit në arritjet e tyre duke shtuar më tepër leximin dhe thellimin tënd?

I përmenda se, si një doktor i ri, miku im, po bisedonte me profesorin e tij për qelizën, menjëherë profesori zgjati dorën afër një rafti dhe mori një vëllim të madh dhe ia dha

37. Latif, emër i Allahut që do të thotë: I Butë.

38. Namazi i natës.

doktorit të ri. Çfarë të shikosh, i gjithë vëllimi fliste për qelizën dhe çfarë ka vendosur Allahu prej sekreteve të saj. Mijëra e mijëra libra shkencor ndihmojnë e mbështesin zhvillimin e ri, i sigurojnë atij sundimin mbi çështjet e jetës në çdo drejtim të saj dhe njerëzit i studiojnë me epsh të gjitha këto lëndë, ndërsa në të njëjtën kohë gjejnë studentë universiteti në njërin prej fakulteteve të këtij lloji, i zënë me replika kundër “Xhehmive”<sup>39</sup>



---

39. Fraksion, rrymë, mendim, i cili e kufizon blasfeminë vetëm me zemër, d.m.th njeriu quhet jobesimtar vetëm atëherë kur mohon me zemër, ndërsa veprat e tij, edhe n.q.s janë të ndaluara për t’u kryer dhe i kryen, nuk kanë rëndësi dhe nuk ndikojnë në besimin e tij, po qe se nuk ka qëllim të keq me zemër.



# KAPITULLI III

## Rreth Islamit

Një mikut tim i thashë: E njihni filanin? Kam një shok, i cili dëshiron të lidhet me të dhe, ndoshta mendon të bëjë krushqi, ose të bashkëpunojë në një plan tregtar të madh! - E njoh shumë mirë, m'u përgjigj, ka moshë mesatare, i shkurtër në trup, ezmer!

Pastaj, çfarë?

Mban kravatë të bukur! Këpucë që shkëlqejnë! Dhe kur ecë... Shpejtova duke ia plotësuar cilësitë e duke i thënë me ironi:

- Kur ecë ngjan bukur, kthehet në mënyrë tërheqëse!!

Çfarë do të thuash me këtë ironi ? Më pyeti me hidhërim.

Ironia është për ty, iu përgjigja. A kjo është njohja që ju paraqitni për një njeri? Me të vërtetë i ngjani disave që flasin për Islamin sot në këtë kohë të zymtë! Ia paraqesin njerëzve dhe nuk u shtojnë gjë tjetër veçse injorancë dhe ndoshta i pengojnë prej tij. E bëjnë Islamin krijesë me mustaqe të rruara, dhëmbë të dukshëm, sy të lyer me remel, i shpërvjelur në punë, etj.

Njohja ka të bëjë me të vërteta personale dhe elementë të rëndësishëm. Feja jonë është e panjohur tek shumë njerëz. Ata duan një përshkrim të mendjes islame, ndërgjegjes islame, moralit islam, ligjit islam. Duan ta njohin familjen ashtu siç e ndërton Islami dhe dynjanë siç e kërkon ai, ligjet e drejtësisë siç i përcakton Islami. Kam mendimin dhe besoj se përhapja e mosbesimit dhe ateizmit në botë, gjysma e këtij mëkati bie mbi fetarët, të cilët mbollën te njerëzit urrejtje për fenë e

Allahut, me fjalët dhe veprat e tyre!

Nuk kam aspak dyshim se, shkaku i përhapjes së komunizmit në Evropë dhe jashtë saj janë, veçse priftërinjtë dhe murgjit, të cilët dëshpëruan bujqit nga drejtësia qiellore, mbyllen në fytyrat e tyre dyert e mëshirës dhe u drejtuan mirazhit duke menduar se ai është lumë.

Sot, disa tipa prej myslimanëve, luajnë rolin e priftërinjve të vjetër, duke e paraqitur Islamin fe me natyrë gjakatare, agresive, pëlqen dhunën, urren butësinë, i kushton rëndësi më tepër prerjes së thonjve dhe të flokëve, sesa interesohet për eliminimin e egoizmit të tepërt e të përbuzjes së njerëzve. Pamja e cila shfaqet, botërisht, për territorin islam është si një territor ku grabitet pasuria kolektive, në të sundon diktatura personale, shpërfillet dinjiteti i gruas, bile humbin të drejtat e saj. Rrugët janë të mbushura me mbeturina, qytetet e fshatrat janë shfaqje e prapambetjes materiale dhe intelektuale, se kaosi e grindjet janë lidhja që sundon në shoqëri .

Se, reformatorët e fesë s'kanë zë tjetër veçse të flasin për ndalimin e fotografive, të muzikës, heqjes së shamive, televizorit. Se, kthimi për tek Islami, siç e kërkon rinia, s'do të thotë tjetër veçse kthim në primitivizmin e parë!! E gjitha kjo lë të kuptosh se qytetërimi njerëzor është në rrezik!! A na gëzon neve kjo pamje e zymtë që na ofrohet? Armiku ynë po na gënjen, ndonëse ne e nxisim që të na gënjejë, në kohën kur fikhu dhe puna jonë me të hutohen, ndërkohë që jeta jonë private dhe ajo e përbashkët është larg esencës së fesë dhe qëllimeve të mëdha të saj .

Një mik i besueshëm më tregoi për një amerikan, i cili kishte pranuar Islamin pas shumë studimesh të thella. Një ditë prej ditësh, myslimani i ri qëllloi të vizitonte disa vende islame në një mision të tij .U kthye i mahnitur duke thënë: *“Falënderimi i takon Allahut, i Cili më dha mundësinë të njoh Islamin para se të shikoj myslimanët”!*

Vërtet, ekziston refuzim i pjesshëm në disa vende islame dhe në disa të tjera zbulime të femrës myslimane ashtu, siç ka injorancë të madhe në disa vende të ndryshme. Gjithashtu ka edhe lulëzim të vërtetë që i mungon të kuptuarit dhe ekspe-



riencia, lulëzime të sinqerta që i mashtrojnë zyrtarët fetarë, ose nuk i ndihmojnë aspak, siç ka edhe grupe prej udhëheqësish që e duan Islamin me një dashuri të zjarrtë, por nuk e dinë se si t'i shërbejnë! Dhe, të tjerë që shfaqin hapur mbështetjen e tyre për laicizmin dhe politikatat e tij!



## Pjesë nga realiteti

Duam të vërtetojmë këtu pjesë nga realiteti që s' duhet ta harrojmë kurrë. Pa dyshim që mbështes mendimin e Ibn Haldunit për arabët, madje janë ndodhitë e kohërave, të cilat e vërtetojnë këtë mendim! **“Njeriu mendon se është e pamundur për arabët të kenë autoritet, sundim përveçse në bazë të shpalljeve, pejgamberllëkut, ose të kenë shtet të tyre, përveçse në bazë të fesë!!”**

Raca arabe është racë që ka instinkte të forta, ndjenja nxitëse, imagjinatë të gjerë, cilësi mendore të mira dhe gjithë këto veçori në qoftë se nuk i kontrollojmë dhe mbahen nën frena të hekurt, e hedhin zotëruesin e tyre në mes të rrugës! Po që se ushtrohen këto kontrole, pas një lulëzimi të mirë fetar, atëherë ngjitet lart e më lart .Për këtë ekzistojnë argumente të qarta në historinë e gjatë arabe.

## Në kohën e vjetër

Arabët kanë ekzistuar që në kohët e vjetra. Populli i Ad-it në Ahkafë, në jug të gadishullit, populli i Themud-it në Haxher në veri të Hixhazit, populli i Medjen-it në lindje të Sinasë, fshatrat Mu'tefiketu në Jordani, por ky ekzistim u kërcënua të zhdukej për shkaqe të sjelljeve sulltanate, të tiranizmit, çrregullimeve dhe padrejtësive.

Për këtë, Kur'ani i shenjtë ka folur rreth tregimeve të pejgamberëve arabë tek popujt e tyre dhe çfarë gjetën Hudi, Salih, Shuajbi dhe Luti a.s prej pengesave dhe arrogancave! Kështu, Allahu gjykoi mbi ta me drejtësinë e Tij, duke sjellë dënime, të cilat zunë të gjithë keqbërësit: *“Secilin prej tyre e kemi dënuar për shkak të mëkatit të vet, disa prej tyre i goditëm me furtunë plot rërë, disa i shkatërruam me krismë nga qielli, kurse disa të tjerë i shkatërruam në tokë dhe disa i përmbytëm*

*me ujë. Allahu nuk u bëri atyre ndonjë padrejtësi, por ata vetes së tyre ishin që i bënë padrejtësi*<sup>40</sup>.

Gjithashtu, edhe banorët e Mekës, kur disa fise u rebeluan, u erdhi dënimi dhe u bënë të mallkuar, për këtë një poet thotë: *“Sikur të mos kishte njerëz mes Xhuhunit dhe Safasë dhe të mos rrinte askush zgjuar në Meke, po po, ne ishim banorët e saj por na zhdukën veprat e netëve dhe fati i mëkatarëve”*.

S’ka seç hyn fati i mëkatarit në luftën shfarosëse, të cilën e ndezën kaderet<sup>41</sup> kundër atyre, arabëve keqbërës!

Me të vërtetë arabët beduinë ngritën krye kundër Zotit, prandaj Ai u dha atyre dënimin e merituar! *“Atë dënim ua dhame për shkak se nuk besuan, e ne nuk dënojmë veçse jobsimtarët”*<sup>42</sup>. As që mbeti kush prej atyre brezave të na tregonte, në mënyrë që të marrin mësim njerëzit e mendjes.

## Dhe erdhi islami

Historia pësoi një hov të madh, duke u shfaqur përsëri arabët, për herë të dytë në fushën e jetës. Zoti i zgjodhi për të mbajtur mesazhin e fundit, pasi ata i edukoi Muhamedi a.s me mësimet e shpalljes dhe i ndriçoi me rrezet e saj. Pothuajse për një çerek shekulli, Pejgamberi a.s arriti të përgatiste një ushtri prej mësuesish dhe luftëtarësh e përbërë nga njerëz që natën e kalonin duke u falur, ndërsa ditë duke luftuar, ashikët e parajsës, reformuesit e tokës; lavdi i qoftë Atij, i Cili krijoi Muhamedin a.s për të ndërtuar këtë brez prej sahabesh rregulluesë, bamirësë e të zotë, të cilët brodhën në tokë duke shkullur rrënjët e shthurjes e të degjenerimit, duke u bërë kështu populli më i mirë, i cili është krijuar për njerëzit!!

Në këtë periudhë të ekzistencës arabe, u përzien veçoritë

40. Sureja Ankebutë, ajeti: 40.

41. Përcaktimet e Allahut

42. Sureja Sebe’ë, ajeti: 17.

e racës me realitetin e mesazhit dhe kështu u bë fjala “urube”, arab sinonim i fjalës “Islam” duke u njohur arabët sikur të jenë trup, shpirti i të cilit është feja, ku me të ecin dhe ajo me ta lëviz, që të hapin burgjet e të lirojnë prangat, t’i japin mundësi të dobëtëve të marrin frymë lirisht, që të dalin nga ngushtica e kësaj bote tek gjerësia e Islamit dhe nga adhurimi i njerëzve tek adhurimi i Zotit të Lartë e të Lavdishëm.

Medina e ndritshme, kryeqyteti i Islamit në atë kohë, vendi në tokë që e meritonte, më shumë se asnjë vend tjetër, udhëheqjen e botës, sepse çka ajo i dha kësaj bote, prej moraleve e udhëzimeve, ishin më të mira në sytë e realitetit, se sa ajo që dha Roma, Athina, Egjipti, Persia, India dhe Kina. Arabët e pashkolluar i shndërroi në mësues të vendosur e të respektuar, në kohën kur kryeqytetet e tjera ishin mbushur me priftërinj të pavlerë, udhëheqës tiranë, feudalë gjakpirës e analfabetizëm në masë.



## Veçoritë e lëvizjes së re

Që të mos jetë biseda jonë thjesht pretendim, le të përdim tani veçoritë e lëvizjes, e cila shndërroi botën në gjendjen e saj të re:

Mendja Islame u ngrit vetëm mbi gjëra të vërteta, duke mohuar kështu iluzionet e mendimet e kota. Ajo u mbështet tek koncepti i zgjuarsisë dhe i shqisave vigjilente në vërtetimin e llojeve të njohjes. Njerëzimi nuk do të ishte në gjendje t'i kuptonte, sikur të mos ishte Kur'ani ai, i cili konsideroi injorancën, çaktivizimin e shqisave, mos vënien e tyre në veprim dhe të menduarit e paktë, rrugë për në zjarr.

Përmes figurave të larta letrare me të cilat shkruan Kur'ani, lexojmë fjalën e Tij xh.sh: *“Ne kemi krijuar shumë nga xhindet e njerëzit për xhehenem. Ata kanë zemra që nuk kuptojnë, kanë sy që nuk shohin dhe kanë veshë që nuk dëgjojnë me ta. Ata janë si kafshët, bile edhe më të humbur, të tillët janë të pavëmendshëm”<sup>43</sup>.*

Fraza e ajetit është: Në klasë mbet vetëm përtaci, i cili nuk përsërit mësimet e tij dhe çdo lojçak që braktis mësuësin.

Morali Islam u ngrit mbi baza të kërkesës për më të plotën në të gjitha sjelljet njerëzore, ndërsa Pejgamberi a.s thotë:

*“Jam dërguar që të plotësoj moralet e larta”. Gjithashtu thotë: “S’ka gjë më të rëndë në peshore për besimtarin në Ditën e Kiametit se sa morali i mirë. Zoti i urren të këqijat e neveritshme dhe në të vërtetë personi me moral të mirë arrin shkallën e atij që agjëron dhe falet”.*

Mësimi i cilësive morale ishte posaçërisht vetëm për disa filozofë që mburrreshin me ta në seminarët e tyre, ose shenja dalluese e atyre, të cilët merreshin me punë të veçanta, derisa erdhi Islami dhe bëri moralin e lartë, monedhë të përdorshme që sundon çdo kuvend, hyn në çdo treg dhe stolisë çdo veprim. Islami refuzoi pranimin e adhurimeve që janë larg moraleve të larta, të përziera me fjalë e vepra të pahijshme. Ritet e adhurimeve dikur ishin shfaqje mirësie e karakteri.

43. Sureja EL-E'arafë, ajeti: 179

Ndërgjegjja islame është ndërgjegje me ndjenja të larta për të mirën dhe të keqen, për atë që kënaq Allahun dhe çfarë e zemëron Atë. Ajo është e obliguar për devotshmëri dhe me mbikëqyrje të Allahut, larg nga nxitësit e dëshirave të kësaj bote dhe frikës së urryer e lidhur vetëm me Zotin Një, e kënaqur me çka ndodhet tek Ai.

Mos harro se ndërgjegjja e kolonizatorit, shfarosi pothuajse të gjithë banorët e Australisë, gjithashtu shfarosi gati të gjithë banorët e Amerikës, në mënyrë që të jetë i vetmi në sundimin e begatave të tokës! Ajo është ndërgjegje lakmuese, lëviz me arsyen e fitimit e të humbjes, ndalet nën frikën e dajakut dhe ecën kur sigurohet nga dënimet.

Ndërsa, ndërgjegjja Islame është e mbrojtur me domethëniet e devotshmërisë e gjykuar me fjalën e Zotit xh.sh:

*“Në ditën që s’bën dobi pasuria e as fëmija, përveç kush i vjen Allahut me zemër të shëndoshë”<sup>44</sup>. Dhe, me fjalën e të Dërguarit a.s: “A nuk është në trup një pjesë, e cila në qoftë se rregullohet, i gjithë trupi është në rregull dhe në qoftë se prishet, i gjithë trupi prishet e, kjo pra është zemra”.*

Gjithashtu në vështrimin islam edhe trupi duhet të jetë i pastër dhe, pastërtia është diçka më tepër se pastrimi e bukuria. Llojet e larjes, të cilat i ka obliguar feja e bëjnë njeriun ballëpastër e fytyrëndritur, pa mbajtur lëkura papastërti dhe as djersë e pisllek.

Nuk njihej, para Islamit, interesimi për trupin e njeriut, bile ishin sëmundjet e papastërtive që vrisnin banorët e Evropës .As që njihnin kryeqytetet e Evropës banjat e duset publike dhe llojet e pastrimit, përveçse ndriçim nga drita e Islamit dhe ndjekje e anëtarëve të tij. Biseda do të zgjaste sikur të merreshim me synetet e zanafillës dhe me të drejtat e trupit!

Kjo nuk është, thjeshtë, adhurim i trupit, apo pëlqim i mendjes e i zemrës, por kjo është kujdesi për të gjithë personalitetin njerëzor. Ndërsa, zbukurimi për gruan do të thotë ruajtje e qenies të saj të shëndoshë dhe rregullimi i mirë i

44. Sureja Shuaraë, ajeti: 88-89.

saj, i cili është krejt ndryshe me lakuriqësinë që nxit të tjerët duke i sprovuar e provokuar!..



## Islami dhe gruaja

Gruaja myslimane është njeri sikur burri, ajo është motra e tij përpara të gjitha parimeve Islame. Gruaja tek arabët ishte plaçkë pa vlerë. Kur atyre u lindte ndonjë vajzë, ajo varrosej për së gjalli dhe përbuzej shumë. Ndërsa në të kaluarën evropianët pyesnin: A ka shpirt gruaja sikur burri?

Në Indi, kur burri i saj sëmuret ose vdes, ajo gjykohet me vdekje duke e djegur dhe nuk i lejohej gruas të jetojë pas vdekjes së burrit! Gjithashtu, Platoni shikonte në qytetin e tij utopik që, gruaja të jetë e përbashkët për të gjithë burrat!

Derisa erdhi feja Islame, e cila ndryshoi të gjitha këto dukuri e paragjyqime, e nxori gruan nga shtëpia për në xhami 5 herë në ditë, në qoftë se kjo gjë nuk e pengon atë në punët e saja, për fëmijët dhe burrin, duke e parë vetë ajo gjendjen e saj. Islami nuk e pengoi gruan nga xhahadi, të luftojë në qoftë se ka mundësi, bile është obligim për të dhe për burrat të gjithë kur është puna për të mbrojtur vendin.

Me të vërtetë, personaliteti i gruas lindi me ardhjen e mesazhit islam dhe, si argument për këtë kemi sjelljen e Pejgamberit a.s me gratë e tij, i cili i ndaloi vetes disa gjëra të lejuara, hallall për hir të grave të tij, që t'i kënaqte ato, derisa zbriti shpallja e Zotit xh.sh: *“O ti i Dërguar, përse ja ndalon vetes ato që Allahu t’i ka lejuar ty, ku me këtë gjë kërkon kënaqësitë e grave tuaja”*<sup>45</sup>?

Më përpara gruaja nuk e kishte gjithë këtë gjerësi në personalitet edhe pse çështja e saj mori drejtim tjetër, për të përmbysur zakonet e vjetra dhe jo si përputhje me parimet islame.





## Familja dhe rëndësia e saj

Familja në Islam është argument prej argumenteve të Allahut, duke u krahasuar krijimi i saj me krijimin e gjithë botës, Zoti xh.sh thotë: *“Prej argumenteve të Tij, krijoi për ju, nga lloji juaj, bashkëshorte që preheni tek ato...”*<sup>46</sup>. Pastaj thotë: *“Dhe prej argumenteve të tij, është krijimi i qiejve e i tokës, ndryshimi i gjuhëve dhe i ngjyrave tuaja”*<sup>47</sup>.

Në jurisprudencën islame ekzistojnë kapituj të tërë për familjen, për rendin e saj material dhe për misionin e saj moral, për aktin e martesës, ku janë përcaktuar detyrat reciproke, kujdesi për fëmijët, llojet e shpenzimeve, mënyra e sjelljes dhe mënyra për ndarje, në rast se nuk ekziston asnjë mundësi për të jetuar më së bashku, sasia e trashëgimisë etj.

Gjithashtu, aty flitet edhe për ndikimet e lidhura shpirtërisht e moralisht me ekzistencën e familjes se, si familja shërben për vazhdimësinë e racës njerëzore dhe për parimet, adhurimet dhe moralet, të cilat Islami i ka urdhëruar dhe është ndërtuar mbi bazën e tyre.

Për të mbrojtur familjen, Islami ka ndaluar përzjerjen shtazore, siç njihet në shumë vende të ndryshme, ka ndaluar çdo gjë që prek nderin dhe turpin.

Një miku im më ka thënë se, fjala “ird” me kuptimin e plotë të ndershëm, të pastër të saj, nuk mund të përkthehet në asnjë gjuhë tjetër!

Si të ketë kuptim kjo fjalë në ato lloj shoqërisht ku lejohet të kërcejë burri me gruan e huaj, i hedh dorën dhe vallëzojnë së bashku në sallë dhe ndoshta burri i saj horr është i prani-shëm, shikon dhe nuk i vjen zor aspak, ose mundet të jetë me babain ose vëllain e saj në mbrëmje!!

Familja në fenë tonë është e rrethuar me dëlirësi dhe me shenjtëri, që nuk gjendet në vende të tjera, mund të gjenden vetëm në letër, ose deri në një moshë të caktuar, pastaj në

46. Sureja Rrumë, ajeti: 21.

47. Sureja Rrumë, ajeti: 22.

moshën e pubertetit, detyrohet djali apo vajza të çajnë rrugën e tyre për të fituar e jetuar.

Shoqëria në Islam është si një familje e madhe, e cila ngrihet mbi baza njohje e dashurie. Njerëzit në të gjithë rruzullin janë të barabartë, bindja e tyre është vetëm për Allahun dhe jo për racë, apo për atdhe. Më i ndershmi i tyre tek Allahu është më i devotshmi.

Baza e komunikimit dhe e marrëdhënieve është përcaktuar qartë: *“Nuk është prej nesh ai që nuk respekton të moshuarin, nuk mëshiron të voglin dhe nuk e njuh të drejtën e mësuesit tonë”*.

Mburrja me anë të prejardhjes është e refuzuar, gjithashtu edhe me anë të shokëve e të miqve është e papranueshme. Zgjedhja e parësia i takon vetëm atij që e meriton dhe jo sipas origjinës dhe shquarjes. Duke nisur nga ky parim, u bënë ata që ishin robër, udhëheqës të botës islame, dolën në krye të fushave të fetvasë, në fikh, letërsi, gjuhë, ia kaluan arabëve që ishin të parët përkrahës të shpalljes, pastaj dolën në krye të fushës së politikës e drejtësisë. Gjithashtu, u ngritën shtete të skllëvërve dhe racave të ndryshme, të cilat patën një ndikim të madh në shërbim të Islamit.



## Roli i pasurisë në shoqëri

Pasuria në Islam ka detyrë të gjerë shoqërore. E drejta e parë e saj i takon fituesit, atij që ka derdh djersën për arritjen dhe fitimin e saj. Ai ka të drejtë të falë pasurinë, të mbrojë me të prestigjin, veten dhe familjen e tij. E gjitha kjo nuk e pengon aspak në nxjerrjen e pjesës së caktuar që ka obliguar Zoti për fukaranë e të vobektit, siç nuk harron, gjithashtu edhe të drejtat e tjera që ka përcaktuar sheriat.

Grindje të madhe ka pasur ndërmjet pasanikëve e fukarenjve, si rrjedhojë e së cilës lindën shumë fondacione dhe organizata, secila më e keqe se tjetra në braktisje e mosbesim. Sikur të pasurit të kishin pasur parasysh kufijtë e Allahut në rrugën e fitimit dhe të shpenzimit, shumë gjakra s'do të ishin derdhur, do të ishin mbrojtur të drejtat, por kush bën koprraci me të paktën që i ka kërkuar Zoti, do të humbë prej tij shumë prej pasurisë e shpërblimit së bashku. Do të duket shumë qartë qëndrimi i Islamit, kur të flasim për drejtësinë, sundimin në periudhën e parë.



## Pushteti është amanet dhe përgjegjësi

Pushteti në Islam është amanet i rëndë, ku trimat frikësohen prej tij e, si atëherë ia ngulin sytë të dobëtit? Ai, pushteti nuk është çmenduri e të mëdhenjve kur duan sundimin dhe as mburrje e mendjemadhësi, pa pasur parasysh se kjo mburrje është fryt i aftësisë së personit, apo fryt i gjendjes së sëmure!. Pushteti është përgjegjësi e madhe para Zotit. Udhëheqësi është argat tek populli mysliman, ruan interesat e tyre fetare e jofetare si kompensim, përball pagës që merr.

Le të shkëpusim diçka prej historisë së Ebu Bekrit e të Umerit r.a, që na e bën të qartë domethënien e asaj që përmendëm më lart e na zbulojnë në përgjithësi politikën e pasurisë dhe pushtetit në Islam.. Ja se çfarë i ka thënë Ebu Bekri nënës së besimtarëve Aishes në prag të vdekjes së tij:

*“E mora përsipër drejtimin e këtyre njerëzve në kohën kur kthimi prapa ishte humbje e zhgënjimi ishte teprim”, d.m.th se, ai nuk e kërkoi kalifatin e as që e donte atë, por e ndjeu se trembja nga pranimi i pushtetit të shfaqur do ta ekspozonte ymetin për shumë sprova të mëdha. Për këtë ai thotë “Dëshmitari im është All-llahu, i Cili nuk më la të ikja nga kalifati, nuk pranoi dorëheqjen time”.*

Ebu Bekri tregon se, si ai nuk ka marrë dhe nuk ka përfituar pagë nga pasuria e popullit, përveçse fare pak, një enë me qumësht deveje që i ishte caktuar nga pasuria e shtetit dhe thoshte: *“Haja prej anës së tyre, pija nga gjiri i devesë dhe falja me ta namazin, jo mendjemadh i poshtër e as shumues e bukëshkalë! Nuk e teproja, vetëm sa për të larguar urinë, mbuluar avretin dhe të ushqeja trupin! Vetëm sa të jetoja prej ushqimit e të mbaja gjallë frymën”.* Pastaj betohet në Zot se, ai u detyrua të hante prej pasurisë së shtetit, sa për të larguar urinë, për shkak të dobësisë së ushqimit të keq që hante! Por siç dihet nevojtar i pi edhe të hidhurën!

Shprehja e tij ishte: *“Zoti dëshmon për urinë e dhimbshme që mbanin të përbrendshmet e mia dhe për këtë u detyrova, siç detyrohet i sëmuri të pijë ujë të njelmët”.* Pastaj,

kalifi në prag të vdekjes ia lë amanet bijës së tij që t'ia kthejë myslimanëve atë çka ka marrë prej pasurisë së tyre. Për këtë ai thotë: “Kur të vdes, ktheju enën e tyre, shërbëtorin, devenë, petkun që mbrohesh nga të ftohtit dhe petkun tjetër që ruhesh nga balta e tokës”. Shtrati që flinte Ebu Bekri, kalifi i myslimanëve ishte i shtruar me gjethe palme!

Shejkh Huderij thotë: “Ebu Bekri e konsideronte veten, si ai që s’ka të drejtë në pasurinë e shtetit, sipas veprës së tij, për këtë la amanet që tokën e tij t’ia jepte myslimanëve si kompensim të asaj që kishte marrë prej tyre”.

Ndërsa, sprovat e tij të gjata në forcimin e themeleve të Islamit, para murtedëve<sup>48</sup> dhe përgatitja e tij e rrallë në luftën kundër persëve e romakëve, janë sakrifica e robit, i cili kërkon kënaqësinë e Allahut dhe nuk kërkon shpërblim për të. Duket qartë se kalifi i parë ngarkoi veten e tij me atë që s’ishte ngarkuar, ngaqë sahabet me dëshirën e tyre i kishin caktuar prej pasurisë publike, çka me drejtësi e meritonte dhe pa pasur aspak problem në të.

Ibn Seadi në Tabekat thotë: “Ebu Bekri shpenzonte nga shfrytëzimi i pasurisë së tij dhe nga puna e dorës së tij, vazhdoi në këtë gjendje gjithashtu disa muaj pas marrjes së kalifatit, duke mos shpenzuar për veten e tij nga pasuria e shtetit.

U ngrit një ditë në mëngjes dhe në krahët e tij mbante disa plaçka, me to po shkonte në treg! E takon Umeri dhe i thotë: “Ku po shkon?” - Për në treg, iu përgjigj Ebu Bekri. Pastaj Umeri i tha: “Çfarë të bësh, ty të është ngarkuar çështja e myslimanëve?” Ebu Bekri tha: “E si të ushqej familjen?” Umeri e këshilloi: “Kthehu, Ebu Ubejde<sup>49</sup> do të caktojë ty nga pasuria e shtetit”.

Kur u kthye, Ebu Ubejde i tha: “Do të jap ushqimin e një burri nga muhaxhirinët, jo sa më i miri prej tyre e jo sa më i keqi prej tyre, veshje për dimër e verë dhe kur të vjetrohët e kthen të vjetrën e të jap tjetër në vend të saj!”

Aishja r.a thotë, siç transmeton Et-Tabariju: “Shtëpia

48. Renegatëve

49. Ebu Ubejde ibnul Xher'rah ishte eminul umme, sekretari i pasurive të shtetit.

e babait tim ishte te gruaja e tij Habibe Ibnetu Kharixhe, ku kishte bërë një dhomë me gjethe hurme dhe s'kishte më tepër, derisa kaloi në shtëpinë e tij në Medine. Pas marrjes së besës, që nga koha kur u bë kalif, jetoi edhe gjashtë muaj në këtë dhomë prej gjethe hurmi”.

Lavdi i qoftë Zotit! Kam lexuar për pishinat me ajër të kondicionuar, në të cilat shkonte të kalonte pushimet shoku Hrushov në bregun e Detit të Zi. Ndjeva një fllad prej luksi që zbuti kohën dhe, ashtu duke lexuar prej së largu, mendoja se si do të ishte sikur të notoja në atë pishinë!

Të gjithë përfaqësuesit e popullit hanë e pinë gjërat më të mira e të shijshme nga pasuria e popullit dhe thonë për fenë se, ajo është opium për popullin, e për udhëheqësit, emirët e besimtarëve myslimanë se, ata kanë grabitur popujt! Sikur Hrushovi të kalonte një natë në dhomën e shtruar me gjethe hurmi e të sillej sa në një krah në tjetrin, në shtratin prej kashte që e mbron nga balta e tokës, çfarë do të kishte thënë? A do të kishte mbetur gjë nga thënia e tij: Feja drogogon popullin dhe se kalifët grabisnin popullin? Apo, e di se grabitësit e popullit janë dikush tjetër!!

Në këtë banesë modeste, të thjeshtë jetoi burri, i cili vendosi planin, strategjinë për shporrjen e Herkulit nga Shami njëherë e përgjithmonë dhe shporrjen e Kirsasë nga qyteti i tij, i cili jetonte në kështjellën e bardhë, të cilën Bahteriu<sup>50</sup> e përshkruante kështu: “Nuk e di, a e ndërtuan njerëzit për xhindet që të banojnë, apo xhindet për njerëzit?”

Pas Ebu Bekrit, erdhi Umer ibnul-Hatabi, burrë shteti i madh, strateg i luftës e i paqes dhe gjykues i paanshëm mes popullit e ministrave të tij!

Ajo që na intereson neve këtu është që të shfaqim dy cilësi nga historia e tij e lavdishme:

1- Ndjenja e tij e thellë për përgjegjësinë e pushtetit e shqetësimi i tij për llogarinë para Zotit.

2- Pastaj, refuzimi i tij i prerë për çdo shfrytëzim të pushtetit në favor të vetes apo të familjes së tij!

50. Bahteriu, 821-898, poet arab i periudhës abasite.

Në cilësinë e parë, përmendim thënien e njohur të tij: “Sikur një deve të humbte e të ngordhte në brigjet e Eufratit, do kisha pasur frikë se Allahu do të merrte në pyetje për të familjen e Hatabit”, d.m.th veten e tij. Kjo ngjan përsëri me atë që transmetohet nga ai: “Sikur një mushkë të rrëzohej në Irak, do konsideroja Umerin përgjegjës për të, përse nuk ia ka rregulluar rrugën”.

Nga Ebu Ravaha transmetohet se Umer ibnul-Hatabi i shkroi drejtuesve të tij: “Konsideroni njerëzit të barabartë para drejtësisë, i largëti i tyre si i afërmi dhe i afërmi si i largëti! Mjerë për ju në qoftë se merrni ryshfete, gjykoni sipas epshit, apo t’i gjykoni ata në kohën kur jeni të zemëruar. Bëhuni të drejtë, qoftë edhe vetëm në një orë të ditës”.

Ndërsa një ditë, ligjëroi e tha: *“O ju njerëz! Ju më emëruat udhëheqës tuajin, por sikur të mos ishte lutja dhe kërkesa juaj ndaj meje, duke më konsideruar si më të zotin në ju dhe për ju, si më të fortin dhe më ekspertin për t’ju përfaqësuar në detyrat dhe përgjegjësitë tuaja, nuk do ta kisha pranuar këtë gjë nga ju. Dhe do t’i kishin mjaftuar Umerit telashet e mërzitjet, në pritje të llogarisë për të drejtat tuaja; si merren dhe ku të vendosen ato? Çfarë udhëheqësi kam qenë për ju? Por, Zoti është Ndihmësi; Umeri tani nuk beson në asnjë forcë apo fuqi, në qoftë se nuk e mbulon Allahu me mëshirën, ndihmën dhe fuqinë e Tij”.*

-Ndërsa për shmangien e Umerit dhe familjes së tij nga çdo punë, e cila jep erë shpërdorimi të ligjeve, profesor El-Huderij ka thënë: “Kur mbreti romak ndërpreu betejën dhe filloi të diskutojë për paqe, Umeri i shkroi dhe e afroi që ta pranonte paqen, duke i dërguar përfaqësuesit e tij dhe së bashku me ta Umm Kulthum bint Alij ibn Ebi Talib, e cila ishte gruaja e Umerit, dërgon një dhuratë për mbretëreshën e romakëve, e cila mbante erë të mirë, enë uji dhe rrobë për gra, ia dorëzoi përfaqësuesve të postës që t’ia shpinin asaj.

Me të mbërritur dhurata, gruaja e mbretit mblodhi gratë e saja dhe u tha: Kjo është dhurata e mbretëreshës arabe, e bijës së Pejgamberit të tyre! I shkroi e i dërgoi edhe ajo një dhuratë, e cila mbante një zinxhir tepër të çmueshëm!

Sapo posta i mbërriti Umerit, urdhëroi për konfiskimin

e saj dhe thirri: “Es-Salatu xhamia”<sup>51</sup>! U mblodhën sahabet. Umeri i udhëhoqi në dy rekat namaz, pastaj tha: “Pa dyshim që s’ka mirësi një punë, e cila kryhet pa konsultim. Më thoni çfarë të bëj me dhuratën që Um Kulthumi i ka dërguar gruas së mbretit të romakëve, e cila pastaj i ka kthyer edhe ajo një dhuratë.”

Disa thanë: “Ajo i takon asaj se, edhe ajo i dërgoi një të tillë, d.m.th kompensimi i asaj që i dërgoi dhe gruaja e mbretit nuk është përgjegjëse për çështjet e popullit që kjo gjë të quhet ryshfet”. Të tjerë thanë: “Më përpara ishim që dhuronim rroba që të na dhuronin edhe neve, d.m.th të përfitonim diçka ndoshta më të mirë.” Umeri tha: “Por, përfaqësuesi, i cili e mbarti dhuratën, është përfaqësuesi i myslimanëve dhe posta është posta e tyre”. Pastaj Umeri shikoi që dhurata e dërguar për gruan e tij ishte shumë e çmueshme dhe se varësja në kraharorin e saj e shqetësonte, për këtë e konfiskoi dhe e vendosi në pasurinë e shtetit, pastaj i dha gruas së tij vlerën e dhuratës që ia kishte dërguar mbretëresha e romakëve.

Sipas historianëve, Umeri ishte person, i cili kur donte të ndalonte njerëzit për diçka, mblidhte familjen e tij dhe i thoshte: “Unë ndalova njerëzit për këtë e për këtë, e ata ju shikojnë juve sikur shikon skifteri për mish. Betohem në Zot, që sikur të gjej që ndonjëri prej jush bën atë që ndalova, kam për t’ia dyfishuar dënimin”.

Me të vërtetë, Umeri ruajti veten dhe familjen e tij qoftë edhe nga një qindarkë prej pasurisë së shtetit. Ai ishte tamam si kalifi i parë, lodhej e sakrifikonte në shërbim të popullit e të Mesazhit të tij, me besim e vendosmëri tek Allahu.

Myslimanët i dhuruan kësaj botë në rangun personal, shoqëror dhe politik parime e shembuj, të cilat mahnitin shikuesit duke i lënë me sy hapur. Arabët në epokën e mesjetës nuk lëvizën, u nisën nga boshllëku, por Islami derdhi metalin e çmuar në kallëpet e tyre, pastaj i hodhi në lindje e perëndim, duke e riformatuar botën në një formë të re. Popujt ia dorëzuan udhëheqjen e tyre fesë së ardhur, sepse

51. Thirja që përdoret në Islam për tubimin e njerëzve kur ka, ose ndodh diçka e madhe. Kuptimi i saj, ejani të tubohemi për namaz.



ata gjetën tek ajo shpëtimin dhe krenarinë e tyre.

Sado që të sektarizohen, të bëhen fanatikë të pafetë, të krishterët e sionistët kundër Islamit, kurrë nuk do të humbasin të vërtetat e mëdha të kësaj feje nga sytë e njerëzve dhe, as që do t'i shuajnë urrejtjet e zeza! Çfarë ekzistonte tek persianët e romakët, prej formave të pushtetit, të cilat u zbatuan në Medinën e ndritshme? Por, çfarë kishin ata prej veprimeve morale dhe bazave të edukatës? Ishte në interesin e pastër njerëzor, të shembeshin këto perandori të mbaruara, e këta religjione tirane mitologjike dhe të shkëlqente Islami mbi botën, që ta pastronte e ta ngrinte në një rang më të lartë.

## Dhe në epokën e re

Pastaj netët shkuan, ditët kaluan një e nga një. Ikën arabët e shekujve të epokës së mesjetës dhe agoi epoka e re mbi arabët e tjerë! Janë ndryshime që njeriu i vështron me hollësi, pastaj zemra e tij mbulohet me trishtim të madh. Qëndrimi i këtyre arabëve ka nevojë për sqarim e zbardhim edhe pse humbjet morale e materiale pushtojnë çdo drejtim dhe i mbulojnë me katra.

Dëgjohen biseda e fjalë nëpër takime që përfshijnë fusha sociale e kulturore se arabët mundet, bile duhet, të ndahen nga Islami, pastaj pas kësaj ndarjeje, prioriteti i takon arabizmit e jo fesë! Prandaj ajo, në qoftë se mund të mbijetojë, do të jetë pasues që lëviz me masë të caktuar, e sipas asaj që i lejohet!.

Kanë lindur shumë ide nacionaliste arabe e shumë mosmarrëveshje, të cilat janë të ngjashme me njëra tjetrën që të vendosin popullsinë myslimane brenda këtij kuadrati, d.m.th bindja ndaj kombësisë e jo ndaj fesë dhe ndaj atdheut e jo ndaj besimit! Guri i mullirit të luftës së fshehtë, apo asaj të hapur patjetër do të sillet ditën dhe natën, që të bluajë çdo gjë që i del përpara këtij qëllimi të lig.

Udhëheqësit arab duhet të marrin shembull nga udhëheqësi renegatë edhe në rast se nuk ia arrijnë qëllimit të tyre menjëherë ose me ngadalë! Kryesorja është që një ditë të arrijnë ta bëjnë popullin arab laik, ku marrëdhëniet e tij me Mesazhin hyjnor dhe me pasurinë e tij janë të prera krejtësisht.

Këto lëvizje tradhtarë janë përplasur shumë herë me rezistenca të forta, por pushtuesit me punëtorët e tyre ndjekin të keqen e të poshtërën për t'ia arritur qëllimit të tyre. Sa herë që mendonin se i janë afruar fitores, ngrihej dallgë pas dallgë besimi luftarak, shkatërronte fuqinë e këpuste shpresat e tyre. Përsëri rifillonin tradhtarët veprimtarinë tyre duke shtuar vrullin, por edhe një herë refuzonte ymeti islam duke luftuar deri në vdekje për mbrojtjen e asaj që kishte mbetur prej besimit. Beteja vazhdon të qëndrojë e hapur ndërmjet dy grupeve, por gjithashtu vazhdon të qëndrojë e fortë shpresa e besimtarëve që të dalin nga kjo fushë e përgjakshme dhe feja Islame të jetë sa më mirë!



## Çështje të rëndësishme

Tërheqim vëmendjen se, sundimi jo me atë që ka zbritur Zoti, ka mbështetës të shumtë, të cilët i ndihmon nga jashtë komunizmi, kristianizmi dhe sionizmi së bashku. Futja e mikrobeve të moraleve të prishura e dhënia pas epsheve ecin përkrah njëra tjetrës, së bashku me pengimin e prodhimit vendas e të ndërprerjes së duarve punëtores.

Gjithashtu, udhëheqësit ekzistuesë njohin shumë mirë vendin që zë feja Islame në popull, nga këtu ata përpiqen të afrojnë një grup dijetarësh të tjerë, siç quhen ndryshe “dijetarë të zbutur” që s’kanë pikë force as fuqie, që përfaqësojnë fenë në një drejtim të caktuar, duke shfaqësuar armiqtë e fesë ndaj akuzës për dyshim e tradhti, edhe pse në radhë të parë janë duke punuar për llogari të komunizmit, sionizmit e kolonizimit.

Ndërsa, gjëja në të cilën do të qëndrojmë për pak çaste, ballë për ballë me të, është fronti aktiv që punon me sinqeritet për Islamin, por gabimet këtu shumë herë janë vrasëse, madje të çarat që ekzistojnë, shumë herë bëhen vrima depërtuese të rrezikut, ose vrima nga ku hyjnë armiqtë për t’ia veshur pastaj fesë Islame e ymetit të saj vuajtjet më të këqija!

Nganjëherë, peshoj mes formës së Islamit të vërtetë dhe formës së Islamit në trurin e çdonjërit prej thirrësve dhe shoh ndryshimin ndërmjet këtyre formave, siç është ndryshimi midis makinës lodër të fëmijëve dhe makinës së vërtetë që çan përpara rrugën!

S’ka dyshim që dituria e pakët tek ato që punojnë në thirrje është krim! Jo çdo mysliman është i kërkuar të jetë dijetar i vendosur, por udhëheqja dijetare duhet të ketë cilësi të larta. Në kohën që po jetojmë janë shtuar shumë njohuritë e medh’hebet janë armatosur me burra të mençur, prandaj në qoftë se udhëheqësit e frontit islamik mbesin në nivelin e tyre të zakonshëm, atëherë e ardhmja do të jetë e zyrtë. Dihet mirë që thirrësit, të cilët i bëjnë dobi fesë dhe ymetit të tyre, do të hasin vështirësi të shumta. Le t’i hasin!! Ngase ky është syneti, ligji i Zotit për të parët e për të fundit, nuk lejohet frika nga kjo dhe as justifikimi që të neglizhohet.

## Nuk është nga thirrësit

Në asnjë mënyrë dhe kategorikisht, nuk mund të numëroj thirrës personin, i cili ka bagazh të paktë në historinë politike të Islamit, apo në historinë legjislativë të tij, ose personin, i cili nuk kupton, veçse fare pak nga botëkuptimi Islam, sepse të kuptuarit e tij në Kur'anin e shenjtë është i errët, i paqartë. E gjithë ajo që ai di janë disa hadithe, në qoftë se janë të saktë, por ai nuk di se si t'i vendos në vendet e tyre.

Nuk mund të rendisim në vargun e thirrësve personin, i cili nuk njeh nga bota bashkëkohore asgjë e, as nga filozofitë që e sundojnë dhe as sekretet e superioritetit të fesë Islame ndaj tyre. Gjithashtu, nuk mundemi të numërojmë prej thirrësve personin, i cili kërkon përhapjen e Islamit në perëndim, duke përhapur tradita e zakone, të cilat i mendon se janë nga feja dhe ato në realitet nuk janë nga Islami, madje mund të shërbejnë si përcmuese për largimin e atij populli, si p.sh, duke i marrë gruas të drejtat e saj, të cilat feja Islame ia ka dhuruar, nën pretekstin e zakoneve popullore në një mjedis të caktuar.

Me këtë s'do të thotë se jemi dakord me paturpësitë dhe përzierjen e ndyrë të përhapur atje. Islami është i ndryshëm nga zakonet që mund të jenë këtu, apo atje. Ai ka dispozitat e tij, të cilat i caktojnë dijetarët e jo budallenjtë.

Ka dijetarë feje, të cilët nuk dinë asgjë nga të drejtat e njeriut, që nuk dinë asgjë nga ligjet, të cilat fiksojnë marrëdhëniet në mes shtetit dhe popullit dhe as që nuk marrin vesh asgjë nga fazat, në të cilën kanë arritur marrëdhëniet ndërmjet shteteve. Ajo që është më e keqe, nuk dinë gjendjen e bashkësisë së shteteve islame në mes të bashkësive të tjera e as që nuhasin aspak intrigat e natës që kanë për qëllim fenë e tyre dhe në atë çfarë planifikohet për kufizimin e të ardhmes së tyre kulturore e shoqërore.

E kështu e pason këtë dobësi në mendim se çështjet, të cilat janë më të rëndësishme e mbi të cilat qëndron pika e ndarjes, konsiderohen si anësore, imagjinare, apo histori pa vlerë...

## Arabët e kohës së re

Le të kthehemi tek arabët e kohës së re, të cilët kërkojnë krenari pa fenë Islame, të cilët mbështesin lënien pas dore të dispozitave e obligimeve të saj. E ajo që dihet mirë është se, kur feja Islame të jetë krenare bëhen krenarë edhe arabët e, në qoftë se sundon ajo, sundon edhe gjuha e letërsia e tyre.

Megjithatë, ajo që është për t'u habitur në rrugën e tyre, është se ato bëhen nacionalistë të arabizmit dhe mohojnë zotërinë e vetëm e të lavdishëm, të cilin Zoti e zgjodhi mes tyre, ku me të i vuri kurorën e mbretërisë të parëve e të fundit të mbretërve, e dërgoi me vulën e feve dhe me Mesazhin më të çmuar. A mundet që ndonjë arab ta urrejë Muhamedin a.s, i cili është nderi e krenaria e tyre!?

Pastaj, si mund të jetë arab ai që nënvlerëson gjuhën arabe, e preferon para saj gjuhë të tjera? E vërteta thotë se ndjenja nacionaliste këtu është perde e hapur e lëvizjeve shkatërruese, me të cilën kërkohet vetëm goditja e fesë Islame dhe shkulja e themeleve të fesë në vendet islame. Mund të themi se, kjo lëvizje fatkeqe është kryqëzatë e krishterë e suksesshme në kohën e re!!

Në të kaluarën arabët ishin fanatikë për veten e tyre, por çfarë përfituan nga ky fanatizëm nacionalist? Humbën veten dhe shpalljen e tyre, si rrjedhim i këtij fanatizmi të verbër, arabët u fshehën nga betejat vendimtare të Islamit, qofshin luftarake, politike apo kulturore. Kjo është ajo që kanë për qëllim?

Në qoftë se tani kërkohet të jenë fanatikë të arabizmit dhe zgjimit të një progresi mbi themelet e tij, a duhet të marrim shembull nga populli i Adit dhe i Themudit? Apo nga Imrul Kajs e Turfete ibn-ul Abd<sup>52</sup>? Dhe, a to të jetë mohimi ynë për fenë Islame e të Dërguarin e saj tërësisht apo pjesërisht? Kush do të jetë këshilltari ynë në këtë caktim, rusi, apo amerikani?

52. Poetë arabë të periudhës paraislame.

Shpresoj që të mbarojë kjo tragjedi, ose kjo komedi! Të shikoj të krijuar një këshillë nga të gjitha racat e kombet, të cilët kanë përqaftuar fenë Islame, prej arabëve, turqve, indianëve, persianëve, indonezianëve, afrikanëve etj, që të shuhet dallimi racor në qenien islamikë të përbashkët, që të shembet çdo çarje xhahile.

Gjithashtu, mundet ripërtëritja e asaj që u dobësua nga lidhjet e vjetra, ashtu siç mundet bashkëpunimi në konferenca e tregje të përbashkët për t'i përballuar të ardhmes të mbushur me vështirësi e urrejtje. Le ta dinë arabët mirë se, ata përpara çdo kujt tjetër, do gëlltiten në ditën që do të lënë fenë Islame e të thyejnë besën e Zotit e të Dërguarit të Tij.



## KAPITULLI IV

### Sprovat e gjuhës arabe dhe rreziqet që ajo përmban

Ka shumë kohë që arabët nuk kryejnë detyrën e tyre në drejtim të gjuhës së shpalljes dhe për këtë gjë as që kanë justifikim para Zotit xh.sh e, as përpara njerëzve.

Egjiptianët, shamitët<sup>53</sup> e të tjerë si ata, lanë gjuhën e tyre të parë dhe preferuan gjuhën e Kur'anit, d.m.th. dashuria e tyre për fenë Islame ishte ajo që i arabizoi duke emigruar nga një fe në një tjetër dhe duke kapërcyer nga një gjuhë në një tjetër.

Në qoftë se arabët kanë ndonjë mirësi është se, ata përçuan Islamin tek mbarë bota dhe e transmetuan me trimëri e forcë të paparë si asnjëherë te pasuesit e ndonjë pejgamberi të mëparshëm. Pasuesit e Isait a.s u treguan të pafuqishëm të bënin të njëjtën gjë. Ata i dhanë mundësi një njeriu hebre, si Pali, të devijojë shpalljen nga qëllimi i saj i vërtetë, e ta nxjerri fenë e Isait nga bazat e para të saj. Prandaj duhet t'i falënderojmë arabët sepse ata e mbajtën me vigjilencë, e transmetuan me amanet të paprekur dhe sakrifikuan shpirtirat e tyre për besimin islam.

Arabët janë vetëm 1/7 e myslimanëve dhe detyra e tyre është t'ua mësojnë gjuhën arabe vëllezërve të besimit, bile e kanë për detyrë shtrirjen e saj në të gjithë rruzullin tokësor, sepse shpallja e tyre është botërore, për këtë janë të obliguar t'ua lehtësojnë njerëzve rrugën për të arritur deri te gjuha e tyre.

53. Banorët e krahinës së Shamit: Siri, Jordani, Liban, Palestinë.

Ne shikojmë se, si anglezët në kohën tonë po bëjnë çudira në përhapjen e gjuhës së tyre në gjithë botën duke shpikur lloj-lloj metodash, për ta bërë atë të dashur te të gjithë, derisa është bërë gjuha angleze gjuha e botës dhe gjuha e shkencës gjithashtu.

Ndërsa ne, nuk bëjmë asgjë nga kjo, por përkundrazi u sulmuam në vatër të shtëpisë sonë, duke lejuar gjuhë të tjera të na pushtojnë e ta largojnë gjuhën arabe nga vendet tona të para.





## Fyerja e arabishtes

Sot, gjuha arabe po fyhet e injorohet nga disa drejtime:

1- Serialet e ndryshme televizive, të cilat flasin me shprehjet e rrugës, tregut dhe të shtresave injorante, duke ngjallur kështu shprehje, të cilat duhet të kishin vdekur në lindjen e tyre, ku mërzhisin dëgjuesit me lloj-lloj dialektesh të padëgjuara!

2- Drejtuesit, të cilët nuk e flasin mirë letraren dhe ëndërronjë që t'i flasin popullit me orë të tëra, ku biseda e tyre vjen larg mendjes dhe të menduarit, ngatërrohet letrarja me dialektin, të përmalluar që të ndryshojnë, ngatërrojnë, përziejnë rasat e emrit nga njëra në tjetrën dhe as që dinë ndonjë gjuhë në botë, ku drejtuesit e saj të flasin në këtë mënyrë!

3- Personat, të cilët ndjekin e imitojnë kolonizatorët pushuesë, ku personaliteti i tyre shkrihet plotësisht dhe duke e konsideruar atë si zhvillim, pranojnë të jetë biseda e tyre në çfarëdolloj gjuhe, veçse në arabisht jo. Këta tipa njerëzish, mendimet i kanë në lëkurat e tyre, siç thuhet. Ata rrihen me kamxhik që të kuptojnë dhe nuk kanë mendje që i udhëheq, apo t'i binden asaj!

4- Ndërsa gjëma e madhe është tek anëtarët e akademive, të cilët mendojnë se gjuha arabe shembet para shprehjeve të civilizimit të ri, termave të shkencave të ndryshme dhe me gjithë këtë, ata as nuk lozin kënd nga vendi edhe pse gjuha arabe është me të vërtetë në rrezik!!



## Në fushën e letërsisë

Në kohën kur kolonizatori kulturor varroste për së gjalli gjuhën letrare në fushën e shkencës, nuk pushonin përpjekjet e tyre të pandërprera për vrasjen e saj edhe në fushën e letërsisë. Por, që t'i zbulojmë rrugët e kësaj vrasjeje le të kthehemi pak prapa.

Që 50 vite më parë, gjuha arabe u përtërit me një progres letrar me poezinë dhe prozën e saj, duke i ngjarë, apo duke u rritur mbi shkëlqimin e saj të vjetër në fillim të sundimit Abasit! Nuk ka ngjarë kurrë në historinë tonë letrare që të bashkohen në të njëjtën kohë koka të shquara të letërsisë, siç ka ngjarë kjo në shekullin e kaluar. Kështu në fushën e prozës u shfaq Rafij, Ukadi, Ahmed Emin, Zekij Mubarek, Taha Husejn, Ahmed Hasen Ez-Zejjet, Alij Tantavi, Sheuket Erslan dhe të tjerë.

Përkatësia shpirtërore e secilit prej tyre ishte e ndryshme. Ndër ta kishte të sinqertë dhe të devotshëm me fenë Islame nga lindja deri në vdekje, por kishte edhe prej atyre, të cilët pinë nga burime të huaja, madje në një pjesë kohe edhe u ndikuan në shkrimet e tyre, si p.sh Ukadi, i cili u ndikua nga letërsia saksonë, Taha Husejni, i cili u ndikua nga letërsia latine. Mes këtyre të dwe pati kritika e debate rreth kësaj përkatësie dhe vlerës së saj njerëzore e kulturore. Kishte prej tyre, të cilët i mbizotëroi ideja e orientalistëve dhe duke u udhëhequr nga teoria e analizës.

Por, për të gjithë këta, gjuha e tyre ishte gjuha letrare dhe kishin ndjenja të larta retorike, urrenin shumë dialektet dhe largoheshin prej tyre, por edhe pse fillimi i tyre ishte në atë përzierje siç e përmendëm, shumica e tyre e përfunduan jetën me të mirë. Kështu që, Ukadi nuk vdiq derisa shkroi një prej librave të tij më të bukur e më të pavdekshëm në fenë Islame, në realitetin dhe pamjen e saj.

Pothuajse kështu, qe edhe Taha Husejni, i cili filloi si ateist renegat, pastaj filloi të afrohej nga feja Islame. Bëri umren dhe vizitoi xhaminë e Pejgamberit a.s.

Profesor Muhammed Fet'hi, miku im, më tregoi se, kishte qenë me Taha Husejnin pranë varrit të pastër të Pejgamberit a.s, të cilin e mbaja për krahësh dhe trupi i dridhej me forcë! Siç duket kolonizatori kulturor u përpoq të thante shpirtin fetar në fushën e letërsisë, por ai nuk pati suksesin e duhur, kështu që, gjuha letrare mbeti përsëri e lartë dhe e rëndësishme.

Po kështu, edhe në fushën e letërsisë fetare u gjetën dijetarë, thirrës, mendimtarë dhe komentuesë, të cilët patën shpërthyer në retorika e inteligjencë, si psh Muhammed Reshid Rida, nxënësi i imam Muhammed Abdo-s, Muhammed Ferid Vethdij, Xhemal-ud Din Kasimij, Mahmud Sheltut, Muhammed Behji, dijetari i madh Muhammed Ebu Zehra, historiani i madh Muhammed Hudari, reformatori Islam i shekullit të 14-të Hasen Benna, e shumë e shumë të tjerë. Arabishtja në gjuhët e tyre, kur predikonin dhe kur shkruanin shpërthente burime të kulluara. Sikur të ishte shkruar, që ky grup njerëzish të jetonin gjatë, patjetër do të ngrihej lart niveli i popullit dhe do ta kthenin në kufijtë e gjuhës nga e cila ishin larguar.

Ndërsa në fushën e poezisë gjendeshin Ahmed Sheukij, Hafidh Ibrahim, Halil Matrani, Zehavi, Rasafi, Ahmed Muhrimi, Alij Xharimi, e shumë të tjerë. Të gjithë këta nuk janë më poshtë se Mutenebbiu, Muar'riu, Ebi Temam, Beshar ibn Burd, madje ka prej kritikëve dhe historianëve të letërsisë arabe, të cilët shohin se Ahmed Sheuki është babai i poetëve arab, të vjetër e të ri.

Të gjithë këta poet ishin ndjenja e ngrohtë e fesë Islame dhe dashuria e saj e gjallë. Sheuki ishte vajtuesi e hidhëruesi në mortet dhe disfatat e fesë, ashtu siç ishte Muganni gëzuesi në fitoret dhe trimëritë e saj. Poezia ishte ajo që udhëhiqte betejat e lirisë kundër pushtuesit të huaj dhe ndizte zjarret e ndjenjave të popullit, të cilat shpërthenin sa në një kohë në tjetrën për të mbrojtur ekzistencën e tij morale dhe materiale. Duket qartë se kjo rilindje letrare u ndërtua mbi themelet e para, duke u lidhur me krenaritë e myslimanëve, që i humbi neglizhenca e mashtrimi!

Po qe se është letërsia pasqyra e popullit dhe rrahjet e zemrës së tij; atëherë vëzhguesi i letërsisë së këtyre ditëve shterpë nuk shikon aspak në këtë letërsi tiparet e fesë Islame apo të arabizmit dhe as përmallimi i një ymeti, i cili sakrifikon për shpalljen e politikën dhe për kulturën e tij kombëtare. Çfarë vihet re në fletët e kësaj letërsie? Asgjë, përveç se mohim i origjinës e i qëllimit dhe kalim nëpër lëndë të ndryshme të huaja dhe ngurrim për të marrë atë që gjen, të cilës s'i dihet origjina.

Me të vërtetë poezia arabe ka muzikën e saj të veçantë, ku disa transmetuesë i numërojnë 16 melodi që përputhen me ndjenjat dhe i përshtaten dëshirave njerëzore me një përshtatje magjike të bukur.

Ndryshimi ndërmjet fjalës së zakonshme dhe vargjeve të renditura, është sikur ndryshimi në mes zërave të zakonshëm dhe tingujve të fyellit e të veglave muzikore. Të mos harrojmë se kanë lindur shumë poetë të talentuar në historinë letrare, ku pasuria e tyre vazhdon të jetë temë e studimit, vlerësimit dhe përsëritje e asaj që mbante prej ndjenjave e përvojave.



# KAPITULLI V

## Në mes të drejtësisë dhe ekstremizmit

Edhe pse jam tip që kam emocione të nxehta dhe ndjenja të forta, megjithatë unë preferoj qetësinë e butësinë para ashpërsisë e egërsisë. Ia imponoj vetes logjikën e mendjes, e ndoshta i detyroj ndjenjat e emocionet nën gjykimin e mendjes, edhe pse ata kundërshtojnë! Përfundimi im për këtë gjë është i mirë në dynja e shpresoj edhe në ahiret!

Dikur, një debat i ashpër ndodhi në mes meje dhe një të riu, i cili punonte në fushën e Islamit. Në atë debat më tepër dëgjoja sesa bëja koment dhe në fund të fundit ia thashë të gjitha që kisha. Ai më tha: “Ju na akuzoni për ekstremizëm, por a nuk na shpjegoni pak qëndrimin ekstremist të tjetrit ndaj nesh dhe të zbuloni rrugën e tij ekstremiste se, a ka qenë i drejtë apo ekstremist? Një person ka bërë me ne këtë e këtë, ka vrrarë e derdhë gjak, etj, etj.”

Iu përgjigja: “Ky person ka vdekur që vite më parë dhe thua ai po shikon punën e tij, Zoti e mëshiroftë!”

Por, bashkëbiseduesi bërtiti: “Mos e mëshiroftë Zoti e, as mos e faltë. Sikur Pejgamberi a.s të kërkonte falje për të, nuk do t’i pranohej kjo gjë! A nuk e ke lexuar fjalën e Zotit xh.sh për Pejgamberin e tij: *“Kërko falje, ose mos kërko falje për ta, edhe n.q.s kërkon falje për ta 70 herë, Zoti nuk do t’i falë, sepse ata kanë mohuar Zotin dhe të Dërguarin e tij. Me të vërtetë Allahu nuk e udhëzon popullin mëkatar”*<sup>54</sup>.

U përpoqa të flas...! Por, ai vazhdonte duke nxituar! Çfarë thua për një njeri, i cili ka poshtëruar arabët dhe ka lejuar

54. Sureja Teube, ajeti: 80.

hebrenjtë të mëkëmben? Çfarë thua për një njeri, i cili ka zhdukur gjykatat fetare, vakëfet islamike dhe ka lejuar të derdhet gjaku i popullsisë islame, ose ka vendosur gjithë aktivitetin e saj në mbikëqyrje të sigurimit, duke vrarë qindra besimtarë nëpër burgje në mënyrat më çnjerëzore dhe duke torturuar mijëra të tjerë aq sa të thinjen qimet e flokut. Ai poshtëroi ata që, Zoti i nderoi dhe nderoi ata që, Zoti i poshtëroi. Nuk ka lënë poshtërsi pa bërë dhe ka përlyer fytyrat e myslimanëve me tym e poshtërsi. Ai u dha mundësi armiqve të Zotit, atë që nuk është parë prej mijëra vitesh!?

Me dashamirësi i thashë: “Mos i ripërtyp dhimbjet e kaluara, por puno për rindërtimin e Islamit, të jetë kjo pjesa më e madhe e mendimit tënd, sesa hakmarrja jote dhe kërkimi i gjakut.

Dëgjoni me vëmendje ata që ju njohin me të vërtetat e Islamit, prej edukatorëve të mëdhenj, dijetarëve të shquar, në vend që të mjaftohesh vetëm me një lexim të disa librave”.

Djali me neveritje më tha: “Dijetarët e mëdhenj? Një urdhër ju dha këtyre të mëdhenjve për të pritur “Makarios-in”, kasapin e Islamit në Qipro dhe u prit me nderim në Ez’herin Sherif.

Një urdhër tjetër u lëshua për dhënien “Sukarnos”, një komunisti ekstremist që njihet mirë në Indonezi, diplomën e doktoratës në filozofi dhe, këta të mëdhenjtë u mblodhën e ia dhanë nga Ez’heri Sherif këtë doktoratë. Një urdhër i tretë u dha për vendosjen e gurit të parë të një kishe, ku shpejtoi sekretari i Ez’herit në pranimin e urdhrit të drejtuesve, të cilët e urdhëruan. Kurrë nuk ka ndodhur në historinë e Vatikanit që të caktohet person fetar katolik e të vendosë gurin e ndonjë kishe që kundërshton rrugën e tij!!

Këta dijetarë heshtën ndaj padrejtësive, të cilat ia humbën popullit ndërgjegjen e trimërinë e tij. Ata pranuan të luftojnë dukuritë fetare dhe devotshmërinë, duke e ditur se ne po konfrontohemi me një shtet fetar, i cili ka ngritur qenien e tij mbi supet tona!

Iu përgjigja: “O djali im, nuk janë të gjithë dijetarët ashtu siç i përshkruan ti dhe, në qoftë se vazhdon ti e shoku yt në këtë rrugë, atëherë nuk do të ktheheni kurrë”.

## Udhëheqësit e popullit

Havarixhët përpara jush i hipën këtij kali dhe u varrosën shpejt në rrjedhën e historisë. Ata që udhëhoqën Mesazhin Islam nuk ishin udhëheqës të këqij dhe as opozitarë budallenj! Me të vërtete, ata që udhëhoqën Islamin ishin dijetarë, edukatorë dhe mendimtarë të sinqertë.

A të them që hebrenjtë janë më të mençur se ju?

- Si?, më pyeti djali.

- Kur u mbledh kongresi i parë botëror në Zvicër, që të ndërtonin shtetin e tyre, arritën në një plan të studiuar, ku kryetari tyre, Hertz tha, Izraeli do të ngrihet pas 50 vitesh! Dhe u ngrit pas 50 vitesh..

Ky njeri nuk punoi për veten dhe as për fëmijët e tij. Mbollli një strategji të largët, ndoshta ai nuk i shijoi frytet e saj por nipërit! Nuk ishte qëllimi të shikojë prodhimin e asaj që punoi, e rëndësishmja ishte t'ia arrinte qëllimit të tij. Ky njeri vuri në dispozicion një gjysmë shekulli, sepse ai donte të likuidonte problemet që kishin dalë gjatë shekujve me radhë, të cilët nuk mund të likuidoheshin me një vizë lapsi apo me një thirrje të zjarrrtë!!

Është padrejtësi t'ia ngarkojmë brezave të sotëm mëkatet e disfatave, të cilat na kanë mbuluar, ato janë korrja e tradhtive popullore dhe politike, të cilat ndodhën për një kohë të gjatë. Atëherë, si mendoni t'i zhdukni ato me plane të pastuduara e sakrificave gjysmake?

I Dërguari ynë a.s, ditën që thirri në besimin në një zot, qindra idhuj ndodheshin rreth Qabes dhe vazhdoi duke bërë thirrje 23 vjet. A e dini se kur u shembën këta idhuj? 21 vjet pas fillimit të Thirrjes, d.m.th një vit para se të çlirohej Meka. Ai, madje as në Umren e Kadasë, nuk mendoi që t'i prekë ato, apo t'u bëjë ndonjë të keqe.

Ndërsa, ju dëshironi ta bëni thirrjen për në një zot të vetëm në mëngjes, e përleshjen e shembjes së idhujve në mbrëmje! Përfundimi, nuk ka rrugë tjetër, janë grindjet e

vazhdueshme, lodhjet që nuk pushojnë dhe pamaturitë, ku Islami duhet të mbajë dëmet e tyre, pa pasur nevojë për to!!

Dua t'ia bëj të ditur mirë të rinjve se, ngritja e fesë është gjithë tjetër dhe mbizotërimi i një grupi njerëzish në një qeverisje është përsëri gjithë tjetër. Pa dyshim që ngritja e fesë kërkon përcaktime të mëdha bindëse e të sinqerta dhe dëlirësinë e lidhjes me Zotin, ashtu siç kërkon edhe eksperiencë të gjerë me jetën, me njerëzit, me miqtë dhe me armiqtë, pastaj urtësi, të cilën e mbështet mbikëqyrja e lartë, në veprim, ndalim, paqe e luftë!

Ka pasur njerëz që kanë sunduar në emër të Islamit, të cilët diskredituan veten e tyre e së bashku me ta diskredituan edhe Islamin! Sa e sa prej tyre që kërkuan sundimin, i cili i shtyn në ngritjen e sundimit mbi bazat e dashurisë së vetvetes, në kërkimin e lavdisë e budallallëkun e madhështisë!

Sa e sa ka prej atyre që kërkojnë sundimin, të cilët nuk dinë gjithë për marrëdhëniet ndërkombëtare, rrymat botërore, konferencat e fshehta dhe jo të fshehta!! Sa e sa ka prej tyre që kërkojnë sundimin në emër të Islamit, të cilët nuk njohin medhhebet islame në Usul e as në Furu'ë<sup>55</sup> dhe, po qe se do të sundonin do të kishin qenë barrë në besim për vëllezërit e tyre, do të preferonin sundimin e një jobsimtari të drejtë para tyre!

Më ka rastisur të shikoj njerëz që bisedonin për ngritjen e shtetit Islam, por të cilët nuk dinin gjithë tjetër, përveçse udhëheqësi nuk është i detyruar të konsultohet, ose zekati nuk është detyrë veçse në katër lloje frutash e të mbjellash se, ekzistenca e opozitave është haram dhe se, biseda për kartën e të drejtave të njeriut është bidat, etj. A thua këta njerëz bëjnë për ndonjë gjë?!

Ndonjëherë kryej ndonjë punë, pastaj i kthehem ndikimit të saj në veten time dhe ndjej se nuk kam qenë në atë punë i sinqertë ashtu siç duhet! Më ka mbuluar dashuria e kësaj bote ose mburrja me veten dhe ndjej dhimbje e pendim. Shikoj se unë, me këtë përzierje nuk jam i vlefshëm në udhëheqjen e

55. Usul: bazë, rrënjë, Furu': degë, filial.



njerëzve dhe në ngritje lart të fjalës së Zotit. Kjo, sepse Allahu kur zhdruk zullumqarët, nuk sjell pas tyre zullumqarë si ato, por Ai sjell myslimanë të drejtë e të vlefshëm.

Zoti xh.sh thotë, duke sqaruar rrugën e atyre që Ai mbështet prej krijesave të Tij: *“E përse të mos i mbështetemi Allahut derisa Ai na udhëzoi në rrugën tonë (të drejtë). Për Zotin, ne gjithsesi do të durojmë e do t’i përballojmë mundimet që na bëni, e vetëm Allahut le t’i mbështeten vazhdimisht ata që gjithnjë iu mbështeten. Ata që mohuan të dërguarit e thanë thanë: “Për Zotin, ne do t’ju dëbojmë nga vendi ynë, ose ju domosdo do të ktheheni në fenë tonë!” E atyre (të dërguarve) Zoti u shpalli: “Ne gjithqysh do t’i shkatërrojmë zullumqarët”. Dhe pas tyre Ne do t’ju vendosim në atë tokë. E këtë (ndihmë) për atë që i frikësohet pranisë Sime dhe i frikësohet dënimit Tim”<sup>56</sup>.*

Ekziston një kufi i mendjes e i plotësimit vetjak, të cilin patjetër duhet ta arrijë kushdo që dëshiron t’i shërbejë fesë dhe ngritjes së shtetit në emër të saj. Plotësimi i këtij kufiri nuk vjen menjëherë, por arrihet në drejtimin e vetes për një kohë të gjatë.

Zoti më mbrojtë që të akuzoj të tjerët për qëllim të keq, por unë dua mbrojtjen e progresit tonë nga sëmundjet, të cilat nuk çojnë në realizimin e qëllimit, e as nuk realizojnë pikësynimin.



56. Sureja Ibrahim, ajeti: 12-14.

## Prej shkaqeve të ekstremizmit fetar

Në shtrembërimin e fesë ekzistojnë shkaqe shpirtërore, psikologjike dhe të tjera shkencore, të cilat shfaqen në thënie të veprat e njeriut ku vihen re gjykime, të cilat i jep ky njeri mbi persona apo gjëra! Këto shkaqe ndryshojnë nga njëra-tjetra sipas forcës e dobësisë dhe sipas madhësisë, shumë apo pak, por ato sidoqoftë kanë një ndikim të thellë në marrjen e qëndrimeve dhe të drejtimeve!

Ajo që kërkohet nga adhurimet, të cilat i ka obliguar Zoti xh.sh për njerëzit, është që këto të pastrojnë ndërgjegjen, ta mbrojnë ate nga sëmundjet e jashtme e të brendshme dhe ta imunizojnë moralin njerëzor nga shtrembërimi, degradimi, padrejtësia, abuzimi.

Kjo gjë do të plotësohet detyrimisht, sikur adhuruesit do të tejkalonin anën formale të adhurimeve të realiteti i tyre dhe po të binin në sexhde ndërgjegjet e zemrat për hir të Zotit xh.sh, në kohën kur bëjnë sexhde trupat dhe të lëvizte gjëja me e shtrenjte në qenien e tyre, zemra e mendja, në kohën kur lëvizin gjuhët e tyre.

Ama, në qoftë se adhurimet do të qëndrojnë në cipën e dukshme dhe në shfaqjen e falsifikuar, atëherë ato nuk do të largojnë të këqijat e, as nuk do të shërojnë sëmundjet. Një ditë prej ditësh duke shkruar për Huteje-n, kur punoja në Thirrje pyeta veten: Çfarë mund të presësh nga një njeri me natyrë të ulët, përveçse këshilla me fjalë therëse dhe shprehje të këqija?

Natyrat e disa njerëzve e shtrembërojnë fenë nga pamja e saj dhe në vend që të udhëzojnë, pengojnë e, në vend që të japin, marrin! Ndërsa, Kur'ani famëlartë na tërheq vëmendjen ndaj rrezikut të largimit për shkak të priftërinjve hebre e të krishterë, të cilët e kanë bërë fenë fall, ku me të prishin natyrën origjinale duke kërkuar interesa të kësaj bote. *“Me të vërtetë shumë prej priftërinjve (jehudi e të krishterë) kanë pasuritë*

*e njerëzve padrejtësisht dhe pengojnë nga rruga e Zotit*<sup>57</sup>.

Këta lloj njerëzish janë epidemia e krejt feve dhe për këtë poeti thotë: “A nuk e prishën fenë përveçse mbretërit e priftërinjtë e saj të këqij. Shitën shpirtrat dhe nuk fituan, sepse çmimi i shitjes ishte i lirë”!

Plagët shpirtërore e psikologjike fillojnë që në vegjëli, madje mund të vijnë së bashku me tiparet e trashëgimisë dhe, në qoftë se nuk do t’i shërojë edukimi i mire, ato rriten me njeriun deri në rini dhe mbesin në gjakun e tij edhe në pleqëri! Shiko një njeri, si p.sh Ebu Sufjani, i cili ka qenë udhëheqës i Mekës dhe plaku i preferuar në xhahilje<sup>58</sup>. Nuk i shpëtonte burrave që e njihnin se, ai e do mburrjen dhe se një fjale e vetme në rendësin e tij, mund të ndryshojë në gjykimin e tij.

Abasi r.a i sugjeroi të Dërguarit të Zotit që të bëjë diçka për Ebu Sufjanin, i cili të ndjehet i qetë për pozicionin që ka pas fitores se tevhidit, Islamit mbi Ummil-Kura<sup>59</sup>. Pejgamberi a.s ju përgjigj mendimit të xhaxhait të tij dhe tha: “Kush hyn në xhami, Qabe ai është i sigurt, kush hyn në shtëpi të Ebu Sufjanit edhe ai është i sigurt dhe, kush qëndron në shtëpinë e tij edhe ai është i sigurt”. Kështu që Ebu Sufjani u qetësua pasi ia përmendi emrin dhe hapi rrugën për dorëzimin e Mekës pa luftë!

Ndoshta sëmundja shpirtërore mund të fshihet pas ndjenja-ve të zjarrta të cilësive e xhelozisë, ndaj të vërtetës etj. Shembulli më i qartë për këtë punë është njeriu, i cili tregoi rezerva në ndarjen e Pejgamberit a.s të plaçkave të luftës, El-Ganaim, që tha: “Në këtë ndarje nuk është pasur parasysht kënaqësia e Zotit”.

Pejgamberi a.s mund t’i zbusë disa njerëz me ndonjë gjë prej gërmadhave të kësaj bote, sepse bindja e plotë nuk ka zënë vend akoma në zemrat e tyre dhe dilte si detyrë për personin që nuk i pëlqen ndarja të pyeste për fshehtësinë e saj, ose të nxitonte duke akuzuar krijesën më të nderuar,

57. Sureja Teube, ajeti: 34.

58. Periudha e injorancës paraislamike.

59. Ummul kura, emër i Mekës i përmendur në Kur’an.

Pejgamberin a.s dhe kjo për shkak të sëmundjes së shpirtit!

Pejgamberi a.s na ka bërë të ditur për këta lloj njerëzish, të cilët falen e lexojnë Kur'an shumë, por ibadeti i tyre nuk ua pastron shpirtin e as nuk ua shëron sëmundjen! Në betejën e "El-Usre-s" Pejgamberi a.s pyeti për Keab ibn Malik, se çfarë e ka vonuar atë? Një njeri duke e akuzuar tha: "E ka penguar shikimi në burden e tij!"

Kjo ishte fjalë fyese, e cila shprehte smirën! Keabi ishte njëri prej tre personave, të cilët mbeten pa marrë pjesë në këtë betejë dhe Zoti i fali e ua pranoi pendimin. Gjatë krizës, Keab-it i erdhi një letër nga mbreti i Romakëve i cili e nxiste të braktisë Medinën dhe ta pasonte e të ndihej krenar në rrethin e mbretit, por ai e konsideroi këtë gjë një fatkeqësi dhe e dogji letrën! Ai priti Mirësinë e Lartë derisa i erdhi, Atij i takon ajo gjë, megjithëse disa njerëz e shikojnë tjetrin me syrin e urrejtjes, duke shfaqë e fshehtë barazinë e lëvdatat, por pret t'i vijë rasti i parë që të nxisë urrejtjen që mbart fshehur.

Erdhi një delegacion tek i Dërguari i Zotit a.s, ndër ta ishte një njeri llafazan, bastard! Sa herë që Pejgamberi a.s fliste, ai shprehej me fjalë më letrare dhe përpiquej të dilte me to mbi Pejgamberin a.s. Dhe, erdhi komenti hyjnor për të cilin tha se, ky dhe të tjerë si ky që përdredhin gjuhët me fjalë ashtu siç përdredh lopa gjuhën e saj për të përtypur barin, ata kanë zjarr në Ditën e Kiametit!

Sa e sa kemi parë prej garuesve të fjalës në fe, që nuk kanë dobi, veçse fjalë pa vlerë e tym në ajër, kështu që këshilla nuk ia arrin qëllimit të saj sado të jetë figurative në qoftë se atë e shoqëron mjeti mashtrues.

Hasan Basriu dëgjoi një vaiz të fortë që fliste me fjalë të bukura, por nuk u ndikua aspak prej tij, prandaj i tha: "O ti njeri, në zemrën time ose në zemrën tënde, ka diçka"! Sëmundjet njerëzore janë të përhapura tek shumë njerëz, fetar dhe jo fetar. Ndërsa psikologët bëjnë të ditur se këto sëmundjet janë më të rrezikshme sesa sjelljet e ulëta materiale.

Është e ditur se mëkatet e zemrës janë më të rrezikshme se mëkatet e gjymtyrëve! P.sh: Mendjemadhësia është më e rrezikshme se pirja e alkoolit, edhe pse feja i ka caktuar dënim

të shpejtë pirësit të alkoolit, por ia ka vonuar atë mendjemëdhënje në ditën kur asnjë këmbë nuk ka për të lëvizur.

E fshehta e kësaj qëndron se pirja e alkoolit në shumicën e rasteve i shkakton dëme vetëm atij që e pi, pasi ai me alkool dëmton organizmin e tij dhe poshtëron mendjen, ndërsa mendjemadhi mohon të drejtat e njerëzve, i bën padrejtësi atyre duke mos pasur kufi e cak dhuna që shkakton.

Mos mendoni se mendjemadhësia është mbajta e kokës lart dhe ecja me hapa të rëndë! Këto janë shfaqje fëminore! Mendjemadhësia është mohimi i të vërtetës, padrejtësia ndaj njerëzve dhe ecja në atë rrugë, e cila imponon epshet personale mbi një pjesë të madhe njerëzish. Mendo pak politikën e këtyre tiranëve të sëmurë, të cilët të drejtën e quajnë dhunë dhe, dhunën e quajnë drejtësi.

Musai a.s i thotë Faraonit: *“Ju kam ardhur me fakte të qarta prej Zotit, prandaj dërgo me mua beni israilët”*<sup>60</sup>. Vjen përgjigjja e dhunshme: *“Me të vërtetë ky është një magjistar i përsosur, që dëshiron t’ju nxjerri nga toka juaj”*<sup>61</sup>.

Njeriu, i cili dëshiron t’i shpëtojë së bashku me popullin e tij dënimit akuzohet se, ai ka për qëllim të nxjerrë njerëzit nga toka e tyre. Kur disa prej ndjekësve të së drejtës i besuan, Musait a.s, Faraoni tha: *“A i besuat atij para se unë t’ju lejoj”*<sup>62</sup>. Lavdi i qoftë Zotit! Përse të pres lejen tënde?

Që në kohë të vjetra kanë ekzistuar kësisoj tipash zullumqarë që mbajnë emra të mëdhenj, të cilët kanë qenë fatkeqësi për popujt e tyre, duke paguar mijëra e mijëra viktima, sigurimin e lavdisë personale, të cilën e pretendonte njeriu duke thënë: “Unë jam shteti! Ose: “Unë e askush tjetër!

Despotizmi politik është ambienti me i përshtatshëm për mbirjen e këtyre faraonëve dhe, ajo që na bën më tepër për të ardhur keq është fjala se: “Ekzistonin më shumë në Lindje, se sa në Perëndim, kjo është pengesa më e madhe në ngritjen e shumë popujve dhe sekretit i përhapjes së të kë-

60. Sureja E’arafë, ajeti: 105.

61. Sureja E’arafë, ajeti: 109-110.

62. Sureja E’arafë, ajeti: 123.

qijave e poshtërsive. Kur kërkojmë për virusin e devijimit në mesin e shume fetarëve, do të gjejmë këta lloj tipa faraonësh pas shumë rrugëve, të cilat i refuzojmë dhe na vjen keq për pasuesit e tyre.

Disa grupimeve, mendimet e tyre u kanë mbirë nëpër burgje, që ua shtuan entuziazmin e tyre si pasojë e zemërimi, ditën kur arriti një person i vetëm të urdhërojë arrestimin e 18 mijë vetëve brenda një nate dhe të shtinte tmerrin e llahtarinë në 18 mijë familjeve myslimane!! A më lejohet mbrojtja me këto fjalë nga ekstremizmi? Jo, cili është ai dijetar mysliman, i cili pranon shtrembërimin e ideologjisë dhe devijimet shpirtërore!

Me të vërtetë ky njeri ka boshllëk në tru, pasi dihet që mësuesi i mesazhit, sa herë që i është paraqitur rasti për të zgjedhur mes dy gjërave, ka marre atë më të lehtë e tyre, ndërsa këta të rinjtë, sa herë që iu është dhënë rasti për të zgjedhur midis dy gjërave, kanë marrë më të vështirën e tyre.

Feja islame pranon argumentin e mohon dhunën, duke mos e pranuar, përveçse e imponuar, ndërsa këta të rinjtë, kanë vështruar mënyrat me të cilat janë sjellë të tjerët me ta, duke lejuar të derdhet gjaku e të cenohen nderet e tyre. Kështu që, nuk kanë gjetur alternativë tjetër, veçse armën!!

Në mesin e fetarëve ekzistojnë tipa me fukarallëk të madh në kulturën e tyre islame dhe po qe se kanë bagazh diturie, e kanë nga fletë të thata e të zverdhura, larg nga mendimi i saktë islam dhe thënieve të vlerësuara të dijetarëve! Ata pëlqejnë hadithin e dobët ndaj të saktit, ose kuptojnë hadithin e saktë jo sipas qëllimit të tij dhe, në qoftë se ekzistojnë në trashëgimin tonë, shumë shkolla intelektuale, ata janë me kuptimin sipërfaqësor kundër shkollës intelektuale<sup>63</sup>, janë me “përrjashtime” kundër përparimit.

Kam dëgjuar disa prej tyre që mohonin rumbullakësinë e tokës dhe rrotullimin e saj. Nuk pushonte lufta e tyre derisa ju bë e ditur se Ibn Kajjim thotë: “Rrotullohet!” Kështu që, të pushojë e të qetësohet zhurma rreth këtij argumenti!! A

63. Medresetur-rej

ekziston te këta njerëz dhe në mes të havarixhëve të dikurshëm ndonjë afërsi shpirtërore, apo ideologjike?

Ndoshta, megjithëse akuza e havarixhëve për ndarjen e ymetit, duhet të dëgjohet nga një kalif i drejtë, me të cilin kam për qëllim udhëheqësin e duhur, i lindur nga një konsultim i saktë dhe që e meriton atë post! P.sh në qoftë se udhëheqësi i padrejtë do të akuzonte njerëzit, atëherë përgjigjja do të ishte e ditur, do t'i thuhej: cili është vendi yt tek ymeti, çfarë vlerash ke dhe a ju përgjigjesh interesave të tyre?

Një mjedis i lirë, ai është vendi i vetëm në të cilin ekstremizmi vdes, duke u groposur anëtarët e tij, ngadalë ose shpejt, kryesorja është që ata të zhduken, ose të mos jenë më! Degjenerimi politik nuk e pranon devijimin e besimit, e as edhe shtrembërimin e fikhut, legjislativ se feja nuk është perde për të mbuluar të metat, por ajo është pastruese e tyre dhe shkolla që i lufton ato. Kështu që, nga përvoja ime kuptoj se ekzistojnë gjëra që më çojnë në neveritje nga fetarizmi mashtrues dhe mbes gjithmonë duke paralajmëruar për rrezikun e tij.



## Teprimi dhe neglizhimi

Mendimet e ndryshme rreth formave në adhurim nuk krijojnë vëllazëri te besimtarët dhe as që sjellin të vërtetën! Këta tipa e bëjnë qimen tra dhe ndryshimet dytësore katastrofa. Ndryshimi në qoftë se lind, ekziston për shkaqe diturie bindëse, ndërsa pas ndryshimeve të tyre ekzistojnë shkaqe që meritojnë të zbulohen!

Njëri prej tyre shkroi si replikë ndaj meje duke thënë se, thirrja i ka paraprirë luftës në fillim të Islamit, pastaj kjo u anulua, duke u bërë thirrja e panevojshme që t'i paraprijë luftës! Për këtë solli disa hadithe, të cilat nuk kishte arritur t'i kuptonte ashtu siç duhet! Përmes rreshtave të shkruar dalloj pamjen e një shkruesi të zellshëm, pamjen e një grabitqari rrugësh që sulmonte njerëzit në emër të fesë!

Fetarizmi sot ka humbur ëmbëlsinë e zemrës, bukurinë e moralit dhe dashuria e krijesave është bërë mallkim për vende e popuj. Ajo që të çudit është se “teprimi” nuk ndodh në rritjen e shërbimeve shoqërore dhe as në rritjen e rasteve të bamirësisë apo dhënies përparësi të tjerëve, por ai ndodh në etjen e madhe për çështje, të cilat dijetarët kanë ndryshuar mes tyre si, vendosja e duarve, apo mënyra e vendosjes së këmbëve gjatë namazit! Gjithë kjo vëmendje e madhe ndeshet me përpjekjet e pakta në rindërtimin e shtetit islam të përnduar dhe, përveshjen për bashkimin e elementëve, të cilët janë më se të domosdoshëm për ngritjen e qytetërimit dhe rikthimin e qenies sonë.

Fushat e pëlqyeshme të “të përvëluarve” zgjerohen kur shikojnë mëkatet e njerëzve duke shpejtuar në gjykimin e tyre për shthurje apo kufër<sup>64</sup>, sikur njeriu tek ata është mëkatar derisa të vërtetohet pafajësia e tij, në të kundërtën e rregullit islam. Që në ditët kur lindi debati rreth atij që lë namazin nga përtacia, askush nuk ka përmendur gjë tjetër përveçse ai është jobesimtar, duhet të vritet dhe është i përhershëm në zjarr!

64. Kufër: mosbesim, blasfemi.



Thashë me vete: Pa dyshim, ai që lë namazin është mëkatar, por gjykimi, të cilin e keni përmendur është për atë që mohon krejtësisht namazin dhe, mohimi i një gjëje që në fe është domosdoshmërisht e njohur, quhet dalje nga feja, ndërsa përtaci i beson bazat e sheriatit, fesë. Thanë me mllëf: “Patjetër vritet”. Atëherë iu përgjigja: Përse harroni hadithin që e transmetojnë autorët e librave të hadithit, ku njeriu nuk ka premtim tek Allahu, për përtacinë e tij në lënien e namazit. Në qoftë se Ai dëshiron e dënon e, në qoftë se Allahu dëshiron, e fal!

Pasi ky mëkat nuk hynë në shirk<sup>65</sup>, dua të them se mundësia e faljes nga mëshira e Perëndisë, është mendimi i gjithë dijetarëve dhe medhhebi i hanefive thotë që përtaci i namazit nuk vritet.

Duhet të jemi të butë e me këshilla të mira, ta drejtojmë atë drejt xhamisë, jo drejt trekëmbëshit, litarit të varjes. Por, ekstremistët nuk pranojnë veçse thënien për vrasje dhe se vetëm kjo është Islami!

Fusha tjetër është çështja e femrës, ngujimi, injoranca dhe akuzat ndaj saj janë pika referimi në të gjitha çështjet adhuresë e zakonore. Duhet të shtrydhen tekste të thëniet e ndryshme, të cilat e lidhin atë me xhaminë, këshilla për të mirën e ndalimi nga e keqja, mësimin dhe po që se del nga shtëpia për ndonjë gjë shumë të domosdoshme nuk duhet t’i shikohen as thonjtë, sepse ajo është e gjitha “auret”<sup>66</sup>, të mos e shikojë asnjeri dhe mos ta shikojë njeri!

Prej këtyre ekstremistëve ka njerëz me qëllime të mira e me njet të pastër për hir të Allahut, por e meta e tyre, në rast se do të zhvisheshin nga sëmundjet dhe cytjet e shejtanëve, qëndron në njohuritë e pakta dhe moskuptimin e duhur. Sikur të zgjeroheshin mendjet e tyre do të përfitonte Islami nga ndjenjat e zjarra dhe vetëmohimi i tyre.

Në një fshat rastisi që kryeplaku lajmëroi imamin e xhamisë se do të vijë agronomi dhe banorët e fshatit duhej të

65. Shirk: të bërit shok Allahut.

66. Auret: pjesë e turpshme që nuk lejohet shikimi i saj.

mblidheshin në mënyrë që ai t'ju jepte disa këshilla të rëndësishme. Për këtë arsye, kryeplaku kërkoi që besimtarët të lajmërohen për takimin.

Kur imami u përpoq të lajmëronte përmes altoparlantit të xhamisë, një nxënës fetarist i thotë: Pejgamberi a.s ka ndaluar të thirret nga xhamia për gjënë e humbur dhe tha: “Namazi është bërë për hir të Allahut, d.m.th për hir të adhurimit” dhe, e ndaloi ta merrte mikrofonin! Kur zemërimi u shtua, nxënësi tha i vendosur: “Nuk lejoj të merret ky mikrofon, përveç se mbi kufomën time!”

Analogjia, këshilla e agronomit me lajmërimin e devesë së humbur të ndonjë nomadi është analogji jo e drejtë, por edhe sikur të ishte e drejtë, kjo çështje duhej të ishte më e lehtë se sa të sakrifikohet jeta në arritjen e saj!!

Me gjithë refuzimin tonë për këto lloj mënyrash, shohim se urrejtja hebreje nuk e thyen kufirin e saj, përveçse sakrifikimi i mbështetur mbi këtë vendosmëri. Duhet që edukatorët dhe udhëheqësit të sillen me këta të rinj me urtësi, e t'i lidhin ata me dijetarë të mençur e të aftë, sepse të rinjtë urrejnë servilët e pushtetarëve dhe e nënvleftësojnë diturinë e tyre, në qoftë se kanë dituri.



## KAPITULLI VI

### Shfrytëzimi i ndryshimeve është tradhëti e madhe

Jam munduar shumë të mbyll hendeqet që ndajnë të rinjtë të myslimanë, sepse është një gjë shumë e keqe të ndodhin ndryshime mes myslimanëve sot, në kohën kur armiqtë e tyre po përgatisin goditjen përfundimtare, pas shumë goditjeve të mëparshme, të cilat kanë shkatërruar rreshtat e bashkuar dhe kanë shtuar epshet. Ekzistojnë disa lloje ndryshimesh formale e gjuhësore, prej të cilave nuk kam frikë aspak, madje i konsideroj si natyrë mendore e shpirtërore të njerëzve!

Ndërsa ndryshimi i lindur nga boshllëku e llafazanllëku, apo ai që zë bisedat e të papunëve dhe të qejfëxhijëve, është mëkat ndaj Zotit dhe poshtërim për ymetin. Ky ndryshim nuk ka qenë në kohën kur ymeti ishte i zënë me Mesazhin e tij duke mbledhur të gjitha forcat në prerjen e thonjve grabitqar kundër Islamit. Por, sapo pushoi nga kjo përgjegjësi, dhe s' duhej të pushonte, filloi të fliste për fe e të zhytej në kuptimin e botës së gajbit<sup>67</sup>, pasi kishte qetësuar veten e tij nga përpjekjet e sakrificat në botën e dukshme!

Kështu që, trashëguam fatkeqësi të mëdha në çështje jokonsensuale. Balta u shtua më tepër pasi armiku ynë filloi sulmin e zhdukjes, ndërsa ne vazhdonim në kotësi, derisa pata frikë se mos dështonte rilindja bashkëkohore islame për shkak të budallallëqeve të të "përvëluarve" në nxitjen e këtyre çështjeve!

Në kohën kur isha në Kajro më erdhi dikush dhe më

67. Bota e gajbit: bota e fshehte, metafizike.

lajmëroi për trazirën<sup>68</sup> e ndodhur në mes besimtarëve në Halvan!

- Përse?, e pyeta.

- Hatibi i xhamisë, m'u përgjigj lajmëtari, pyeti me zë të lartë: "Ku është Allahu?" Besimtarët u habitën nga pyetja! Pastaj hatibi mori përsipër përgjigjen duke thënë se Allahu është në qiell! Dhe, solli një hadith të njohur për këtë. Disa besimtarë u zemëruan nga kjo përgjigje, e cila i hodhi njerëzit në debate e diskutime.

Me të vërtetë m'u çjerr trupi nga ky debat dhe më zuri një zemërim i madh, ndërsa ngjarja e hatibit përcillej sa këtu e sa atje dhe debati u ringjall përsëri në mes atyre me përkatësi selefite dhe atyre me përkatësi halefite<sup>69</sup>.

Thashë me vete se kjo gjë ia kënaq syrin hebrenjve dhe është fatkeqësi mbas fatkeqësish për myslimanët e humbur! S'kisha rrugë tjetër veçse të sillem sa këtu e atje duke hedhur ujë mbi zjarr dhe duke e zënë ymetin me atë që duhet të zihet. Flisja për ndryshimet vjetra e të reja me atë që bashkonte rreshtat e largonte përçarjet.



68. Trazirë: fitne.

69. Selef: pretendon se i përket brezit të parë të myslimanëve. Halef: pasardhës i brezit të parë, selefite.

## E qarta dhe jo e qarta

Thashë: Kur'ani ka ajete të qarta (muhkeme) dhe të tjera jo të qarta (muteshabih)<sup>70</sup> në kuptimin e tyre, por sa është përqindja e muteshabihit ndaj muhkemit? Muhkemi është nëna e Shpalljes, esenca e Qitabit dhe baza e obligimit. Kjo do të thotë se dispozitat drejtohen rreth muhkemit me të cilat punohet, të tjerat varen nga ai, ndërsa tjetri, muteshabih, është në kufi të caktuar.

Të merresh me të është shtrembërim në mendim dhe rrëshqitje në zemër. Na mjafton t'i kalojmë me respekt, të mos e teprojmë e të mos ngarkojmë veten me çka nuk mundemi. Qëndrimi i gjatë mbi to, së pari nuk sjell dobi, pastaj së dyti është hyrje në llogari të muhkemit, nuk do t'i japim të drejtën që i takon, pasi humbëm kohën duke qëndruar tek tjetri.

Dikush tha: “Baballarët tanë kanë ndryshuar pasi kanë menduar”. Këtë nuk mund ta mohojmë. E nëpër botë ka prej të cilëve janë fanatikë të selefëve, që u kanë besuar ajeteve sipas kuptimit sipërfaqësor dhe, ka prej atyre që janë fanatik të halefëve, të cilët i kanë komentuar dhe kanë gjetur kuptime të arsyeshme, prandaj çfarë të bëjmë?

Për këtë kam përgjigjen: “Fanatizmi i verbër është i refuzuar! Kur mendojmë e kuptojmë gjejmë diçka që patjetër duhet ta shfaqim; selefët dhe halefët, të gjithë këta i bëjnë tesbih, lavdërojnë e falënderojnë Zotin e tyre dhe e madhërojnë Atë, shpresojnë mëshirën e Tij dhe i frikësohen dënimit. Të gjithë këta e besojnë ekzistencën e Tij se, Ai është Mbikëqyrësi i Përhershëm e i Përjetshëm se, Atij nuk i ngjan asgjë.

Ato që hebrenjtë dhe të krishterët ia përshkruajnë si, trupëzimin, ortakërinë apo gjëra të tjera me tipare njerëzore janë krejtësisht gabime! Thëniet e selefëve dhe të halefëve të gjitha sillen rreth këtij qëllimi, por ndoshta mund të ndryshojnë mënyrat e realizimit! Në qoftë se ndryshimi nuk është gjuhësor, ai i afrohet ndryshimit gjuhësor.

70. Muhkem: me kuptim të drejtpërdrejtë dhe të qartë. Muteshabih: me kuptim figurativ dhe jo të qartë.

Kur'ani është libër, i cili ngulit sigurinë në zemra, përhap të mirën në shoqëri, u flet njerëzve për Zotin që të njohin Madhësitinë e Tij dhe, i edukon ata me devotshmërinë ndaj Tij!

A e din buburreca se si e krijon poeti poezinë? Ose, si mësuesi zgjidh një ekuacion? Ajo nuk e din dhe as që do ta dijë! Kështu që, askush nga ne nuk është përpjekur të dijë sekretin e Perëndisë. Njeriu nuk njeh veten e tij, madje nuk njeh as edhe trupin e tij!

Shndërrimi i ushqimit në qeliza të gjalla, shndërrimi i qelizave të gjalla në trupa pa jetë, pastaj rinovimi i tyre, është me të vërtetë diçka që të merr mendtë e, megjithatë e gjitha kjo është shumë e vogël në çdo moment të ditës dhe natës tek Ai që ka thënë për Vetën e Tij: *“Ai është, i Cili jep jetë dhe vdekje e kur të vendosë për diçka, Ai thotë bëhu dhe bëhet menjëherë”*<sup>71</sup>.



## Selefët dhe halefët

Me kujtesën time u ktheva në ditët e studimeve në universitetin e Ez'herit, afërsisht 50 vjet më parë. Ishim në mësimin e lëndës së Tevhidit, duke dëgjuar profesorin, i cili po tregonte shembuj të ajeteve figurative, ku mendjet tona u mbushën me shumë gjëra për Zotin e Lartë.

*“Mëshiruesi mbi Arsh lartësoi”<sup>72</sup>.*

*“Dora e Zotit përmbi duart e tyre”<sup>73</sup>.*

Pas shumë fjalëve të gjata, profesori, Zoti e mëshiroftë tha: “Medh’hebi i selefëve është më i saktë, ndërsa medhhebi i halefëve është më i drejtë!”

- Përse?, e pyeta.

- Medhhebi i selefëve është më i saktë, sepse ai qëndron më larg gabimeve në vendosjen e kuptimeve dhe më afër shpërblimit, sepse i largohet komentimit, te’vilit” dhe e pranon metodën e delegimit të gjykimeve, për të cilën edhe jemi urdhëruar. Ndërsa medhhebi i halefëve është më i aftë në largimin e dyshimeve, të vesveseve dhe të nënshtrimit të kundërshtarit.

Kështu, ne nxënësit e pranuar këtë gjë ashtu siç e mësuam, kaluan vite dhe debati mes dy grupeve nuk po mbaron!

E mendova këtë me veten time dhe vura re se, të dy këta, selefët dhe halefët e kanë pranuar komentimin, te’vilin në disa ajete si, p.sh fjala e Tij xh.sh: *“Ai është me ju kudo që të jeni”<sup>74</sup>*. Nuk është të qënurit me to, qënia e Tij vetë, por ajo është qënia e diturisë! Fjala e Tij xh.sh: *“Ne jemi më afër tij, se damari i qafës.”<sup>75</sup>* Ose, fjala e Tij xh.sh: *“Ne jemi më afër tij se sa ju, por ju nuk shikoni”<sup>76</sup>*.

72. Sureja TaHa, ajeti: 5.

73. Sureja Fet’h, ajeti: 10.

74. Sureja Hadid, ajeti : 4.

75. Sureja Kaf, ajeti: 16.

76. Sureja Vakia, ajeti: 85.

Ka për qëllim melaiiket, jo Qënia e Tij e Lartë, kështu kanë thënë selefët. Ndërsa komentimet, te'vilet e halefëve, janë të shumta si, p.sh Fjala e Tij xh.sh: *“Mëshiruesi mbi arsh lartësoi”*. Nuk është “lartësimi” me kuptim të qëndrimit e të prekjes, por ai është “lartësim” e gjithë pushtet që ka fuqi për çdo gjë, etj.

Iu ktheva thënieve të imamëve dhe dijetarëve gjatë gjithë kohërave. Vura re se disa thënie vërtetojnë disa të tjera, ose pothuajse i vërtetojnë. Gjithashtu vura re se ndryshimi ishte i afërt, në mes selefëve dhe halefëve dhe se nuk kishte vend për një betejë të pafund në mes këtyre dhe atyre.

Ebu Hamid El Gazali, i cili është prej imamëve të halefëve thotë: “Në qoftë se dikush pyet: “Çfarë kuptimi ka fjala e Tij xh.sh: *“Mëshiruesi përmbi Arsh lartësoi”* dhe, çfarë kuptimi ka fjala e Pejgamberit a.s: “Zoti zbret çdo natë në qiellin e dynjasë” i përgjigjemi: “Fjala sipas kuptimit të dukshëm, sipërfaqësor në këtë temë është e gjatë, por do përmendim metodën lidhur me këto dy tekste, e cila na udhëzon si më poshtë, e ajo që dua të them është se, njerëzit ndahen në dy grupe: të thjeshtë dhe dijetarë!

Ajo që e shohim të përshtatshme për njerëzit e thjeshtë është të mos t’i zhysim në të tilla komentime por, tua largojmë nga besimi i tyre çdo gjë që imponon përngjasimin, apo, të çon drejt të resë, d.m.th nuk ka ekzistuar që në zanafillë por ka lindur më vonë. Tua bëjmë të ditur se Ai xh.sh ekziston: *“Asgjë nuk i ngjan Atij dhe Ai është Dëgjuesi dhe Shikuesi”*<sup>77</sup>.

Në qoftë se pyesin për kuptimin e këtyre ajeteve, të ndalohe nga një gjë e tillë dhe t’u thuhet: “Kjo gjë nuk është në kapacitetin tuaj, prandaj largohuni, sepse çdo shkencë ka dijetarët e saj”. T’u përgjigjemi ashtu siç është përgjigjur imam Malik Ibn Enes: “Lartësimi është i ditur, mënyra se si, është e paditur; besimi në të është detyrë dhe pyetja për të është bidat”. Kjo, sepse mendjet e njerëzve të thjeshtë nuk arrijnë të kapin gjërat jokonkrete, të kuptojnë termat gjuhësorë dhe, as që arrijnë të kuptojnë gjerësinë e arabëve në figurat



letrare! Ndërsa, për dijetarët është e përshtatshme ta dinë këtë gjë dhe ta kuptojnë! Nuk them, kjo gjë është obligim individual i detyrueshëm pasi nuk ka ardhur obligim për të, por obligimi është: “Pastrimi i Tij xh.sh nga çdo përngjasim me diçka tjetër”<sup>78</sup>.

Sipas transmetimit Kadi Ijad ka thënë: “Nuk ka asnjë kundërshtim tek myslimanët, dijetari, hadithologu, filozofi, pasuesi etj, se kuptimi sipërfaqësor në ajetin se Zoti është në qiell: “*A u siguruat ju prej Atij që është në qiell, që të mos ju shafit (të mos u lëshoj) toka kur të dridhet*”<sup>79</sup> dhe të tjera ajete nuk kanë kuptim sipërfaqësor, por të gjithë i kanë komentuar.

Zhytja në komentim, siç ka bërë medhhebi Mu'tezili, ka larguar frikërespektin nga zemra, ashtu siç ka hedhur përkrahësit e saj në kundërshtime logjike të habitshme pasi, a mund të thuhet: i ditur pa dituri dhe i fuqishëm pa fuqi? Kjo logjikë është pasim i rëndomtë i Aristotelit i cili ka zhveshur zotin e tij nga çdo cilësi, atribut dhe veprim, derisa e ktheu në një zot që mendon vetëm rreth vetes së tij e asgjë më shumë!



78. Shih: El Iktisad fil I'tikad.

79. Sureja Mulk, ajeti: 16

## Rruga e drejtë

Rruga më e drejtë është: “T’i kushtojmë më tepër rëndësi zbritjes së qartë dhe, të gjithë interesimin tonë ta drejtojmë andej e ta kapërcejmë jo të qartën”. Të mos përpiqemi ta vëmë në punë mendjen për të, sepse mendja nuk ka fushë veprimi pas natyrës, metafizikës.

Kjo duke pasur parasysh bindjen se, ekziston ndryshim i madh mes asaj që mendja e gjykon si të pamundur dhe asaj që paaftësia ndjen ndaj ekzaminimit të realitetit të saj. Që të jetë njëshi tresh është e pamundur! Por ama, qenia e Tij i përhershëm pa fillim, që nuk ka fillim e as mbarim për Të, është e vërtetë edhe pse mundet të mungojë perceptimi i një gjëje të tillë nga mendja. A më shikon mua se ia kam qëlluar në atë përfundimin që dhashë? Kam sakrifikuar, hoqa një barrë mbi shpatulla dhe i shërbeva ymetit! Do të thotë dikush: “Jo, ti na dole në përfundim me diçka të ndryshme nga ajo që pritnim”.

Për këta vëllezër do të përmendi disa vërejtje.

Po dëgjoja profesorin në klasë, i cili po tregonte qëndrimin e Islamit ndaj filozofëve dhe përmendi këto fjalë: Me tri gjëra filozofët mohuan! Thënia se bota është pa fillim, mohimi i shpërblimit material dhe mohimi i diturisë së Zotit për hollësitrat e gjërave.

Këta të akuzuar kanë vdekur dhe në vend të tyre kanë mbirë mohues në çështje të tjera. Tani mendja njerëzore, ditën që beson në Zotin xh.sh ashtu siç e përshkruan Kur’ani i Shenjtë, largohet prej shumë kontradiktave të vjetra e nuk qëndron gjatë përpara ajeteve jo të qartë<sup>80</sup>. Ajo është mendja, e cila refuzon të kërkojë të fshehtat e dritës, por përfiton prej saj në fusha të tjera.

Po, ditën që kjo mendje beson, ajo do t’i kapërcejë këto çështje sipërfaqësore, të cilat i krijoi boshllëku, sepse e rëndësishme është që ta bëjmë të besojë.

80. Ajete me kuptime figurative, jo të qarta.

Konflikti mes myslimanëve dhe jomyslimanëve u transferua në fusha, të cilat duhet t'i studiojmë e të përgatitemi për ta me mendje që e kupton Shpalljen dhe universin së bashku. Brenda rinisë islame ekzistojnë grupe të çuditshme.

Aty ka trashëgimtarë të idesë havarixhe, fikhut dhahirij<sup>81</sup> dhe imagjinatës së formësuesve! Në të ka prej atyre që ngre poshtërsitë e tija në sharjet e imamëve nën pretekstin e shkencës së hadithit, ka prej atyre që kthejnë primitivizmin e vjetër në emër të zanafillës, ndërsa ata të cilët përhapin nomadizmin, luftojnë zhvillimin qytetërues në emër të devotshmërisë dhe ruajtjes së mësimave të Islamit.

Tani, po lemë konfliktin në emër të besimit për të kaluar te konflikti në emër të adhurimeve!



---

81. Pasuesit e këtij medhhebi vendimet fetare i nxjerrin nga kuptimet sipërfaqës - re të burimeve të shariatit duke mos kërkuar për qëllimet, të cilat përmbajnë këto burime.

## Ndryshimi i juristëve

Ndryshimet juridike në çështje dytësore janë të hershme, aq sa është e hershme edhe vetë feja Islame. Ai është një ndryshim i domosdoshëm pa të cilin nuk bën, madje feja nuk ka rrezik prej tij deri në Ditën e Kiametit! Gjithë ajo që dëshirojmë është që ky ndryshim të qëndrojë në kufijtë e mendimit shkencor islamik dhe ndërgjegjes këmbëngulëse dhe dëshiruese e kënaqësisë së Zotit xh.sh.

Të gjithë myslimanët janë të një mendimi se Kur’ani dhe Syneti janë shtyllat e para legjislative-dispozitare. Asnjë mysliman nga të parët apo, nga të fundit, nuk ka thënë se syneti i Pejgamberit a.s mund të lihet pas dore dhe se, ai nuk është burim legjislativ! Ndërsa ata që mohojnë këtë gjë, janë disa të devjuar e të shturur.

Mendimet ndryshojnë në vlerësimet e transmetimeve, në gjykimin për t’i pranuar ato, ose refuzuar. Kjo nuk do të thotë braktisje e synetit, sepse çdo gjë që dijetarët e kanë konfirmuar duhet të nderohet dhe të respektohet. Kur dije-tari lë një hadith ahad<sup>82</sup>, për një argument më të fortë se ai, në Kur’an ose Synet, nuk akuzohet se ka braktisur synetin. Ajo që mund ta cilësojmë konsiston në atë se, ai është shumë kërkues në konfirmim dhe se, ai nuk ka braktisur kurrë asnjë hadith duke besuar se ai është i saktë.

Në kohën kur shkrova librin “Akideja e myslimanit” nuk kam përmendur asgjë në të për Mehdiun e pritur dhe, kur u kritikova për këtë duke më thënë: “Përse nuk e ke përmendur në shenjat e kiametit?” Iu përgjigja: “Në memorien time, që kur isha student, nuk më kujtohet se ka ardhur hadith i qartë për Mehdiun dhe ajo që nuk ka ardhur e qartë, nuk është e saktë! Në qoftë se ajo që ka ardhur nuk mundet të formulojë një ligj të saktë, atëherë si ta bëj atë akide, e cila shërben si ndarëse mes kufrit dhe imanit, besimit e mosbesimit”? Pastaj duke qeshur shtova se problemi sot nuk qëndron në Mehdiun

82. Hadithe ahad: hadith me një transmetues.

e pritur, por në Mehdiun e papritur, i cili na befason kohë pas kohe me shfaqen e tij. Gjithashtu na shqetëson edhe numri që po rritet në llogaritjen e dexhalinëve, mashtruesve. Nga eksperiencia ime me synetin sherif, them se myslimanët kanë gabuar dy herë në vlerësimin e tij:

**Herën e parë:** në kohën kur u përhapën transmetimet e dobëta, duke u lënë hapësirë në traditat e tyre, në sjelljet dhe nganjëherë në adhurimet e tyre.

**Herën e dytë:** në kohën kur nuk mundën ta vendosnin hadithin e saktë në vendin e vërtetë, duke mos ndjekur qëllimin e tij, me një pasim të zgjuar. Nuk harroj kurrë një broshurë e cila u botua në Mekë që pretendonte se, Pejgamberi a.s ka sulmuar njerëzit pa u bërë thirrje, pa i ftuar në Islam duke ndezur luftën për t'i zënë njerëzit në befasi! E të tjera, të cilat shpjegonin betejat si ato në fillim ishin luftëra sulmuese, agresive.

Ata që merren me studimin e synetit, nga ky lloj i trashë, janë fatkeqësi për Kur'anin dhe Syneti së bashku dhe ata janë kallëp shoqëruës për injorancën e dyfishtë. Në veten time më është krijuar një ndjenjë që vazhdimisht rritet me kalimin e ditëve, përmbajtja e së cilës është kjo: *“Ai njeri që ka lidhje të dobët me Kur'anin e madhëruar, që është i privuar nga udhëzimi dhe drita e tij, nuk duhet në asnjë mënyrë të merret me studimin e synetit dhe të nxjerri dispozita nga ai, sepse ai zor se mund të udhëzohet në urtësi, kur dihet se ai është i penguar nga burimi i parë i urtësisë, Kur'ani që është libri i Zotit xh.sh.”*

Nuk kam për qëllim lidhjen e dobët, leximin e pakët të tij, por kam për qëllim dobësinë e kuptimit, mungesën e ndjenjave dhe mendjehhtësinë e kuptimit së strategjive të largëta të Librit të shenjtë!

Kur isha në fillimet e fikhut, të cilin e kam mësuar në medhhebin hanefi, por edhe tani vazhdoj me mendimin se kuptimi sipërfaqësor i Kur'anit është më primar të pranohet sesa argumentet e tjera. Se harami duhet të ketë argument të prerë. E megjithatë, me këtë pëlqim të fikhut, unë nuk ia pres rrugën njerëzve të tjerë me mendje të shëndoshë shken-core!

## Teksti kuranor dhe transmetimet njëshe

Më mahnit fjala e Muhamed Reshid Rida-s: “Ndarja mes dispozitave, të cilat janë konfirmuar nga Kur’ani i shenjtë, nga transmetimet njëshe dhe nga vlerësimet e juristëve është e domosdoshme, sepse ai që mohon atë që ka ardhur në Kur’an, gjykohet si mosbesimtar, ndërsa kush mohon diçka tjetër jo nga Kur’ani shikohet në bazë të arsyes që ka!”

Nuk ka imam muxhtehid<sup>83</sup> që të mos ketë thënë disa fjalë në kundërshtim me disa hadithe të sakta për shkaqe që mund të merren parasysh, d.m.th mund të justifikohet me to. Pastaj njerëzit kanë pasuar në këtë gjë dhe askush nuk e konsideron këtë gjë dalje nga feja, madje as edhe atë, të cilit nuk i takon të jetë pasues. Atëherë çfarë mendon ti për ndryshimin e njëri-tjetrit në thënie interpretative për të cilat mënyrat e vlerësimeve të tyre janë të ndryshme?

Ndoshta pyet se cila është arsyeja në lënien e hadithit të saktë? Përgjigja është kjo: “Ka një tekst tjetër më i fortë, më i saktë se ai. P.sh: Malikitë nuk e kanë gjykuar si haram, të ndaluar, përveçse për atë që ka ardhur në ajetin: **“Allahu ua ndaloi juve vetëm të ngordhëtën, gjakun, mishin e derrit dhe atë që theret jo në emër të Allahut”**<sup>84</sup>. Dhe gjithçka, përveç kësaj është e lejuar. Por, ndoshta mund të mos pëlqehet vetëm si pasojë e disa transmetimeve të ardhura në librat e synetit.

Hanefitë e kanë bërë zekatin të detyrueshëm për çdo gjë që del nga toka, duke u nisur nga konteksti i fjalës së Zotit xh.sh: **“O ju që besuat, jepni nga më e mira e asaj që e fituat dhe nga ajo që u dhamë (nxorëm) prej tokës...”**<sup>85</sup>, me të cilin refuzojnë kushtëzimin e zekatit për prodhime të veçanta, të cilat kanë ardhur në synet. Shafiitë kanë refuzuar prej synetit se, prekja e femrës së huaj nuk e prish abdesin!

Hanbelitë kanë refuzuar se, gji-dhënia e të rriturit nda-

83. Interpretues

84. Sureja Bekare, ajeti: 173.

85. Sureja Bekare, ajeti: 267.

lon, privon martesën dhe kanë konsideruar gji-dhënien vetëm atë që shoqërohet me mbirjen e qimeve dhe forcimin e kockave.

Këto janë disa shembuj të shpejtë në këtë ekspozitë të kufizuar. Transmetimet janë të shumta, ndërsa kuptimet edhe më të shumta, për këtë themi se, mënyrat e vështrimeve juridike nuk fillojnë prej boshllëkut. Le të shikojmë p.sh në këtë çështje: Akti i shitjes i mbështetur në çdo lloj kushti!

Juristët kanë thënë se akti i shitjes dhe kushti janë jo legjitim dhe disa të tjerë kanë thënë, se të dy janë legjitim. Ka edhe të tjerë juristë, fukaha që kanë thënë se akti i shitjes është i vlefshëm, ndërsa kushti është i pavlefshëm. Gjithashtu ekzistojnë edhe thënie të tjera për këtë çështje.

Ibn Ruzhdi në “Bidajetul Muxhtehid” ka thënë se origjina e mospajtitimit të njerëzve për këtë temë është e mbështetur në tre hadithe:

Hadithi i Xhabirit r.a ku thotë se, “Prejgamberi a.s bleu nga unë një deve me kusht që unë të hipja dhe ta përdorur deri në Medine”.

Hadithi i dytë, hadithi i Bunejves: “Çdo kusht që nuk është në librin e Zotit xh.sh është i kotë, edhe sikur të jenë 100 kushte”. Ky hadith është mutefekun alejhi.<sup>86</sup>

Hadithi i tretë, hadithi i Xhabirit r.a: “Prejgamberi a.s ka ndaluar nga shitja e prodhimit pa u korrur dhe pa u pjekur<sup>87</sup>, duke vlerësuar me hamendje dhe nuk dihet me saktësi sasia me para ose me mall në dorë; nga shitja dhe shkëmbimi i frutave të freskëta me ato të thata<sup>88</sup>, mbasi kjo konsiderohet kamatë, prandaj është ndaluar; nga lëshimi me qera i tokës në shkëmbim të një sasive prodhimi që del nga ajo<sup>89</sup>; nga shitja me hamendje<sup>90</sup>, ndalimi i shitjes pa ditur masën; me shitë diçka duke përfshirë pjesë prej asaj që ke shitur<sup>91</sup>; dhe ka

86. Mutefekun alejhi: hadith i saktë i transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi.

87. Muhakaleti

88. Muzabeneti

89. Muhabereti

90. Muavemeti

91. Teneja

*lehtësuar në araja, ka për qëllim shitjen në hurma kur ato të jenë pjekur*". Juristët për këtë çështje kanë dhënë sqarime të gjata, duke ditur se ky hadith është në librat e saktë të haditheve.

Në lidhje me këtë temë transmetohet nga Ebu Hanifeja se, Pejgamberi a.s ka ndaluar nga shitja me kusht. Kështu që, dijetarët kanë ndryshuar si pasojë e mospajtimit të këtyre haditheve. Disa kanë thënë: Akti i shitjes është i pavlefshëm, gjithashtu edhe kushti është i pavlefshëm. Të tjerët kanë thënë: akti i shitjes është i vlefshëm, gjithashtu edhe kushti është i vlefshëm. Prej atyre që kanë thënë kështu është Ibn Ebi Shebrem. Disa të tjerë kanë thënë: akti i shitjes është i vlefshëm, ndërsa kushti jo i vlefshëm. Ahmed Ibn Hambeli ka thënë: Akti i shitjes është i vlefshëm me një kusht të vetëm, ndërsa me dy kushte jo.

Ndërsa nga imam Maliku kemi ndarje të gjata për kushtin që e bën të vlefshëm dhe atë që lejohet, por këtu nuk është vendi për të shpjeguar se, në cilin medhheb dhe në cilat argumentet janë mbështetur. A nuk e ke vënë re se Umer Ibnul Khattabi kur ka refuzuar hadithin e Fatime bintu Kajs, në banesën e të divorcuarës tre herë, ka thënë, duke mbështetur veprimin e tij: *"Nuk e lëmë librin e Zotit tonë dhe synetin e të Dërguarit për një fjalë gruaje, që nuk e dimë se ka mbajtur mend ose ka harruar"*.

D.m.th refuzimi është për transmetuesin dhe jo për të zotin e Mesazhin a.s; pa marrë parasysh se ka gabuar Umeri r.a, apo ia ka qëlluar. Këtu nuk ka vend për të bërë zhurmë në sinqeritetin e pasimit, dëshirës së tij për synetin e Pejgamberit a.s.





## Bashkëpunimi në atë që të gjithë bien dakord

Gjërat, për të cilat myslimanët bien dakord janë të shumta, atëherë përse nuk bashkëpunojnë me njëri-tjetrin për realizimin e tyre? Beso, po qe se ata do të bashkoheshin për këto gjëra, në asnjë mënyrë nuk do të mbeste kohë për kontradikta në çështjet dytësore, por edhe sikur të binin në kontradikta për to, atyre nuk do t'u dilte koha për t'i shndërruar kontradiktat në luftëra të ftohta, apo të nxehta!

Unë i dua dijetarët e hadithit, por edhe studiuesit e shkencave të tij e, kjo është degë e dashurisë time të madhe për zotëriun e Risales<sup>92</sup>, majën e njerëzimit dhe peygamberin e peygamberëve, Muhamedin të birin e Abdullahut paqja dhe shpëtimi i Zotit qoftë mbi të. Shikoj se kjo gjë, si anë e kulturës sonë islamike është e domosdoshme dhe e nevojshme, pa të cilën nuk mund të jetojmë. Por, kush ka thënë se dijetarët e fikhut dhe interpretuesit e tij të mëdhenj, janë ana tjetër, të cilët kanë smirë për të parët; se fukahatë, pra juristët janë shkaktarë të përçarjes së ymetit dhe largimit të tij nga burimet e para të Islamit?

Pa dyshim që janë fjalë të kota!

Kam ndjekur disa ndryshime në disa çështje, të cilat kanë lindur mes atyre që merren me synetin, me transmetimet “muan’ane - nga-nga”<sup>93</sup>. Kam vënë re se ata nuk janë më të paktë dhe pa dallim më të vogël se mendimet e ndryshme të fukahave. Ibn Hazmi e pranon Talak thelathe<sup>94</sup>, divorcin treshës dhe, e shikon këtë dispozitë të argumentuar nga syneti edhe po të jetë me një fjalë të vetme.

Ndërsa Ibën Tejmije mendon ndryshe nga ai, duke e konsideruar divorcin treshës si një divorc të vetëm, derisa të jetë

92. Rivale: Mesazh, ka për qëllim Peygamberin a.s

93. Transmetime muan’ane: transmetime që vargu i tyre fillon me fjalët, nga filani, nga filani, nga... etj.

94. Talak thelathe: fjala që burri i thotë gruas së tij: je e ndarë, je e ndarë, je e ndarë, pra e përsërit tre herë.

në një kuvend, mexhlis të ulur së bashku, ose me një shprehje. Duke u nisur nga kjo gjë, ai lejon kthimin nga divorci. Ndërkohë kur, Ibën Hazmi mendon se asaj nuk i lejohet kjo martesë derisa të martohet me një burrë tjetër. Ibën Hazmi e shikon muzikën, muzikën e mirë, si të lejuar dhe lejon shitjen e veglave muzikore. Ndërsa Ibën Xhevzij, Ibën Tejmije dhe Ibnul Kajjimi i shikojnë të gjitha këto gjëra si të ndaluara.

Kam parë ndryshim mes Shejh Albanit, i cili është haditholog i madh dhe dy imamëve, Ibën Tejmije dhe Ibnul Kajjimit. Albani mendon se gusli<sup>95</sup> ditën e Arafatit është bidat, ndërsa Ibën Tejmije e shikon këtë gusël si të konfirmuar nga Pejgamberi a.s. Albani mendon se bashkimi i dy namazeve në udhëtim është i konfirmuar<sup>96</sup>! Ndërsa Ibnul Kajjimi thotë se kjo gjë nuk ka qenë prej rrugës së Pejgamberit a.s.

Ibën Tejmije thotë se abdesi pas prekjës së auresit nga mashkulli është i pëlqyeshëm<sup>97</sup>, ndërsa Albani thotë se, madje është i detyrueshëm<sup>98</sup>.

Sikur të ndiqnin ato gjëra që kanë ndryshuar mbështetësit e hadithit, llogaria do të zgjatej dhe, i fundit i kësaj është ajo që Shejh Albani ka thënë se, ari i punuar rreth, byzlyk-muhal'lak është haram për gratë, duke u mbështetur tek një hadith i pasaktë dhe tek një kuptim i papërcaktuar, ashtu siç e shikojnë refuzuesit e tij, duke ditur se ixhmai<sup>99</sup> është për lejimin e tij për gratë!

Çfarë do të thotë e gjithë kjo? Do të thotë se kontradiktat në mendime dhe ndryshimet e medhhebeve janë gjëra që nuk mund të mohohen dhe nuk mund të braktisen, sepse kjo është praktika, syneti i Zotit, në njerëz dhe në mendime.

Përçarja nuk zgjidhet me shkop dhe as me vulgarizëm! Por ajo zgjidhet duke bashkëpunuar në ato gjëra për të cilat jemi dakord, duke justifikuar ndryshuesit, po qe se janë të zotët për interpretim dhe kërkim.

95. Larja e plotë e trupit.

96. Thabit

97. Mustehab

98. Vaxhib

99. Ixhma: konsensus i dijetarëve.

Gabimi i interpretuesit është i shpërblyer. Duhet patjetër të mbyllet dyert para mendjelehtëve, kështu që të mos flasë në fenë e Zotit xh.sh kushdo, por vetëm të zotët e diturisë.

Kush kërkon hirësinë e Zotit, kënaqet me atë që di ta përsosë dhe ruan Islamin në fushën që punon. Por, sa e sa fusha pune janë bosh, sepse njerëzit grinden në fushën e fjalëve rreth disa gjërave dytësore, të cilat nuk i sjellin Islamit asnjë dobi.





## KAPITULLI VII

### Të kuptuarit e thirrjes Islame dhe problemi i thirrësve

Thirrja në rrugën e Zotit ka shoqëruar fillimin e krijimit dhe do ta shoqërojë atë deri në Ditën e Fundit, e fuqizuar me fuqinë e Zotit xh.sh dhe e ruajtur me mbrojtjen e Tij. Por, ndoshta puna për hir të Islamit mund të ketë sukses dhe të dhurojë frutat e saj.

Ndodhë edhe që ta pengojë diçka, por shkarjet dhe rrëshqitjet janë në vartësi të aftësive të thirrësve dhe punonjësve të saj për përshtatjen dhe zhvillimin e mënyrave të thirrjes. Duhet pasur parasysh atë që të lejojnë kushtet dhe gjendja e papërshtatshme, kuptimi i vizioneve të situatës në të cilin punojmë, aftësitë për të përcaktuar qëndrimin aktiv dhe ndikues dhe mënyrën e përsosur përmes rrethanave dhe mundësive të disponueshme.

Çështjet, të cilat lindin gjithmonë vështirësi, ndjeshmëri të sinqertë, kuptim të thellë, mendje vlerësuese, njohuri të gjëra, eksperiencë të mirë dhe kuptim të betejës së Islamit dhe armiqve të tij, në mënyrë që të përcaktohen betejat, duke ditur se problemet ndryshojnë dhe armët me të cilat përballohen përparojnë me një shpejtësi të madhe.

Nga këtu vërtetohet edhe më shumë rëndësia e rishikimit të vazhdueshëm dhe korrigjimit të përhershëm e të gjithmonshëm të situatës së punës islame në etapa të ndryshme për të drejtuar lëvizjen dhe për të vërtetuar disiplinimin e lëvizjes me parimet e Islamit. Përcaktimin e volumit të aktivitetit me atë që i përshtatet me mundësitë, brenda kufirit të përballueshëm se *“All-llahu nuk e obligon asnjë njeri përtej mundësisë së*

*tij...*” sidomos në ditët e sotme, në kohën e marrëdhënieve të ndërlikuara dhe sfidave të mëdha, për të mos rënë në konfuzion mes mundësive dhe asaj që zotërojmë.

Do të vazhdojë kontakti i qytetërimit islam përmes grupit të punës që ecën në rrugën e vërtetë, rrugë të cilën nuk ka kush e dëmton dhe refuzon, derisa të vijë urdhri i Zotit, ku Ai të caktojë për këtë punë ata që do ta kryejnë në çdo situatë dhe në çdo kohë, prej të zotëve të mendjes, diturisë, urtësisë, eksperiencës dhe punës së vazhdueshme. Duke vërtetuar fjalën e të Dërguarit të Zotit a.s, të cilën e transmeton Bejhaku: *“E mban këtë dituri prej çdo pasardhësi të drejtit e tyre, mohojnë nga ajo devijimin, falsifikimin e ekstremistëve, shpifjet e shkatërruesve dhe komentimin e injorantëve”.*

Thirrja islame po korr ferra nga disa njerëz me aktivitet të madh që u mungon kuptimi, shpërthejnë me mendjet e tyre të dobëta, keqësojnë e nuk përmirësojnë. Të gjithë ne gabojmë dhe për këtë nuk është çudi, por ajo që të habit është se gabimi mbetet dhe ne këmbëngulin në të! Dhe, më e habitshme është se disa nga ne ecin në rrugën e devijuar dhe ato nuk e dinë, ose ndoshta ai mendon për veten e tij se është në rrugën e drejtë.



## Kuptimi i praktikave hyjnore në njerëz dhe në univers

Prej çështjeve të rëndësishme të mendimit dhe punës islame, të cilat shfaqin veten e tyre me ngulmim në kohët e fundit, është çështja e humbjes së ekuilibrit shoqëror të shumica e punonjësve në fushën e thirrjes, ku ai bashkëpunon me një shoqëri, e cila mund të përmbajë gabime dhe devijime. Kjo konsiston në marrjen e qëndrimeve të ndryshme, që nuk janë të ngritura mbi një kuptim të saktë të praktikave kozmologjike të Zotit xh.sh në prekjën e realitetit dhe përhapjes së tij në shoqëri dhe as të mbështetura mbi metoda të studiuara të thirrjes islame.

Kështu, këto qëndrime merren, ose si pamje të një refuzimi të plotë të shoqërisë, si mëkatarë dhe duke u ngritur për ta ndryshuar, si dëshirë për të arritur rezultate të nxituara. Ose, si pamje e një tërheqjeje nga shoqëria duke u tërhequr dhe duke e braktisur atë, si pasojë e dështimeve, në të cilat mungoi arritja e këtyre rezultateve të nxituara. Kjo çështje në vetë aspektin e mendimit dhe punës islame është e paraprirë me të shkuara në histori.

Në kohë të vjetra kanë gjetur gabime nga pushteti dhe pushtetarët dhe qëndrimi i tyre ishte i ndryshëm për shkak të kulturës, e cila mbizotëronte. Kështu kemi parë p.sh. havarijët. Ata iu drejtuan shpatave, duke u bindur në besimin e tyre dhe duke menduar se dashuria e tyre për t'u sakrifikuar dhe premtimi për fitoren nga Allahu xh.sh i lejonte të dilnin, të vrisnin e të krijonin çarje të pafundme në shtet.

Lloji i dytë ka qenë i personifikuar në disa mistikë, të cilët kishin braktisur shoqërinë dhe gabimet e saj, pushtetin me dëshirat dhe epshet e tij dhe menduan se, në izolim është lumturia. Se, është më mirë për ta të lënë shoqërinë e gjithçka ka në të, në izolim ka paqe dhe shikonin në hadithet, të cilat kanë ardhur për afrimin dhe izolimin duke i komentuar ato sipas qëndrimit të tyre.

E vërteta, të cilën unë e shoh, është se të dy grupet kanë

gabuar. As ata, të cilët dolën të bindur në ekzistencën e gabimeve dhe domosdoshmërinë e luftimit të tyre nuk ishin në rrugën e saktë që Islami e konfirmon dhe, as ata të cilët u izoluan nga gabimet dhe devijimet e tyre, nuk ishin në rrugën e drejtë. Gjithashtu Islami dëshiron të luftohet gabimi, por ai vendos plane largpamëse dhe e bën njeriun, me gjithë ndryshimin e kohës, vendit, etapave të shtrira gjatë kohës të arrijë qëllimin e tij me maturi.

Zoti xh.sh ka praktikuar synete të shumta kozmologjike në pjekjen e realitetit dhe përhapjes së tij në shoqëri, sado të jetë besimi ynë, sado e madhe të jetë nxehtësia e besimit në zemrat tona dhe sado të jetë përlulja jonë ndaj Zotit xh.sh që të na ndihmojë. Për këtë, unë mendoj se ata, të cilët janë përkushtuar punës islame tani, duhet të mësojnë nga gabimet e dy grupeve të kaluara dhe, të jenë njerëz të besimit e të xhelozisë për urdhrat e Zotit xh.sh, njerëz të dëshirës për zëvendësimin, ndryshimin e asaj që është më e mirë. Të ndiqet ky ndryshim derisa të arrijë pikësynimin e tij, jo sipas dëshirës, por sipas praktikave kozmologjike të Zotit xh.sh.

Edhe Pejgamberi a.s i është nënshtruar këtyre praktikave dhe, kur shokët e tij u nxituan duke i thënë lute Zotin për ne, sepse dhimbjet e shfaqura i detyruan t'i drejtoheshin ankesave, përgjigjja e tij profetike ishte: *“Pasha Zotin, Allahu do ta triumfojë këtë fe, por ju jeni që nxitoni”*. Besimtarët ngrihen për të vazhduar praktikat kozmologjike të Zotit xh.sh me gjithë kërkesat e saj në këtë fushë. Aspak nuk i takon atyre të habiten, e as të nxitohen. Unë mendoj se nxitimi ose habitja këtu, janë injorancë ndaj praktikave kozmologjike të Zotit xh.sh.

Askush nuk ka qenë me moral më të lartë dhe me fisnikëri më të madhe se sa Pejgamberi a.s në shfaqjen e vërtetësisë së Islamit dhe as në butësinë e tij në arritjen e qëllimeve. Me gjithë këtë, ata që kishin lidhur gjendjen dhe interesat e tyre në të kaluarën apo me gjendjen aktuale, ishin shumë të kujdesshëm në urrejtjen ndaj Islamit dhe armiqtësinë e Pejgamberit a.s.

Allahu xh.sh thotë: *“Dhe kështu, ne secilit Pejgamber ia bëmë ndonjë armik prej jobesimtarëve, por mjafton që Zoti të jetë*



*udhërrëfyes, ndihmës yti*<sup>100</sup> dhe thotë: “Dhe kështu (sikurse dhe ty) çdo pejgamberit i bëmë armiq, nga njerëzit dhe nga xhindët e djallëzuar, që me fjalë të shkëlqyeshme në mënyrë të fshehtë nxit njeri-tjetrin në mashtrime. E sikur të donte Zoti yt, ata nuk do të bënëin atë (armiçësi) po ti lëri ata me trillimet (e tyre)”<sup>101</sup>.

Dëshira këtu nuk është më shumë sesa sqarim i praktikave kozmologjike të Zotit xh.sh. Disa këtë dukuri e komentojnë se, ajo është rezultat i mungesës së kuptimit të praktikave kozmologjike, ndërsa rënien në këto humbje, si pasojë e mungesës së rezultateve. Në kohën kur njeriu nuk arrin rezultatet që shpreson, ose i mendon, bie në humbje dhe, kjo humbje e bën të izolohet dhe të tërhiqet nga shoqëria, del kundër saj, ose tretet në të!

Problemi në mendimin islam mbetet në mungesën e dhënies së vendimeve të duhura të praktikave kozmologjike. Disa mendojnë se myslimanëve në këto etapa nuk u mungon sinqeriteti dhe besimi, sepse ata kanë dhënë shumë energji për punën islamike, por atyre u mungon arritja dhe kuptimi i praktikave, të cilat sundojnë jetën dhe njerëzit.

Nuk mundet të jetë sinqeriteti i njeriut, sado i thellë të jetë ai, por edhe dashuria e tij për Zotin, sado e fortë të jetë ajo, nuk mundet të jetë ky, ose ajo shkak për anulimin e praktikave rreth të cilave Zoti xh.sh ka sjellë çështjet e kësaj bote. Ato janë praktika të palëvizshme, për të cilat Zoti xh.sh ka nënshtruar pejgamberët e Tij, atëherë përse nuk i nënshtrohen pasuesit e tyre?

Pastaj, logjika e nënshtimit, nuk jam sofist, por dua të pohoj një të vërtetë fetare, më bën t’i shikoj përcaktimet e Zotit xh.sh se, ato janë më të vlefshme se mendimi im. Ato janë mjedisi i vetëm, në të cilin mund të piqen të vërtetat shoqërore, për të cilat njerëzit kanë nevojë të jetojnë me to. Nuk është ajo që mendoj, apo ajo që planifikoj, e cila ia arrin qëllimit. Jo, ne jemi robër të Zotit xh.sh.

Këtë robëri e vëmë re së bashku me dobësinë dhe me

100. Sureja Furkanë, ajeti: 31.

101. Sureja En’amë, ajeti: 112.

mungesën e njohjes së saj të së ardhmes, si dhe paaftësinë e saj në kuptimin dhe perceptimin e interesave akute në betejën e Bedrit, ku masa e sahabeve ishin që dëshironin frytet e shpejta: *“...e ju dëshironit t’ju takojë ai (grup) i paarmatosur”*<sup>102</sup>.

Kështu masa e tyre fillimisht e urrenin betejën derisa edhe Kur’ani e përmend këtë gjë më fjalën e Tij xh.sh: *“Mos-pajtimi i tyre për plaçkë, është ashtu si ai kur Zoti yt të nxori nga shtëpia jote për të vërtetën, e një grup nga besimtarët nuk ishte i kënaqur”*<sup>103</sup>.

Sipas ndjenjave të tyre, ata po niseshin drejt vdekjes, por nuk e kuptonin se kaderi, përcaktimi i Zotit po i shtynte drejt fitores më madhështore që do të arrinte thirrja islame gjatë jetës së Pejgamberit a.s. E gjitha kjo na bën të vendosim vija ndarëse mes parashikimit dhe kuptimit tonë të të vërtetave dhe, mes asaj që kaderi i lartë planifikon për ne.

Përse të tjerët janë të aftë t’i lidhin rezultatet e punës së tyre me një punë të gjatë. Në kongresin e parë sionist (1897), Hertcel ka thënë: *“Izraeli do të formohet pas 50 vjetësh”*. Hebrejtë kishin dëshirë të realizonin premtimin, apo profetizmin e tij. Kështu që, në vitin 1947 e ngritën, kur doli vendimi për copëtimin e Palestinës me 23 nëntor 1947.

Në realitet, Hertcel nuk mendonte se do të jetonte derisa ta arrijë këtë rezultat, por edhe ndoshta mendonte se, ajo për të cilën nuk kishte mundur ta realizonte do ta arrinin bijtë e tij dhe ajo që bijtë e tij nuk mund ta realizonin do ta bënin nipërit e tij. Kryesorja është që brezat pasuesë të një kombi bashkëpunojnë për arritjen e rezultatit.

Çfarë na mungon ne myslimanëve, që ne trashëgojmë gabime me disa shekuj, të vendosim një plan me strategji afatgjatë, ashtu që të mbarojmë nga këto gabime dhe bijtë tanë të ndiejnë se ata mbajnë përgjegjësi së bashku me ata që vendosën planin. Edhe në qoftë se disa prej tyre kanë ndërruar jetë, të tjerët janë në pritje dhe se ai, i cili është duke pritur ndoshta vdes përpara se t’i shikojë rezultatet, por ai

102. Sureja Enfalë, ajeti: 7.

103. Sureja Enfalë, ajeti: 5.

trashëgon pas tij bij ose përkrahës, të cilët i bën ata të kryejnë të drejtat e Zotit xh.sh që kanë për t'i kryer.

Zoti xh.sh ka thënë :“*Ne, ose ta bëjmë të mundshme të sho-hësh diçka nga (dënimi) që u premtuam atyre, ose ta marrim shpirtin ty (kurse ti nuk sheh gjë) e ardhmja e tyre është vetëm tek Ne*”<sup>104</sup>.

Për këtë akoma vazhdoj duke kërkuar nga të drejtit, të mos jetë ndjenja e nxehtë, ajo e cila i udhëzon, por patjetër duhet që me zemër të bindur të bashkohet mendja e thellë dhe shikimi i mprehtë, që të mund t'i shërbejmë fesë sonë, sidomos mbas zgjerimit të konfrontimit mes nesh dhe armiqve tanë.

Ne, duke pasur parasysh mënyrën e jetesës, të mendimit, shkencës dhe filozofisë, ndryshojmë shumë. Të tjerët kanë sulmuar universin dhe kanë vendosur këmbët në disa planetë dhe po studiojnë planetet e tjera, ndërsa ne akoma vazhdojmë të mbështetemi në kotheren e bukës, të cilën e hamë të prodhuar nga duart e të tjerëve, jo në atë që ne vetë e prodhojmë.

Në realitet, problemi qëndron në atë se disa njerëz e kuptojnë çështjen e përcaktimeve mbizotëruese të Zotit xh.sh, ndaj të cilave myslimani duhet të jetë i qetë dhe se, vullneti i Zotit është triumfues në fund të çdo pune, e kuptojnë këtë gjë si lloj detyrimi.

Prej ligjeve kozmologjike të Zotit xh.sh është që, unë të punoj dhe unë të jem i bindur në ndihmën e Zotit xh.sh, por nuk është prej ligjeve të Tij që punët të kryhen sipas vlerësimit tim.

Unë i mëshoj fort këtyre kuptimeve, sepse kam parë beteja të shumta të ndodhura mes besimtarëve dhe jobesimtarëve, ose mes armiqve të Zotit ku, ndër besimtarët kishte njerëz që shpirtrat i kishin të ndezur nga sinqeriteti për Zotin e tyre, por ata nuk kishin përsosur planet, nuk kishin studiuar betejën dhe nuk kishin parashikuar përfundimet.

Kështu na goditën disfatat, sa që mund të përputhet plotësisht fjala e Tij xh.sh: “*E kur juve u goditi një dështim (në Uhud)*”

104. Sureja Junus, ajeti: 46.

*e që ju patët dhënë atë dyfish (armikut në Bedr), thatë: “prej nga kjo? “ Thuaj: “Ajo është nga vetë ju!”<sup>105</sup>.*

Disfata të shumta e kanë goditur ymetin islam dhe mu-xhahidinët në këtë ymet, sepse ata nuk kishin përsosur planifikimin e betejës, ndërsa mendja patjetër duhet, sepse ajo është dhurata më e shtrenjtë që Zoti i Lartë i ka dhënë krijesave të Tij.

Kam llogaritur fjalën “Ulil elbab”, të zotët e mendjes në Kur’anin e shenjtë, e cila është përsëritur në 16 vende. Kjo do të thotë, se ata të cilët i shërbejnë Islamit, duhet që patjetër të zotërojnë mendje të mëdha..

Mundet të shërbejë si degë nga kjo fjalë, përshkallëzimi në legjisllacioni i Pejgamberit a.s, duke ditur se ai kaloi një periudhë kohore në Mekë dhe nuk theu asnjë idhull, se myslimanët nuk përdoren asnjë formë ballafaqimi fizik ndaj idhujtarëve, por çështja qëndronte vetëm në sqarimin e të vërtetave besimore. Ata përballonin me durim çdo gjë që i godiste. Ndërsa, kur hyri në Mekë si çlirues, nuk i la idhujve asnjë sekondë kohë, pasi puna e parë që bëri ishte thyerja e tyre.

Ajo që në të vërtetë ka ndodhur është ndarja e mesazhit në dy periudha, periudha mekase dhe periudha medinase. Mund të thuhet: periudha medinase ka qenë periudhë legjisllative, ndërsa periudha mekase ka qenë periudhë sqarimi e parimeve të besimit, e lidhjes së njerëzve me to dhe krijimi i bashkësisë. Ndërsa, baza e lidhjes ishte besimi në Zotit xh.sh. dhe drejtimi i sinqertë tek Ai..

Nuk ka aspak dyshim se përshkallëzimi<sup>106</sup> ka qenë praktikë në disa dispozita legjisllative dytësore në Islam. Kështu, p.sh për kamatën, shpallja e parë ka qenë fjala e Zotit: **“Dhe çka të jepni nga pasuria për ta shtuar e rritur (me kamatë), në pasurinë e njerëzve, ajo nuk do të shtohet tek Allahu, e çka të jepni nga sadakaja (bamirësia) me qëllim që t’i afroheni Allahut, të tillët**

105. Sureja Ali Imran, ajeti: 165.

106. Et-Teder’rukh

*janë ata që u shumëfishohet (shpërblimi)*<sup>107</sup>.

Ky ajet lë për të kuptuar se, kamata është e refuzuar, por momenti final në pastrimin e bashkësisë nga kamata dhe fshirjes së gjithë gjurmëve të saj ka qenë në periudhën medinase dhe jo në periudhën e parë. Ajetet e fundit të zbritura për këtë, ka qenë fjala e Zotit xh.sh: *“Ata që e hanë kamatën, ata nuk ngrihen ndryshe vetëm se si ngrihet ai i çmenduri nga të prekurit e djallit*<sup>108</sup>. *“Allahu e zhdok kamatën dhe e shton lëmoshën*<sup>109</sup>. *“O ju që besuat, kini frikë Allahun dhe nëse jeni besimtarë të sinqertë, hiqni dorë prej asaj që ka mbetur nga kamata*<sup>110</sup>.

Këtu dispozita ishte vendimtare, e prerë. Kështu ka qenë edhe dispozita e alkoolit dhe gjithçka rreth saj, por ne nuk mund të themi se ata që punojnë tani për Islamit po përshkallëzojnë në shpjegimin e të vërtetave shkencore të Islamit, sepse këto të vërteta tashmë janë plotësuar dhe, që kur ka zbritur fjala e Tij xh.sh: *“Sot përsosa për ju fenë tuaj*<sup>111</sup>, jemi bërë përgjegjës për shfaqjen e gjithë Islamit, ajet për ajet dhe praktikë për praktikë, synet për synet.

Por, ndërtimi i shtetit pas përhapjes së thirrjes, kjo patjetër kërkon përshkallëzim, sepse ndërtimi i asaj që është shembur për disa shekuj, nuk mund të kthehet kështjella e tij gjatë disa javëve, opo disa viteve të pakta. Për këtë reformatorët e mëdhenj thonë se, koha është pjesë e mjekimit, me kuptimin se unë patjetër duhet të them se dënimet duhet të jepen dhe nuk pranoj asnjë diskutim në ndonjë prej dënimeve, por kur t’i zbatoj, nuk ka gjë po të filloj menjëherë me ndëshkimin e shpifjes, ose ndëshkimin e prerjes së dorës së hajdutit, sepse kjo është e lehtë dhe mundet të vonohen disa ndëshkime derisa të më krijohen rrethanat e zbatimit.

Teorikisht unë jam i obliguar për sqarimin e Islamit totalisht, por praktikisht patjetër duhet të përshkallëzohem në zbatimin praktik. Kjo është e gjitha ajo që na imponohet

107. Sureja Rrum, ajeti: 39.

108. Sureja Bekare, ajeti: 75.

109. Sureja Bekare, ajeti: 276.

110. Sureja Bekare, ajeti: 278

111. Sureja Maide, ajeti: 3.

nga rrethanat, pa të cilat nuk mund të bëhet, sepse ilaçin që patjetër duhet ta marrë i sëmuri për t'u zgjuar, ia jap atij gllënjka, gllënjka.



## Kur'ani dhe sulltani, pushteti

Ekziston edhe një çështje, e cila ka lidhje me atë që fillojmë të flasim. Disa mendojnë se myslimanët janë shumë të pasur në fikhun legjislativ dhe, shumë të varfër në fikhun politik me gjithë kuptimin e tij administrativ dhe konstitucional. E kjo mund të çojë ndoshta drejt një rënie në vizionin politik, sepse historikisht kjo ka vazhduar të mbetet vetëm shprehje ndaj parimeve të përgjithshme të pazbatuara në fikhun dhe programet që formojnë produktivitet në imagjinatën e njeriut mysliman, i cili mund të manovrojë me jetën përmes tij.

Pyetja këtu është: “A thua e gjithë kjo ka qenë fryt i ndarjes së pushtetit nga Kur’ani në historinë e Islamit? Duke ditur se shumë e shumë ajete të zbritura nxisin për të vështruar e për të marrë mësim dhe se, ftesa për konsultim në natyrën e saj ajo është më afër fikhut social e politik, sesa fikhut legjislativ, duke ditur se rritja është e vazhdueshme në fikhun legjislativ, ndërsa ne vuajmë nga një dobësim në fikhun politik.

Si mundet që myslimanët të largohen nga disa këto dhimbje?

Së pari, patjetër duhet të pohojmë se fikhu i adhurimeve dhe pjesë nga fikhu i akt-marrëveshjeve, janë zgjeruar më tepër sesa është e nevojshme. Thellimi legjislativ në çështjet e taharetit<sup>112</sup>, namazit, haxhit, zekatit etj, ka qenë më i madh sesa mund të mbante individi, ose bashkësia myslimane. Një pakicë prej këtyre i mjaftonte njerëzve, ashtu siç ekzistonin disa emërtime rreth një diçkaje të vetme, për të cilat nuk ishte e domosdoshme që të gjithë t’i njihnin. Por, nuk ka aspak dyshim se në ymetin islam ekziston një prapambetje në politikën e qeverisjes, menaxhimit të pasurisë, ndërsa politika e parasë ajo është e njohur si prova e ymetit tonë, ashtu siç ka ardhur edhe në hadith: “Fitneja, prova e ymetit tim është paraja”<sup>113</sup>.

Fatkeqësia vjen nga mënyrat e fitimit dhe të shpenzimit

112. Pastrimit .

113. Transmetohet në mënyrë të saktë nga Pejgamberi a.s se ka thënë: “Çdo umet ka nga një provë dhe, prova e ymetit tim është paraja”.

të pasurisë. Kështu që, as mënyrave të burimeve të fitimit nuk i vendosëm filtrues, të cilët pengojnë haramin dhe lejojnë të rrjedhë hallalli dhe, as rrugëve të shpenzimeve nuk i vendosëm kontroll ligjor që ndalojnë shpërdorimin e marrë, të ndalojë mendjelehtët të derdhin pasurinë e tyre atje ku nuk është vendi.

Ndoshta në këtë gjë, shumë shtete, popuj na e kanë kaluar, duke vendosur për pasurinë politika të përpikta në shpenzim dhe fitim të saj, të cilat duken në buxhetet e përgjithshme që vetë këto shtete i kanë vendosur.

Këto shtete ia imponojnë qeverive të tyre duke mos lejuar të marrin nga populli qoftë edhe një qindarkë të vetme, përveçse me ligj, ose me amendamente të qarta, me anë të të cilave kuptohet se shteti me të vërtetë ka nevojë për një gjë të tillë. Madje, as që shpenzojnë gjë, përveçse me të njëjten përpikëri që ndjekin në mënyrën e fitimit.

Gjithashtu, edhe kur shpallin luftë, ata nuk e lënë në dorë të epsheve të një personi që lufton dhe bën paqe si t'i dojë qejfi, por populli, i cili paguan me gjakun e i tij çmimin e luftës dhe sakrificën e luftimeve, ai është vendimmarrësi për të tilla çështje. Duhet patjetër, për hir të së vërtetës, të ekzistojnë departamente të veçanta e të specializuara në çështje teknike dhe shtetërore për të njohur pozicionin e ymetit mysliman ndaj ymeteve të tjera. Çfarë i sjell këtij ymeti dobi e çfarë i sjell dëm dhe, të ekzistojnë ligje të rrepta, të cilat rregullojnë marrëdhëniet dhe kushtet ndërmjet nesh dhe palëve të tjera.

Megjithëse jurisprudenca islame zë të paktën 50% të bibliotekës islame, edhe pse ky fikh është hulumtuar aq thellë tek ne, ashtu që ndoshta nuk gjen qytetërim botëror, i cili të jetë thelluar në fikh ashtu siç është thelluar në qytetërimin tonë, e megjithatë ne në këtë drejtim jemi goditur nga një dobësi në disa akt-marrëveshje.

P.sh, për rreth 25 mëkate prej mëkateve të mëdha, nuk janë vendosur masa, dënim-ndëshkime. Ne nuk kemi vendosur masa dënuese për kamatën, plaçkitjen, arratisjen nga beteja, grabitjen e pasurisë së jetimit, mashtruesin, apo atyre



gjërave të panumërta, të cilat janë kundërvajtje të shumta. A janë masat ndëshkuese dhe dënimet, të cilat Zoti xh.sh. i ka vendosur, të mjaftueshme për masa ligjore të domosdoshme në fushën sociale? A lihen kështu masat ndëshkuese pa asnjë disiplinë dhe pa mbikëqyrjen e tyre me ligje të qarta?

Gjëja e dytë: Fikhu islam, madje edhe në fushën e familjes, ka mbetur i prangosur brenda kufijve të katër medhhebeve, derisa erdhi Ibn Tejmije, i cili arriti të bëjë një punë të madhe kur refuzoi divorcin e parregullt, me të cilën gjë zuri një vend të mahnitshëm e të nderuar në ruajtjen e familjes islame, edhe pse disa e refuzojnë fjalën e tij në këtë çështje. Por, hapja e derës së interpretimit para një njeriu, e bëri atë të vendosë kontroll për familjen islame. Kjo është një gjë e mirë.

Ligjet për punën dhe punëtorët akoma vazhdojnë të jenë zero tek ne e, të cilat i importojmë nga jashtë për dëmtimet gjatë punës dhe për të drejtat e punëtorit. Kjo nuk lejohet. Ligjet zyrtare akoma edhe tani vazhdojnë të jenë të grabitura.

Ndoshta, ajo që kërkohet është përcaktimi i shkaqeve, shkaqeve të dobësimit në këtë anë dhe zhvillimin të tij në anën tjetër, të kundërt. A thua është tërheqja nga shoqëria? Apo, ndoshta është ndarja e pushtetit nga Kur'ani?

Megjithëse njeriu e merr vesh se, ajeti me të cilin juristët mbështeten në argumentimin e analogjisë është fjala e Zotit xh.sh: *“Pra, merrni përvojë, o ju të zotët e mendjes”*<sup>114</sup>. Pasi Allahu xh.sh ka folur për gjendjen në të cilën ishte fisi Benu Nadir, duke i dënuar për një shkak të caktuar shoqëror që ndodhi dhe se, çdo gjë që godet këtë realitet do të mbarojë me të njëjtin përfundim, i cili është më afër fikhut social sesa fikhut legjislativ.

Vëmë re se, ky lloj fikhu i praktikave shoqërore, praktikisht, është kthyer në fikhun legjislativ, duke mbetur çështja sociale, fikhu social, apo praktikat të varura nga ngritja dhe rënia e popujve dhe çështja e pasurisë mbetet çështje e dobët.

Nga ana teorike, imamët tanë kanë arritur që herët të vendosin rregulla legjislative shembullore. Pothuajse, mes të

114. Sureja Hashr, ajeti: 2.

katër Imamëve dhe pushtetarëve, ka pasur ftohje, marrëdhënie jo të mira. Imam Ebu Hanife u vra në burg, sipas versionit më të njohur. Imam Maliku u qëllua, u rrah sepse ai dha fetva, me të cilën zemëroi udhëheqësin në kohën e tij. Imam Ahmed ibn Hanbel u rrah dhe u qëllua me goditje të forta, sikur të mos kishte bërë Zoti mëshirë mbi të, gati sa nuk vdiq në burg. Imam Shafiu u arrestua dhe iu ndalua që të gjykojë, sepse ai vuri re se gjërat po shkonin keq. Kështu, kësaj ane legjislativë i erdhi dobësimi nga divergjencat.

Pra dobësimi, shkak i tij ishte konflikti mes udhëheqjes mendore, intelektuale dhe udhëheqjes politike, po që se shprehja është e saktë. Kështu, duhet të lidhim paqe mes dy drejtimeve, mes drejtimit intelektual dhe drejtimit politik.

Unë mendoj se diçka nga kjo, gjithashtu ka ndodhur edhe mes vetë mendimtarëve.

Në historinë tonë kemi parë shkëputje mes mendimit politik dhe mendimit intelektual-legjislativ, por gjithashtu vëmë re se ka ndodhur shkëputje mes fikhut edukativ dhe atij legjislativ duke u shkëputur ajo që quhet shkenca e zemrës, shkenca e misticizmit<sup>115</sup>, shkenca e edukatës, ose ajo, të cilën e kanë quajtur: Hakikati dhe Sheriati, e vërteta dhe feja.

Në realitetin tonë islam, kjo konsiderohet një shkëputje e hidhur. Ne dimë se librat për misticizmin mbushin bibliotekat. Urdhrrat mistike kanë mbushur botën islame në një periudhë të kaluar e, ndoshta sot mund të mos nevojiten këto rrugë. Bile, jeta mund të ecë e të udhëzohet edhe pa këto rrugë, por ajo, jeta nuk mund të rregullohet e të udhëzohet në qoftë se zemra njerëzore mbetet pa një premtim të mençur. D.m.th se, edukata është shtyllë në formimin e popujve. Edukata pa të cilën nuk bën, në mënyrë që shpirtrat të jenë të udhëzuar dhe shoqëritë ideale, është ajo që ngrihet mbi bazën e Ihsanit, ose mbikëqyrjes së Zotit xh.sh mbi ndërgjegjen njerëzore në të gjitha sjelljet dhe veprimet e tij, ditën dhe natën.

Kjo mbikëqyrje është ajo, nga e cila lind frika, shpresa, durimi, falënderimi, mbështetja, dashuria, devotshmëria,

pendimi dhe të njohurit e mëkateve të mëdha, të cilat janë më të rrezikshme sesa mëkatet e trupit, me kuptimin që të dihet se si lahen shpirtrat nga dashuria për t'u dukur, nga egoizmi, nga smira, nga kërkimi i pushtetit, nga sorollatjet nëpër trotuaret e poshtërsive, nga dehja në kërkimin e kësaj bote në kurriz të botës tjetër.

E gjithë kjo, në qoftë se ne humbim, atëherë një tërësi e skeletit legjislativ nuk mund të bëj dobi në vend të tij. Madje, ka qenë e domosdoshme që dijetarët fillimisht t'i edukonin brezat mbi këto domethënie, sepse kjo është ajo mbi të cilën u ngrit bashkësia e parë islame.

Kur thellohesh në trashëgimin e Ibën Tejmijes, i cili konsiderohet "armik" i misticizmit, ose të Ibnul Kajjimit, nxënësit të tij, atëherë ti do të gjesh se Ibën Tejmije ka rezervuar afërsisht dy vëllime nga *Fetafat* e tij për zemrat dhe bisedat ndaj Zotit xh.sh, frikës ndaj Tij, punën për hir të Tij, sinqeritetin, ihsanin dhe të tjera domethënie, me të cilat karakterizohej misticizmi pa një përvetësim të saktë. Pastaj, erdhi nxënësi i tij Ibnul Kajjimi që e zbërtheu duke shkruar shumë dhe duke u zgjeruar më shumë në këtë drejtim se sa mësuesi i tij.



## Të konsultuarit në periudhën e lulëzimit të filozofisë

Le të kthehemi te pika e ndarjes së udhëheqjes intelektuale dhe edukative nga udhëheqja legjislativë. Kjo ishte ndarja, e cila krijoi hendeqe dhe barriera në bashkësinë myslimane. Një pjesë e madhe e njerëzve e ndjejnë këtë çështje, prandaj patjetër duhet që të vendosen gjërat elementare për mjekimin e saj.

Ne besojmë se, jo gjithë shkaku qëndron tek udhëheqja politike e, as tek udhëheqja legjislativë ose intelektuale, por secilës prej dy udhëheqjeve i takon pjesa e mëkatit. Kështu që, nuk mundemi t'i drejtohem me qortime asnjërit prej grupeve. Ne, të gjithë, dijetarë, udhëheqës, zyrtarë, edukatorë, juristë, ligjvënës dhe drejtues ushtarakë, ne të gjithë, mbajmë peshën e dobësisë, e cila ka mbërthyer mbarë botën islame.

Është e dobishme dhe e mirë që të njohim planin e përbashkët që mund të shpëtojë ymeti, trashëgiminë tonë dhe, të kryejmë obligimin që kemi ndaj Mesazhit, që ta takojmë Zotin xh.sh me fytyra të bardha, ose përndryshe pasojat për ne do të jenë shumë të rënda.

Ne nuk fillojmë nga hiçi, sepse nga nderimi i Zotit xh.sh për këtë ymet, libri i Tij ekziston akoma. Se, syneti i Pejgamberit a.s akoma është me mësim të qarta. Se, jurisprudenca islame në origjinën dhe qëllimet e saj të mëdha, vazhdon akoma të na dhurojë forcën për të shikuar e për të lëvizur. E gjitha kjo i privohet neglizhuesve dhe dashakeqësve të fjalës së fesë së Zotit xh.sh, ose punës sipas saj, sepse ata bëjnë keq, në kohën kur dëshirojnë të bëjnë mirë, ndërsa feja e Zotit xh.sh është shumë më e lartë se sa të merret nga goja e budallenjve.

Patjetër që unë refuzoj në këtë periudhë, në të cilën popujt janë të llastuar dhe ka lulëzuar filozofia, e cila shpall veten e saj ndaj krijesave, refuzoj të vijë ndonjë njeri e të thotë se udhëheqësi në Islam vendos pa pasur një këshillë konsultimi. Atij i takon të vetmohet në mendimin e tij duke

hedhur poshtë të gjitha mendimet, të cilat e kundërshtojnë. Këto janë fjalë që nuk duhet të thuhen, ndërkohë që Pejgamberi a.s nuk e mendonte një gjë të tillë për vetën e vet, atëherë si të mendonte diçka të tillë për të tjerët?! Thënia që, konsultimi nuk imponon askënd, është thënie boshe dhe nuk e di se nga ka ardhur!

Ndoshta ideja e mos imponimit të konsultimit dhe, ideja e tiranit të drejtë, të gjitha këto kanë qenë filozofi të një realiteti të caktuar për justifikimin dhe shfaqjesimin e totalitarizmit politik nga juristët e pushtetit. Fjala “tiran i drejtë” është e njëjtë me fjalën “dijetar injorant”, ose me fjalën “i devotshëm mëkatar”. Këto fjalë konsiderohen bashkim i dy të kundërtave.

Mundet që të përhapet në shoqërinë islame, sa në një kohë në tjetrën, shprehja “tiran i drejtë”, ose mund të përhapet në shoqërinë islame shprehja se, konsultimi nuk është i obligueshëm, si lloj i justifikimit, ose dhënia e fetvasë për tiranizmin politik, ose veshja e petkut islam për tiranizmin politik. Këto gjëra nuk lejohen, sepse atë që pamë në historinë e Pejgamberit a.s është se, ai e pranonte konsultimin.

Konsultimi është prej parimeve islame dhe, para se myslimanët të kishin shtet, u thuhej kjo është bashkësia juaj, e cila akoma nuk është shndërruar në shtet, duhet që çështja juaj të jetë në konsultim: *“..dhe ata që konsultohen mes vete për punë të përbashkëta”*<sup>116</sup>. Kjo ka qenë në periudhën e Mekës, ndërsa kur bashkësia u ngrit mbi bazat e shtetit, pasi u transferua në Medine, atëherë iu tha të Dërguarit a.s, pasi pasuan disfatat në “Uhud” *“e konsultohu me ta në të gjitha çështjet”*<sup>117</sup>.

Provimi i parë i konsultimit ka qenë në luftën e Ahzabit, në kohën kur Pejgamberi a.s pothuajse, gati sa nuk nënshkroi marrëveshjen mes tij dhe fiseve idhujtare, në kopshtet rreth Medinës, të cilat mund t’i sulmonin, sepse ai vuri re pozitën e vështirë të ensarëve dhe lakminë e fortë të armiqve ndaj tyre. Shikoi arabët që qëllonin në të njëjtin hark e, pati frikë këtë dhe propozoi. Kur këtë ia shfaqti dy udhëheqësve të fisit

116. Sureja Esh-Shura, ajeti: 38.

117. Sureja Ali Imran, ajeti: 159.

Euvs dhe Hazrexh, Said ibën Ubade dhe Said ibën Muadh, këta refuzuan.

Ajo që unë mbaja mend nga transmetimi është se Pejgamberi a.s iu tha të dyve: *“Në qoftë se ju të dy bini dakord në diçka, unë nuk do t’ju kundërshtoj në atë gjë”*...kjo është origjina e konsultimit dhe dihet fare mirë se konsultimi nuk ka aspak lidhje me “tekstet”<sup>118</sup>. Konsultimi bëhet atëherë kur nuk ka “tekst”, ndërsa ata që thonë se konsultimi ndryshon dispozitat e Islamit, këta nuk kuptojnë çfarë do të thotë konsultim. Në ditët kur themi se shteti, feja zyrtare e tij është Islami, do të thotë se “tekstet” e Islamit t’i kemi gjënë më të shtrenjtë e të mos ketë fjalë e diskutime për to, ndërsa konsultimi hyn atje ku nuk ka “tekst”.

D.m.th, kuptimi i konsultimit është se, mendimet thuhën dhe, çdo kush thotë atë që di, i qëndron korrekt asaj. Kundërshton derisa të merren mendimet dhe të dihet se për ku është drejtimi, por në fund ecë me shumicën. Kjo është ajo që themi ne, ndërsa thënia tani se, secili njeri ta marrë ymetin e vet nga lindja, ndërsa ai dëshiron të shkojë nga perëndimi, kjo është një gjë që nuk mund të thuhet dhe është e papranueshme.



118. Fjala “Nass”, tekst në jurisprudencën islame nënkupton argument kuranor, profetik, ose nga një burim tjetër islam.

## Besa masive dhe xhemati musliman

Ndoshta mund të mos vihen re gjurmët e ndikimit të detyrimit, apo mos detyrimit të konsultimit të disa aktivistëve, shoqata dhe shoqëri islame.

Kështu që çështja e mos detyrimit të konsultimit është e pranishme të disa xhemate, apo aktivistëve islamë, por ka shkaktuar shumë kontradikta, të cilat mund të jenë ana tjetër e çështjes, e cila është vështirësia dhe ndërlikimi i kuptimit të teksteve ku konsultimi është përmendur.

Ne e dimë që, besa masive nuk mund të jetë, veçse për udhëheqësin e aftë musliman në shpalljen e luftës dhe marrëveshjes së muslimanit, zbatimin e ndëshkimeve, d.m.th ai ka një vizion dhe kompetenca të caktuara. Kështu që, disa xhemate dhe aktivistëve islamë kanë rënë në dy probleme.

Problemi i parë, mos detyrimi i konsultimit.

Problemi i dytë, besa masive për drejtuesin e punës, ose prijësin e xhematit, apo diçka tjetër si kjo. Çështje, e cila më pas shkaktoi diçka arbitrare në marrëdhëniet kundrejt dispozitave juridike, nga njëra anë dhe, konsiderimi i vetes së tyre se ata janë xhemat muslimanësh, çoi drejt një rënieje, ndërsa vendimi për muslimanët me disa dispozita ishte jashtë kontureve të tyre. Të gjitha këto thelluan distancën mes tyre dhe Mesazhit të vërtetë, duke mbyllur portat e thirrjes për tek Allahu xh.sh.

Të gjitha këto janë gabime që nuk mund t'i mohoj, që ndodhen në botën islame, për fat të keq, shumë prej punëtorëve të fushës islame janë sjellë në një mënyrë që të detyron të pësësish e të habitësh.

Çështja e parë, shumë prej tyre janë vetëquajtur “emirë”<sup>119</sup> dhe, me aq sa di është se Hasan el Benna, sipas urrejtjes që kishte për postin e prijësit, sapo e mori vesh se dashuria për të udhëhequr dhe, kërkimi i saj kanë shkaktuar të keqën muslimanëve në historinë e tyre të gjatë, e quajti vetën e tij

119. Prijësa, udhëheqës

udhëheqës, murshid dhe, urrente të quhej apo të bëhej kryetar, apo prijës.

Kështu që nuk e di se çfarë i bëri një numri të madh prej xhematëve islame të quajnë drejtuesit e tyre “umera-prijës”. Është e vërtetë fjala e Profetit a.s “*Në qoftë se jeni tre persona, njërin bëjeni prijës*”, por nuk është qëllimi të bëhet madhështor e i lartë, por qëllimi është të jetë përgjegjës dhe i thjeshtë. Këtë e pasoi ajo që prijësi, i cili u bë prijës për disa studentë, punëtorë ose disa të rinj, filloi ta shohë vetën e tij si të aftë në dhënien e direktivave, për të cilat nuk pyeti aspak, si e si të refuzojë çdo kundërshtim kur i drejtohej atij e me këtë totalitarizëm sundoi shumë anë dhe ky është një gabim i qartë.

Çështja e dytë, thënia se këta prijës të rinisë, studentëve ose të punëtorëve, kanë të drejtat e Ebu Bekrit, Umerit, Uthmanit dhe Alisë, të drejtat që i përkisnin kalifatit të madh dhe, të drejtat e bindjes për myslimanët, sepse ata janë drejtues udhëheqës dhe Zoti ka urdhëruar që t’u bindemi drejtuesve!

Kjo gjithashtu është fjalë e refuzuar dhe nuk mund të pranohet, sepse dalja nga besa, ose dalja nga bindja ndaj udhëheqësit, ka qenë për të mbajtur prestigjin e shtetit dhe vendin që ai zë dhe, si pengesë të bëhen çarjet shkaktare të shembjes së tij përpara armikut. Për këtë kryengritjet e armatosura, janë kritikuar dhe janë konsideruar prej gjërave të ngjashme me tradhtinë, sepse nuk ka dyshim që dalja e armatosur kundër shtetit është rrezik që lejon derdhjen e gjakut.

Por, dalja e thjeshtë e zakonshme me kuptimin që refuzon mendimin e dikujt prej prijësve, ose udhëheqësve nuk është diçka që njeriu mund të kritikohet. Madje është vlerësim i mirë që një njeri të shfaqë atë që zotëron. Dhe, nuk mund të thuhet se ai që kundërshton prijësin e xhematit konsiderohet i dalë nga Islami, i dalë nga xhemati, thyes i besës, ose ka vdekur siç vdesin xhahilët, deri tek praktikat e fundit, të cilat i transmetojnë nga fusha e shtetit në horizontet e tyre të ngushta e të kufizuara, në të cilat jetojnë. Puna islame duhet të jetë larg nga këto iluzione e pretendime.

Në qoftë se një xhemat mysliman zgjedh prijësin e tij, ai



është prijësi i tyre, është imam për ta sikur imami i namazit, në qoftë se gabon korrigjohet dhe orientohet drejt së vërtetës. Nuk i takon atij t'ua imponojë të tjerëve që ta pasojnë në gabimin e tij. Është e drejta e njerëzve të shkojnë tek ai, ta lënë e ta kundërshtojnë në se vërejnë se rruga e tij nuk e ka gjetur mendimin për të dhe as nuk konsiderohet mëkatar e as i dalë nga Islami.

Ndërsa, problemi i qëllimeve është tek Zoti xh.sh. Kështu që, kush lë njërin nga xhematet, sepse detyrat e xhihadit e kanë dobësuar dhe rënduar, atëherë ai njeri do të pyetet përpara Zotit xh.sh: Përse i konsideroi të rënda detyrat e xhihadit, në kohën kur prej tij kërkohej të ishte luftëtar. Ndërsa, kur gjen ndonjë plan të gabuar dhe vendosë, pasi ka dhënë këshilla, por ato janë refuzuar, të lejë këtë gabim, i cili madje është prej të drejtës së tij, për këtë vendim të tij ai nuk konsiderohet si i dalë nga besa, ose largim nga feja e as kthim në injorancë dhe asgjë prej gjithë këtyre gjërave.

Ka edhe një pikë tjetër për çështjen e ixhtihadit<sup>120</sup>. Ajo që dihet është se, porta e ixhtihadit është ndalur ose mbyllur dhe, kjo i ka hedhur myslimanët në një anarki shumë të madhe. E vërteta është se ndalimi i pastër i ixhtihadit, është në vetvete ixhtihad. Atëherë, a është ai ixhtihad i detyrueshëm dhe, nga e ka marrë cilësinë e detyrimit? Kjo është një çështje, ndërsa çështja tjetër është se, ndalimi i derës së ixhtihadit do të thotë ndalim i rritjes islame në ballafaqimin e problemeve bashkëkohore dhe gjykimin mbi to.

Pika e tretë në këtë temë, nënkupton një lloj ndarjeje, shpëputjeje mes Islamit dhe shoqërisë, ose shkëputja e Islamit nga shoqëria me duar myslimane dhe pjesëmarrja negative nga ana jonë në ndalimin e Islamit. Kjo bie në kundërshtim me amshueshmërinë e sheriatit. Allahu i Lartë, i Cili zbriti sheriatin, është i njohur plotësisht me rrethanat dhe transformimet e popujve dhe me atë që quhet proces i fesadit të kohës<sup>121</sup> me të cilin argumentohen këta njerëz që kanë bërë ixhtihad për të dhe kanë bërë thirrje për të ndalur derën e

120. Interpretimit

121. Prishje, shthurje e kohës.

ixhtihadit. Kështu që thirrja e tyre ka qenë objekt shikimi.

Në përgjithësi, ndalimi i derës së ixhtihadit, absolutisht nuk kishte kuptimin, në njohjen e atij që e kërkonte atë, apo të atij që e detyronte për njerëzit, burgosjen e mendjes islame në këtë pengesë që lindi. Ajo që ndodhi, sipas asaj që kam lexuar nga Bagdati në librin e tij “Tarihul Bagdat” është se, ixhtihadi kishte arritur në anarshi. Kështu, ymetit islam në Bagdat i jepej fetva për të derdhur gjak në një lagje dhe, për të mos derdhur në një tjetër lagje. Në një lagje femra ishte hallall, ndërsa në një tjetër ishte haram, por le të sjellim një shembull.

Mendo sikur një njeri mysliman ka vrarë një person jomusliman nën mbrojtjen myslimane. Malikitë dhe Shafitë thonë se nuk vritet myslimani për të, me këtë mbrojnë gjakun e tij. Ndërsa Hanefitë thonë: vritet myslimani për të. Pra, patjetër duhej të ndërhynte shteti këtu, ose ndërhyrja e ixhtihadit, ashtu që të zgjedh një gjykim ndaj një tjetri, e të mbyllej dera para njërit prej dy ixhtihadeve.

Ky ishte një lloj rregullimi, i cili filloi si rregullim i kufizuar, por ai, për fat të keq, u shndërrua në anarki, vdekje e ngurtësim i mendjes islame.

E gjitha kjo nuk ka ekzistuar në ymetin islam, ajo ka nisur në kohët e reja. Kadiu, gjykatësi dikur ka bërë ixhtihad dhe ishte e drejtë e tij të ndiqte njërin nga të katër medhhebet e mbështetura e të njohura. Ai nuk ishte si gjykatësi sot, që para tij ka ligjin, zbaton nenet e tij mbi të vërtetën dhe jep gjykimin. Detyra e tij është që të bëjë ixhtihad në njohjen e gjykimit, vendimit dhe, a i përshtatet atij apo jo?

Sikur ligji ta kufizojë tani për një gjendje të caktuar, atëherë ai kthehet tek një nga burimet e fikhut, por sido qoftë ky ixhtihad për mbylljen e derës së ixhtihadit përfundon me dëm dhe, dëmi është ai se ymeti qëndroi me të vërtetë tek mendimi, i cili qarkullonte në shekullin e katërt afërsisht, ndërsa koha modernizohet siç thuhet: Gjykoi njerëzit sipas ngatërresave që kanë bërë.

Kështu që, patjetër duhet që dera e ixhtihadit të ngelë e hapur. Por, kam një vërejtje dhe dëshiroj të jem i përpik-

të, sepse kam para njerëz që shfrytëzojnë hapjen e derës së ixhtihadit. Kanë sjellë dispozita, në të cilat ata kanë bërë ixhtihad e kanë qenë barrë përmbi ymetin, sepse mendjet e tyre janë të mangëta. Ata nuk i kanë arritur nivelet shkencore dhe morale të muxhtehidit. Duke u nisur nga ky shkak, gati sa nuk them: Kthimi në pasimin e medhhebeve është më mirë sesa kjo anarshi, e cila ka bërë disa njerëz të krijojnë medhheb të pestë, të gjashtë e të shtatë, por nuk kanë pas tyre trashëgimi shkencore, e cila iu jep atyre ndonjë shenjtërim, apo paprekshmëri.

Diçka tjetër rreth kësaj vërejtjeje është se, ixhtihadi ka qenë në një fushë, e cila duhej që të ndalohej ixhtihadi në të, me kuptimin që, ne nuk bëmë ixhtihad në atë që ndaluan të bënin ixhtihad, ose në atë që fikhu ynë ishte i dobët në të. Kjo fushë kishte të bënte me menaxhimin e pasurisë, politikën financiare dhe, me menaxhimin e pushtetit, politikën e qeverisjes. Ose, në atë që quhet fikhu politik, politika e punës dhe e punëtorëve, fikhu administrativ, marrëdhëniet tona të jashtme me shtetet.

Të gjitha këto kanë pasur nevojë për ixhtihade të shumta. Këta nuk kuptojnë asgjë nga këto fusha, as duke pasuar dhe as duke bërë ixhtihad. Por, e gjitha ajo me të cilën kanë filluar dhe të cilën kanë përsëritur është për jurisprudencën e adhurimeve. P.sh, a duhet të lejohet leximi i sures Fatiha pas imamit apo jo? A duhet të bëhet duaja e kunutit në namazin e sabahut apo jo? A bën të falesh me këpucë apo jo? A duhet që duart të vendosen poshtë kërthizës apo sipër gjoksit? Pas rukusë, a lidhen duart përsëri apo nuk lidhen, etj?

Kam thënë, e sakta dhe gabimi në këto gjëra janë përafërsisht të barabarta, ose nuk dihet ekzaktësisht dhe, të gjitha kanë shpërblim. Edhe muxhtehidët e rinj kanë filluar të punojnë në këtë drejtim. Për këtë mendoj të ndalohet i gjithë ky ixhtihad i ri, sepse ai është ixhtihad në fushën ku puna jonë duhet të jetë vetëm përzgjedhje dhe vlerësim i thënieve të paraardhësve, të cilat kanë përfshirë, pothuajse, çdo gjë sepse adhurimet nuk janë që modernizohen, ndërsa marrëdhëniet, veprimtaritë financiare, kontratat, etj, mendimi për to është të

mbështesin parimin e Meslahatu Mursele<sup>122</sup>, në të cilën është mbështetur Imam Maliku dhe disa Shafii dhe Istihسانی<sup>123</sup>, në të cilin është mbështetur Imam Ebu Hanife.

Ndërsa, rregullat e përgjithshme në fenë tonë janë të shumta dhe të njohura, rregullat e fikhut, të cilat në to ushqejnë fikhun e katër imamëve e, ai për ne në realitet është fikh i moderuar. Është plotësisht e mundur të hyjmë në këtë gjë në fushën e politikës financiare, qeverisëse, administrative, punës, punëtoreve dhe çështjet e shtetit, etj, së bashku me hapjen e portës për të përfituar nga dituria e re.



122. Meslahatu mursele: interesi i përgjithshëm.

123. Istihsan: mirësi, ta konsiderosh diçka të mirë.

## Renia e fetvave zyrtare

Ekziston edhe një pikë tjetër rreth çështjes së ixhtihadit. Sikur kjo gjë të lihej e lirë, atëherë njerëz me nivel të kualifikuar dhe të tjerë pa nivel, ose të pakualifikuar do të merreshin me çështjen e interpretimit. Por, sipas vlerësimit tim, në qoftë se ka një vetëdije të saktë islame dhe aktivizim në çështjen e ixhtihadit, s'do të rrëzoheshin disa fetva, të cilat nuk meritojnë të jenë fetva në fe, të ardhura nga disa njerëz të pazotë, sepse i zoti i fetvasë është njeri shpikës, i paditur, ose diçka tjetër.

Këto ditë po shohim se, disa fetva zyrtare, po na vijnë për “rroba” të caktuara, të cilat masa myslimane nuk i pranon dhe, as që e ndryshon aspak gjendjen reale të tyre. Ndërkohë, mund të jenë disa fetva, të cilat nuk kanë pushtet politik, por kanë pushtet shkencor dhe gëzojnë kualifikime, që i bëjnë të zotët e këtyre fetvave, të jenë njerëz të aftë për fetva dhe shqyrtime e të kenë ndikim të madh te masat e njerëzve.

E me gjithë këtë, ka disa njerëz, për shkak të mangësive të tyre në fikh, jurisprudencë, shikojnë historinë islame, veçanërisht në një mijë vitet e fundit të saj, ose shikojnë në traditat shoqërore që sundojnë në disa vende sikur të jenë burime për sheriatin. Kjo nuk është e saktë, sepse historia islame është punë e udhëheqësve në zbatimin e Islamit dhe, siç dihet puna mund të jetë e gabuar ose mund të jetë e saktë.

Ashtu sikur jurisprudenca islame që nuk është e mbrojtur nga gabimet, sepse ajo është punë e mendjes islame në nxjerrjen e dispozitave nga argumentet e saja, në të ka të gabuarën dhe të saktën. Pra, e tillë është edhe historia islame. Historia nuk është prej burimeve të shariatit. Ndoshta disa udhëheqës bien në gabime të shumta, por ne duhet të vendosim në ixhtihadin tonë mënyra për t'u larguar nga këto gabime të mundshme.

E vërteta është se, ka fjalë të shumta rreth çështjes së historisë dhe çështjeve të trashëgimisë. Disa njerëz në përkufizimet e tyre për trashëgiminë, e cila nënkupton çdo gjë të vjetër të trashëguar, sido të jetë, ixhtihad njerëzor, apo

shpallje qiellore. Ndoshta arrin deri atje sa ta konsiderojnë Kur'anin dhe Synetin prej trashëgimisë, d.m.th atë që trashëguan pasardhësit nga paraardhësit mund ta marrin e të lënë çfarë të dëshirojnë nga ajo.

Ndërsa, disa të tjerë bëjnë dallim mes tyre dhe thonë: trashëgimia është të kuptuarit e myslimanëve nga Kur'ani dhe Syneti, mund të jetë gabim dhe e saktë, ndërsa Kur'ani dhe Syneti, ato janë shpallje e Zotit dhe nuk mund t'u nënshtrohen masave dhe vlerësimeve, në të cilat ngrihet trashëgimia, duke pasur parasysh të gabuarën dhe të saktën.

Nga ana gjuhësore mund të përfshihet fjala libër dhe synet, të jenë nga trashëgimia pejgamberore, ajo çka ka ardhur nga ata, *“pastaj ne u lamë në trashëgim librin robërve Tanë që ne i kemi zgjedhur”*<sup>124</sup> dhe hadithi i Ebu-Hurejrës r.a: “Jurriini këtu?! Ndërsa trashëgimia e Muhamedit po ndahet në xhami”. Kështu që, trashëgimia jonë, të cilën e ka mbartur ymeti arab, ajo në fakt është mesazh qiellor. Libri i ardhur nga Zoti xh.sh dhe Pejgamberi i frymëzuar, që Zoti i dha mbarësi në të tëra lëvizjet dhe qëndrimet e tij, në mënyrë që ai, sipas imunitetit që gëzonte ndaj gabimeve, është edhe më i udhëzuar dhe më i frymëzuar.

Mu për këtë, ne shohim se Libri dhe Syneti janë burimi kryesor, pa të cilat feja jonë nuk bën. Patjetër duhet që ato të dyja të rrethohen nga një lloj shenjtërie, sepse ato janë jeta jonë shpirtërore dhe çdo neglizhencë në Libër dhe Synet konsiderohet dalje e diçkaje nga e vërteta e saj.

Termi i trashëgimisë, i cili ka përfshirë mendjet e disa njerëzve, është ajo çka kanë trashëguar pasardhësit prej paraardhësve nga kuptimet e padetyrueshme që nuk zbatohen mbi Librin dhe Synetin.

Këto kuptime që janë të përputhshme me termin e trashëgimisë, e cila mund të shërbejë si udhëzim Libri dhe Syneti, janë çështje që nuk përputhen me to, ato janë dy gjëra të mbrojtura, që patjetër duhet të nderohen, ato janë përmbi çdo pyetje dhe debat: *“Kur Allahu ka vendosur për një çështje, ose i Dërguari i Tij, nuk i takon (nuk i lejohet) asnjë besimtar i dhe*

*asnjë besimtareje që në atë çështje të tyre personale të bëjnë zgjedhje tjetër fare...*<sup>125</sup>. Përsëri Zoti i Lartë thotë: *“O besimtarë, mos bëni asgjë para (se të orientoheni në udhëzimet) e Zotit dhe të dërguarit të Tij...”*<sup>126</sup> kështu që, kur Zoti i Lartë, ose i Dërguari i Tij a.s kanë vendosur për diçka, atëherë çështja ka marrë fund.

Ne i nderojmë dhe respektojmë sahabet e Pejgamberit a.s, sepse ata janë pjesë e mesazhit hyjnor dhe e qenies pejgamberike. Shekulli më i mirë është shekulli i parë dhe pastaj shekulli që pason. Pejgamberi a.s vdiq dhe mesazhi i tij kufizohet brenda gadishullit arabik, megjithëse ai nga ana shkencore, është mesazh botëror. Atëherë, kush ia dha atij këtë shtrirje dhe frymë mbarë botërore?! Ata ishin shokët, sahabet, të cilët i edukoi Muhamedi a.s dhe e shkëlqeu edukimin e tyre. Ata ishin, që transportuan Islamin nga gadishulli arabik në Afrikë dhe Azi.

Nuk duhet të harrojmë se ata ishin shumë më të aftë, më të zotë e më të rrahur me jetën dhe më të patundur se sa pasuesit e Pejgamberëve të mëparshëm. Kështu pasuesit e Isait a.s, kur u lëshua urdhri për arrestimin e Isait a.s., shfaqën mohimin dhe mosnjohjen ndaj tij dhe, i pari i tyre ishte Pali që tha se unë nuk e kam parë e as nuk e njoh. Ndërsa gjetëm se shokët e Muhamedit a.s, gjatë jetës dhe pas vdekjes së tij, ishin njerëzit më besnikë e më përhapës të trashëgimisë së tij. Ata realizuan qëllimin botëror të mesazhit. Shkatërruan dy perandoritë më të mëdha të historisë në të njëjtën kohë.

Nuk kishin kaluar akoma 10 vjet nga vdekja e Pejgamberit a.s kur perandoria persiane u shua, pastaj të njëjtin fat e ndoqi perandoria romake në Azinë e vogël e në të gjithë veriun e Afrikës dhe mbeti afërsisht vetëm në Evropë e në disa pjesë të Azisë. Atyre që realizuan këtë gjë, u takon lavdia. Por, më bën përshtypje armiqësia ndaj sahabeve të Pejgamberit a.s. e cila është me qëllim.

Kam dëgjuar në radiot e huaja për Halid Ibnul Velidin, që folësi, më vonë e njoha se ishte jo-mysliman, mendonte se Halidi ishte njeri vrasës. Filloi t’i binte daulleve se ai vrau

125. Sureja Ahzabë, ajeti: 36.

126. Sureja Huxhurat, ajeti: 1.

Malik ibn Muvejr dhe i mori gruan. Pastaj, e zhveshi nga e gjithë gjenia e tij ushtarake e nga çdo lavdi në shembjen e perandorisë më tirane në botë, perandorisë romake. Kjo në realitet është falsifikim i historisë.

Gjithashtu kur thonë se Amër ibnul As ka qenë njeri plaçkitës, ose diçka i ngjashëm me këtë. Kjo gjë është e rrezikshme, sepse kuptimi i përdhosjes së sahabeve nën hijen e qëllimeve të ndryshme, do të thotë se Muhamedi a.s nuk ka ditur të edukojë se ai ka dërguar njerëz kërkues të dëshirave dhe jo njerëz të devotshëm, duke ditur se popujt nuk e kanë mësuar besimin dhe devotshmërinë, përveçse nga këta çlirues.

Ka edhe një pikë tjetër që lidhet me çështjen e thirrjes dhe me punëtorët që punojnë për Islamin sipas kushteve që i rrethojnë. Qëndrimi aktiv i punonjësve që punojnë për Islamin dhe për çështjen e thirrjes është bërë domosdoshmëri përcaktuese në këtë kohë, në të cilën sundojnë dhe gjykojnë ekuilibrat ndërshtetërorë, shpikjet teknologjike në shërbim të pushtetit dhe të udhëheqësve.

Nuk e di, nëse kjo çështje ka sjellë ndonjë gjë të re në kohën tonë, me kuptimin që, në qoftë se rryma islame në momentin kur lëviz ndjen se përpara saj ndodhen shkëmbinj e mure të mëdha që e pengojnë të lëviz e të kryej misionin, të gjitha këto pengesa janë të njëjta me ato të cilat u ndeshi zoti i Mesazhit, pikësëpari kur filloi të thërrasë.

Askush nuk mund të besonte se një popull, si populli i shkretëtirës që ngjan në afërsitë mendore, intelektuale dhe shpirtërore me secilin popull të çfarëdoshëm në botë tani, mund të mbante mesazhin e madh, por me madhështinë e thirrësit, durimin, këmbënguljen, butësinë dhe vazhdimësinë e tij, me urdhrin e Zotit, me udhëzimin dhe me dritën e Tij, e pritjen e ndihmës së Zotit, me të gjitha këto filloi puna për ndryshimin sipas planit, të cilin e vendoste kaderi për zbatimin e fjalës së Tij xh.sh: *“E tashmë fjala (premtimi) e jonë u është dhënë më parë robërve tanë të dërguar, se ata pa dyshim do të jenë të ndihmuar. Dhe se ushtria jonë do të jenë ata ngadhënjësit”*<sup>127</sup>.

127. Sureja Safatë, ajeti: 171-173.



Në qoftë se rryma Islame tani është e rrethuar me kufij të ashpër prej prapambetjes shkencore e qytetëruese, prej prapambetjes ushtarake e civile, e gjitha kjo nuk duhet të shkaktojë pesimizëm.

Për këtë mendoj se, thirrësi mysliman duhet të fillojë me ndreqjen e mjedisit të tij dhe përgatitjen e këtij mjedisi me një përgatitje shpirtërore e mendore që të shërbejë si pikënisje për tek ajo që ndodhet pas saj. Sa herë që të rregullojë atë pjesë të tokës në të cilën qëndron me këmbët e tija, kalon tek tjetra, e përfshin nën këmbët e tija një pjesë të re që të zgjerohet sipërfaqja nga e cila do të niset për mbarë botën.

Gjithashtu atij i duhet të mos bëhet imitues hap për hap i lëvizjeve të para rregulluese, sepse ndryshimet, të cilat kanë ndodhur në botë e bëjnë atë tani të kujdesshëm dhe parashikues për dimensionet që thotë. Ndoshta një fjalë thuhet tani në gadishullin arabik dhe nuk kalojnë disa orë derisa të transmetohet në pesë kontinentet. Mundet që një fetva të dalë duke pasur qëllim një mjedis të brendshëm, pastaj ajo transmetohet jashtë dhe bëhet shkak për pengesa në ecjen e thirrjes Islame.

Gjithashtu, thirrësi duhet të dijë mirë se, tani ka shumë mjete të modernizuara. Informacioni tani është bërë art. Është bërë e mundshme puna e shumë gjërave, të cilat e bëjnë fjalën e Islamit të transmetohet në forma dhe mënyra të ndryshme. Teknika e të shkruarit, me të vërtetë një teknikë që ka burrat e saj, të cilët janë të përsosur të arrijnë thellësinë e shpirttrave, e Zoti xh.sh thotë: “...*tërhiqu vërejtjen dhe thuaju fjalë që lënë përshtypje në veten e tyre*”<sup>128</sup>.

Si ta thuash fjalën e të arrijë thellësinë e shpirttrave të njerëzve? Tani, deri edhe pamja është bërë që të ndikojë. Të gjitha këto duhet t’i zotërojnë ata, të cilët i kanë hyrë punës në fushën e Islamit. Shtytësi aktiv është se, ata janë njerëz me besim në Zotin, punojnë për hir të Tij, kërkojnë ndihmë nga Ai se, ata njohin çdo mënyrë të re që shpiket në botë dhe çdo gjë që modernizohet në botë prej mënyrave dhe armatimeve ushtarake.

128. Sureja Nisae, ajeti: 63.

Kështu që lidhja, ose kapja vetëm për armët e vjetra është budallallëk. Gjithashtu, lidhja për hapat e vjetra është budallallëk. Lëvizja ka nevojë për zgjuars, inteligjencë dhe mençuri.

Duke u nisur nga kjo pikë, unë kam nevojë për një njeri që veçoritë e tij mendore të jenë elastike dhe ka mundësi që, Islami i tij të lëvizë në pika të shumta, sepse ai, në realitet, frikësohet nga paaftësia e myslimanit në vështrimin e fushës në të cilën punon. Ajo që unë kërkoja, është që ai të zotërojë fikh, kuptim-inteligjencë për pamjen me të cilën bashkëpunon përgjatë mundësive që ka dhe përgjatë shanseve të disponueshme për të.

Studenti i çfarëdo fakulteti qoftë, i cili përqafton thirrjen reformuese islame, gjëja e parë që ai mendon është goditja e udhëheqësit. Ky njeri është mendjelehtë, me të meta mendore, sepse gjëja e fundit që reformatori mendon është ndryshimi i aparatit të pushtetit. Natyrisht duhen bërë reforma në shtëpi, rrugë, në tradita, në sjellje. Ka gjëra të shumta përpara se të arrish tek karrigia në të cilin ulesh për të gjykuar. Përse i anashkalojmë të gjitha këto dhe nuk mendojmë për to? Nuk mendojmë përveçse të shkojmë drejt karriges për t'u ulur në të e për të udhëhequr.

Ai që harron rrugën e gjatë para se të arrijë në karrigen e pushtetit dhe, gjithë mendimi i tij është që ai të fillojë këtë rrugë e të kalojë distancën e gjatë e të gjerë që të arrijë për në karrige, këtë njeri unë mundem ta akuzoj për njetin e tij, në qoftë se nuk mundem ta akuzoj për mendjen e tij.

Mendo së pari në thirrjen islame, thirrjen hyjnore baza e së cilës është bashkëpunimi me Zotin xh.sh. Në qoftë se njerëzit në Evropë thonë se unë nuk kam lidhje me rrugën e njeriut të veçantë, le të jetë alkoolist, le të jetë kumarxhi ose mëkatar, kjo është rruga e tij e veçantë. Mua nuk më intereson ai me punën e tij për shtetin dhe shoqërinë, kjo është një gjë që nuk mund të kuptohet sipas drejtimit islam.

Zoti i madhëruar më ka urdhëruar të rregulloj veten time dhe në sajë të dritës së rregullimit tim për veten time, rregulloj njerëzit, d.m.th me eksperiencën time në rregullimin

e vetes, rregulloj njerëzit. Ndoshta mund të jetë dikush, në të vërtetë, njeri me nijet të saktë e të shëndoshë, por ai është i paaftë në perceptimin e pamjes me të cilën bashkëpunon dhe shtyhet në disa situata, të cilat e hedhin në rënie, dështim dhe humbje përfundimtare të krejt çështjes.

Mbetet edhe një pikë tjetër. Disa myslimanë në këto ditë, besojnë se fusha e punës islame është e kufizuar në mësimin e xhamisë, hytbe në mimber dhe në një uniformë të caktuar duke e veshur e të dalë në një ditë të javës në ndonjë fshat të afërt, ose diçka tjetër dhe, ky është ai Islami, këto janë dimensionet e tij për një pikë që e ndan prej shoqërisë, prej studimeve dhe prej shkencave bashkëkohore. Ndoshta disa prej tyre lënë edhe universitetet në moshë të avancuar duke besuar se çështja e thirrjes është më e rëndësishmja. Gjithashtu ai është i pazot të mendojë thirrjen përgjatë talentit dhe specializimit të tij shkencor dhe aftësitë e tija në lartësimin e mimberëve, tribunave aktive në shoqëri.

Ky është një problem që me të vërtetë na ka mbërthyer. Në thirrjen për në Islam kemi parë se si disa njerëz kanë përqaftuar filozofi boshe të çuditshme, që i kanë bërë të shkurtojnë rrugë në vend që të shkojnë e të ushqehen me shkencë, dije ashtu që t'i shërbejnë fesë së tyre në fusha të gjëra. Vërtet menduan se feja është vetëm disa debate në xhami me këto gjëra negative e të cilat jetojnë brenda tyre në izolim. Këta njerëz kanë pësuar krizë mendore e, ata vuajnë me siguri nga mungesa e dijes shkencore dhe kanë nevojë për dikë që u zgjeron të kuptuarit e tyre.

Çfarë mund të them për një njeri që e do xhihadin dhe kujdeset që xhihadi të jetë mbi shalën e kalit e me shpatë në dorë? Çfarë të them mbi këtë krijesë, në qoftë se është zemërmirë dhe kërkon të vdesë dëshmor, i cili ka dhënë besën që të jetë luftëtar në rrugë të Zotit? Përse nuk e mëson se, xhihadi tani ka universitete të forcave tokësore, detare dhe ajrore, se xhihadi është bërë një shkencë që ka shtrirje shkencore, të cilat gati sa nuk kanë përfshirë çdo gjë në jetën e përgjithshme?

Një njeriu të tillë si ky, duhet t'i çajmë mendjen e tij me

çfarëdo rruge derisa të kuptojë dhe, po qe se disa njerëz janë të mbyllur, sepse ata janë prej llojit për të cilin një njeri i mirë thotë: *“Nga shokët e mi kam prej atyre që shpresoj në lutjen e tij dhe refuzoj të rënit dëshmor nga ana e tij”* d.m.th i devotshëm, por ai nuk ka eksperiencë dhe nuk ka mend. Ai duhet të qëndrojë në kufirin e tij, por jo të punojë në thirrje. Atij i mjafton që të urdhërojë për punë të mira brenda kufijve të njohurive të tij për këto punë të mira, të ndalojë nga të këqijat brenda kufijve të asaj që kupton prej punëve të këqija. Por, që të punojë për një rreth të madh islam, kjo është diçka jashtë nivelit të tij.

Do të ishte më mirë sikur secili prej nesh të zinte vendin e tij. Talentet e njerëzve janë të shumta dhe pa cenuar askënd.

Ebu Dheri ishte një njeri që nuk bënte për administratë dhe, kur kërkoi të jetë punëtor ose mëkëmbës në ndonjë vend, Pejgamberi a.s ia tha hapur se, ai është i dobët e nuk vlen për punë administrative, duke i thënë: *“Kjo gjë është amanet e unë të shoh ty se je i dobët”* dhe, ky amanet, në qoftë se nuk e merr ashtu siç e kërkon dhe nuk i kryen ato që duhen kryer, do të jetë në Ditën e Kiametit përçmim dhe dëshpërim.

Mundet që njeriu të ketë talent në arte dhe mund të bëhet dijetar i madh në ndonjë prej fushave, por ai nuk ka fuqi për drejtim administrativ, sepse udhëheqja dhe drejtimi ushtarak janë teknika. Halid ibnul Velid hyri në Islam vetëm katër muaj pas dështimit, i cili i goditi myslimanët në “Uhud”. E megjithatë, Pejgamberi a.s vuri re sinqeritetin, aftësitë dhe talentin e tij. Njohu mundësitë e njeriut të madh pasi besimi i tij u bë i mirë. Atëherë i dorëzoi drejtimin e ushtrisë dhe e bëri atë prej shpatave të mprehta të Zotit përmbi armiqtë e Allahut.

Në të njëjtën kohë gjejmë shumë njerëz që qëndruan në funksionin e thirrjes së ezanit, ose në funksionin e një pune të thjeshtë, sepse këto ishin talentet e tyre, përgatitjet dhe aftësitë e tyre personale. Kështu, qenia e ndonjërit prej tyre i mirë, sepse është i mirë, mendon të jetë në ballë të myslimanëve, por jo, këto dhunti i shpërndau Zoti xh.sh përmbi robërit e tij.

Personalisht mund të vlej për një gjë dhe e përsos atë, por dështoj në diçka tjetër dhe bëhem më i ulët se sa një i thjeshtë. Nuk ka kuptim të vendosi veten time atje ku nuk vlej. Puna për Islamin ka nevojë për një njeri që ka vizion të madh, për një komandant që gjithashtu ka vizion të madh, që mundet t'i grupojë njerëzit, të cilët janë me të e t'i shpërndajë nëpër punët që ka nevojë për to.

Në një nga ngjarjet e çlirimit të Persisë, ka ndodhur kjo. Një njeri, i cili donte shumë të binte dëshmor, udhëhoqi ushtrinë dhe e mbyti atë, sepse ai dëshironte të binte shehid. Hyri në betejë, në ngjarjen e “urës”, kështu që disfata ishte shumë e madhe për myslimanët. Por jo, puna nuk qëndron kështu. Halid ibnul Velidi, kur shikoi në “Mu'te”, pa se beteja është e papërshtatshme, u tërhoq dhe, “Unë ia jap komandimin Amrit, ia jap atë Halidit, prej të zotëve të sulmit dhe tërheqjes, të zotëve të aftësive për t'u nisur dhe për t'u kthyer”<sup>129</sup>, sepse ai nuk dëshiron vetëm të vdesë, por madje dëshiron të jetojë për fenë e tij e të vdesë po për fenë e tij.

Çështja nuk qëndron te vdekja dhe mbaron puna. Çështja qëndron te puna se si unë t'i shërbej Islamit e të bëj llogaritë dhe po erdhi ndonjë njeri i mirë dhe dëshiron të udhëheqë dhe të bëhet prijës xhemati, sepse ai është i sigurtë dhe mbaron puna, jo jo, nuk bën kjo. Por duhet t'i jepet e drejta e tij natyrore në vendin e tij si drejtues shkencor, ose drejtues personal, apo diçka tjetër si këto. Ai duhet të zërë vendin e tij dhe, dikush tjetër të përparojë.



129. Pjesë nga fjala e Pejgamberit a.s përpara se myslimanët të niseshin drejt betejës së Mu'tes.

## Dështimi i parë dhe i fundit

Tani, kanë mbetur edhe dy pika. E para, rreth çështjes së Palestinës, që të përfitojmë nga mësimi i historisë përgjatë një eksperience të madhe.

Në kohën kur Izraeli po studion sulmin e kryqëzatave dhe përfiton nga mësimet e historisë në ballafaqimet e tyre, studion sulmet e mongolëve, shkaqet e dështimit të tyre dhe nxjerr nga këto mësimet e mend për të sotmen dhe të ardhmen e tij, shikojmë se realiteti palestinez, përgjatë një eksperience të gjatë, asgjë s'ka ndryshuar në këtë çështje, përveçse dërrmim dhe përçarje. Kështu që, ne jemi të pazotë të përfitojmë nga mësimi islam, i cili siguron dhe vërteton se asgjë nuk i ndaloj pushtuesit nga kjo krahinë përveçse Islami, por vëmë re se Islami tani nuk mbështetet dhe, as nuk shikohet me syrin e konsideratës në këtë konfrontim.

Ndërsa pika e dytë, është një këshillë për punëtorët në fushën islame në përgjithësi. Realiteti ashtu siç kam e parë është se, udhëheqja e parë për banorët e Palestinës ka qenë udhëheqje islamike, ka qenë Izzu Din el-Kassami dhe ai që erdhi pas tij, Emin el-Hesejnij, ishin burra që nuk njihnin gjë tjetër, përveçse Islamin dhe potencialet islamike. Nuk kishte rrugë tjetër, përveç kësaj, jo nga sektarizmi kundër pakicave kristiane që jetojnë tek ne, por si ballafaqim ndaj një qëndrimi në të cilin ishin armiq të tanë.

Armiqtë tanë erdhën me Tevrat dhe Telmud dhe pas tyre me Dhiatën e vjetër u thonin: *“Do të ngrejë çadrën e rrëzuar të Davudit, do të përzgjedh popullin tim nga mesi i popujve dhe do vijë me ta në këtë tokë”*. Këto frymëzime fetare i bëri çifutët të bëjnë një luftë fetare, madje bëri që protestantët mbi brigjet e Atlantikut mes Amerikës dhe Evropës, të jenë të lidhur për Dhiatën e Vjetër, i bëri ata të forcojnë dashurinë e tyre për sionizmin dhe t'i mbështesnin ata me gjithçka që posedojnë deri tani, prej potencialeve ushtarake.

Kështu, zhveshja e rezistencës arabe në Palestinë prej anës fetare, largimi i Islamit nga beteja dhe konsiderimi i tij

i huaj në këtë fushë, kjo për mendimin tim është dështimi i parë dhe i fundit. Algjerianët arritën të sigurojnë të ardhmen e revolucionit të tyre kur u lidhën me Islamin, sikur u lidhën të tjerët me kristianizmin.

Ata refuzuan të tjerat dhe arritën që rilindja e tyre të jetë rilindje xhihadit për të shpëtuar tokën islame. Kështu ishte rilindja Islame, ajo e cila fitoi betejën në revolucionin algjerian e ajo tani refuzon për të arabizimin. Ky është një mësim që vëllezërit në Palestinë duhet të përfitojnë prej tij.

Largimi i Islamit nuk ka kuptim tjetër, përveçse regjistrimi i dështimit për këtë ymet. Në qoftë se të tjerët nuk e larguan fenë e tyre, atëherë përse ne ta largojmë fenë tonë?! A pranohet hebraizmi botërisht si besim pushtues dhe refuzohet Islami botërisht si besim mbrojtës?! Si mundet kjo?! Në qoftë se kjo është e refuzuar, atëherë si ta pranojmë ne?!

Besoj, edhe pse unë jam një njeri me kombësi egjiptiane, por nga pozita e pohimit të të vërtetave, ashtu siç e ka kuptuar eksperiencia ime, besoj se populli palestinez është nga më të zgjuarit e popujve arabë, më i afti i tyre për rezistenca e më i pathyeshmi. Por ai, për fat të keq, është ndeshur me komplete të ndyta botërore.

Shijoi dhimbje të hidhura, e tradhtuan miq dhe armiq dhe akoma vazhdon deri tani të vuajë për shumë gjëra. Por, unë dëshiroj që të tërheq vëmendjen e tij për një gjë që patjetër duhet të sigurojë të ardhmen e tij dhe të fitojë betejën. Le të shikojmë tek armiqtë tanë.

Në librin tim *“Thirrja Islame në prag të shek. XV”* kam sjellë se, si një gazetë e Vatikanit i jep një këshillë ekzistencës sioniste në Palestinë, duke iu drejtuar aparateve ushtarake në këtë vend: studioni përse dikur kryqëzatat dështuan dhe u shkatërruan në këtë tokë?

Periudha 40-vjeçare e përçarjes, mashtrimit, copëtimit dhe e kompleteve të miqve e të armiqtë, është bërë e mjaftueshme si eksperiencë për palestinezët, për t’u kthyer pas gjithë kësaj tragjedie të hidhur tek feja dhe, te bazat e baballarëve të tyre nga të cilat ata u nisën, sepse shumë prej mendimeve, në realitet kanë qenë shprehje e maskave që fshiheshin

pas tyre grupacione dhe grumbullime jo-islamike, të cilat i shtypën e i vranë.

Ndërsa, për këshillat ndaj punëtorëve në fushën islame, kërkoj nga vëllezërit e mi, të cilët Zoti i ka nderuar të punojnë në fushën e thirrjes islame, të jenë të qëndrueshëm e të bashkohen në pikat mbrojtëse ndaj besimit dhe gjërave të shenjta të tyre, në mënyrë që të sigurojnë fitoren dhe t'ua dorëzojnë atë fëmijëve dhe nipërve të tyre, që të plotësohet rruga siç thuhet.

Tani të bashkuarit në fushat e mbrojtjes së Islamit dhe thirrjes së tij, përballojnë vuajtje e mundime të shumta, por akoma vazhdoj t'i kujtoj vetes sime dhe të tjerëve për fjalën e Zotit të Lartë: *“Mos u tregoni të dobët në ndjekjen e armikut, sepse nëse ndjeni dhembje edhe ata ndjejnë dhembje si ju, e ju shpresoni nga Allahu atë çka ata nuk e shpresojnë”*<sup>130</sup>.

Le të jenë të shumta sakrificat, le të jenë dhimbjet e një-pasnjëshme, por detyrë për ne është të lëvizim, të ecim e të kryejmë atë që kemi për detyrë dhe ne të jemi të fituar, ashtu siç ka kërkuar gjithmonë Allahu, luftëtarët të parashikojnë njërën prej dy gjërave dhe, e mira është në të dy gjërat së bashku. U thotë atyre: *“Thuaj: Neve nuk na godet asgjë tjetër, përveç çka na është caktuar prej Allahut, Ai është Ndihmëtari ynë”*<sup>131</sup>. Prandaj, vetëm Allahut le t'i mbështeten besimtarët.

Thuaj: *“Ç'prisni për ne tjetër, pas njëres nga dy të mirat (o fitues, o dëshmorë)? Ndërsa ne presim për ju që nga ana e Allahut, ose nëpërmjet duarve tona, t'ju godasë me dënim. Pra, ju pritni e, bashkë me ju presim edhe ne”*<sup>132</sup>.

Me kalimin e kohës do të piqen të mbjellat e do arrihen rezultatet dhe për çdo gjë, gjejmë suren “Hudë”, e cila përfundon me këtë ajet: *“E atyre që nuk besojnë thuaju: “veproni sa të mundeni në atë tuajën edhe ne jemi duke vepruar”. Ju pritni (ç'do të na gjejë neve) edhe ne jemi duke pritur (se ç'do t'ju gjejë juve). Vetëm Allahut i takon dija për fshehtësitë e qiejve dhe të*

130. Sureja Nisaë, ajeti: 104.

131. Sureja Toube, ajeti: 51-52.

132. Sureja Toube, ajeti: 51-52.



*tokës, çdo çështje i kthehet (në kompetencë) Atij. Pra adhuroje Atë, se Zoti yt, nuk është i panjohur për atë që veproni”.*





